

YLLI POLOVINA

**22 DITËT
E MEHMET SHEHUT
NË
NJU JORK**



2020

YLLI POLOVINA

22 DITËT E MEHMET
SHEHUT
NË NJU JORK

2020

Përmbajtja e lëndës

Grupet vorioepirote në Nju Jork

Diaspora shqiptare në SHBA

Gjenerali sovjetik Zaharokin

Vapori “Balltika”

Kati i dhjetë në “446 East, 86 Street”

Protestë e antikomunistëve duke kënduar himnin kombëtar

Vjen Fidel Kastro

Vijnë Antonin Novotni dhe Vladislav Gomulka

Çështja Rudolf Slanskit: manipulimi i mendjes së kundërshtarëve me meskalinë dhe aktevron

Vjen Hrushovi

Ftohtësi e “kampit socialist” në pritje të ardhjes së Mehmet Shehut

Shoqëruesit me pistoleta në brez të Fidel Kastros

Vjen Tito

Zbret në Nju Jork Mehmet Shehu, 20 shtator 1960

Pallati i Qelqtë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara

Ngjashmëria e Mehmet Shehut me jugosllavin Koça Popoviç
“Përse kriminelët shqiptarë u rrahën me fashistët vorioepirotë?”

Fjalë se Misioni Jugosllav në OKB do të goditet me predha reaktive

“Shqiptarët e Amerikës, që kurrë nuk kanë protestuar dhe kurrë nuk protestojnë kundër Shqipërisë, protestojnë kundër komunistëve”

Mehmet Shehu dëshiron të vizitojë Broduej

“Shoku Enver, në vapor e detyruam Titon të qëndronte mbyllur në kabinë dhe evitua çdo takim me njerëzit e tij”
Gazetat amerikane: “Nacionalistët dhe antikomunistët shqiptarë në Amerikë për shkak të Shqipërisë “mbrojnë” udhëheqësin komunist”

Gazetat amerikane: “Nacionalistët dhe antikomunistët shqiptarë në Amerikë për shkak të Shqipërisë “mbrojnë” udhëheqësin komunist”

“Shoku Enver, mbrëmë natën, për inat kërkua të shëtisim në Broduej...”

Mehmet Shehu: “Ata që u rrahën dje me grekët ishin ballista”

Buqetë e madhe me lule nga Komiteti i Partisë Komuniste të Nju Jorkut

Flet në OKB presidenti amerikan Duajt Ajzenauer

Vritet aksidentalisht nga truprojat e Fidel Kastros një vajzë nëntë vjeçare

Sovjetikët rishikuan vendimin për ndihmë në drithë për Shqipërinë dhe e akorduan një sasi me klering dhe me ar

Një tortë për Hrushovin, e dyshuar si bombë

Mot Fishman

“Hiqi duart, more vesh apo jo!”

Fan Noli

“Shoku Enver, vajtëm një orë e gjysmë nga Uollstriti”

Bisedë me gazetarin e revistës “United States News and World Report”

Ballistët: “Nashti jemi me Tiranën e do themi rroftë Mehmet Shehu”

Revista “Time” shkruan...

26 shtator, kryeministri shqiptar zbraz 15 faqe fjalim në OKB

“Shoku Enver, armiqtë na duken si krimba të shushatur”

Tek dreka e mërzitshme e Hrushovit hahet edhe pjepër

Takim me Ges Holl, Sekretar i Përgjithshëm i Partisë
Komuniste Amerikane

“Fiqireti me fëmijët janë mirë...Të përqafoj. Shpati”

Gazetari grek Kris Nikollopulos, i atashuar pranë OKB-së

“Të përqafoj me mall. Shpati”

Intervista me gazetarin grek

Sërish Mot Fishman

Gazeta “Shqiptari i lirë”

Mehmet Shehu në revistën “Life”

Të vizitojnë “Empire State Building” apo “Rokfeler Center”?

Tito lajmëron ikjen e tij nga Nju Jorku

Tre tetor, në Asamble Mehmet Shehu flet mbi përfaqësimin
e Kinës në OKB

Kur gdhiu 4 tetori

Antikomunisti Selahudin Kaloshi i godet me një shishe vere
Vizitë e Mehmet Shehut në “Metropolitan Museum”, e pret
vetë drejtori Xhejms Robejner

Vizitë në lagjen “Harlem”

“Fiqiretin me fëmijë i ke mirë, të bëjnë të fala. Shokët dhe
Nexhmija të bëjnë gjithashtu të fala... Yti, Shpati”

Në “Empire State Building”

Novotni dhe Gomulka largohen nga SHBA

“Hrushovi, person me sëmundje psiqike”

“Të vish shëndoshë. Shpati”

Përsëri revista “Time”

Vapori tundet...

46 fjalët e radiogramit

Ikja e Mehmet Shehut nga Nju Jorku me udhëtimin e
fundit të anijes franceze “Liberté”

Zbritja në aeroportin e Rinasit

Grupet vorioepirote në Nju Jork

Ndërsa ishte ende në Tiranë në prag të udhëtimit të tij për të marrë pjesë në punimet e Sesionit të 15-të të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, në 3 shtator 1960 në zyrën e Mehmet Shehut mbërriti një material informativ, të cilin e kishte kërkuar vetë.

Qenë të dhëna për trajtimin nga qeveria shqiptare e minoritetit grek.

Nga Nju Jorku Reis Malile i pat shkruar se diaspora fqinje në Shtetet e Bashkuara të Amerikës jo vetëm që agresive, por grupet e saj voriepirote kishin përhapur fjalë se Mehmet Shehun, kur të vinte, do ta prisnin me protesta të forta.

Kjo mund të shkaktojë vëmendje të medias njujorkeze për Shqipërinë dhe qëndrimin gjoja diskriminues që ajo mban ndaj pakicës greke, nënvizonte Malile.

Gjithçka mund të sqarohet, këmbëngulte ai, në rast se i jepen fakte se gëzon përkujdesje të plotë.

Kryeministri, sapo ja sollën informacionin për pakicën greke në Shqipëri, e lexoi me një frymë.

Ishte një përmbledhje e ngjeshur.

Shifrat e shumta dhe fjalët e kursyera thoshin se minoriteti kishte në vendbanimet e veta në jug 3 spitale me 23 shtretër, 4 maternitete e reparte lindjeje me 14 shtretër, një stacion hydromineral me 30 krevate, 4 konsultore për gra e fëmijë, 19 ambulanca mjekimi dhe 2 farmaci.

I gjithë personeli në to përbëhej nga rreth 70 vetë, prej të cilëve dy qenë mjekë dhe tridhjetë e pesë teknikë të mesëm e të ultë.

Informacioni shënonte se për nevoja të pakicës greke funksiononin 19 kopshte me 673 fëmijë e 22 edukatore, 84 shkolla fillore me 3880 nxënës dhe 124 mësues, 20 shkolla tetëvjeçare me 1403 nxënës.

Thuhej gjithashtu se në Shkollën Pedagogjike të Gjirokastrës, ku përgatiteshin kuadro mësimdhënës për shkollat minoritare, kishte dy klasa paralele me 54 nxënës.

Mehmet Shehu e mori në duar dyfletëshin e daktilografuar dhe pasi e mbajti pak sekonda në ajër, i nguli sytë zhbirues në dy radhët e fundit: “Arsimi shtatëvjeçar në shkallë republike është realizuar 70.6 %, kurse në shkollat minoritare mbi 80 %. Dropulli e Pogoni realizuar 100%”.

Që kur ishte i vogël kështu i mbante mend minoritarët grekë: shumë të zgjuar.

Diaspora shqiptare në SHBA

Informacioni tjetër që sipas kërkesës së tij kryeministrit i erdhi nga Ministria e Jashtme thoshte se në SHBA kishte rreth 70.000 shqiptarë të emigruar, prej tyre 60 deri 65 për qind bashkë me familje.

Në çdo dhjetë prej tyre dy ende nuk qenë pajisur me shtetësi amerikane.

Nga të shtatëdhjetë mijtë 65 për qind ishin nga Korça dhe 30 për qind nga Gjirokastra.

Në fillimet e veta qenë grumbulluar në organizata të ndryshme shoqërore dhe mirëbërëse, po ashtu, duke ngritur kisha, edhe në bashkime fetare ortodokse. Kishat kishin luajtur rol pozitiv në lëvizjen nacionale. Njëkohësisht edhe në grumbullimin e unitetin e shqiptarëve të atjeshëm. Degë aktive të shoqatave gjendeshin në Nju Jork, Worcester, Boston, Filadelfia, Detroit, Çikago.

Informacioni i ardhur nga MPJ thoshte se “Vatra” që e para shoqatë politike, e krijuar në 1912 me iniciativën e Fan Nolit dhe të Faik Konicës. Gazeta “Dielli”, botuar nën kujdesin e Nolit që në vitin 1909, “Vatra” e bëri organ të saj. Në fillim kishin qenë afër qeverisë së Tiranës, kurse tashmë shpreheshin kundër.

Mes kundërshtarëve më aktivë ishte Arshi Pipa.

Po ashtu edhe një tjetër, M.M., autor i libri “Pionieri i Kuq” (“The Red Pionier”). Sipas një radiogrami të Reis Maliles të 22 dhjetorit 1959, ky libër që botuar në 1955 në Nju Jork, por tashmë nuk i gjendeshin më kopje në qarkullim.

Njërën pat arritur ta gjente vetë Malile rastësisht në një dyqan librash të vjetër dhe ja kishte nisur menjëherë Tiranës.

Informacioni i Ministrisë së Jashtme ngulte këmbë se organizata kundërshtare në SHBA qenë Komiteti Shqipëria e Lirë, Balli Kombëtar, Blloku Independent, po ashtu disa grupe zogiste.

Libra që herë pas here i dërgoheshin nga Tirana kolonisë shqiptare në SHBA qenë “Bagëti e bujqësi” e Naim Frashërit, “Albumi” i Fan Nolit...

Në listën me rreth tridhjetë tituj Mehmet Shehu pa se ndodhej edhe libri i tij “Lufta për çlirimin e Tiranës”.

Në raportin e ardhur i bëhej me dijeni kryeministrit se qeveria amerikane për vitin 1960 kishte përcaktuar si kuotë pranimi të emigrantëve nga Shqipëria 100 vetë, por kufiri mund të zgjerohej deri në 428. Këtë njoftim e pat bërë gazeta “New York Times” e 18 marsit.

Emisioni i posaçëm i Radio-Tiranës për shqiptarët jashtë atdheut në SHBA, sipas informacionit të MPJ, dëgjohej me valën e shkurtër 30.93 metra, me orën e Nju Jorkut çdo ditë nga 20.30 deri në 21.00.

Gjenerali sovjetik Zaharokin

Udhëtimin e kryeministrit shqiptar drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës e kemi përshkruar tek libri me format elektronik “Mehmet Shehu dhe Tito takim në “Queen Elizabeth”, qëllimi i këtij libri tjetër të këtij lloji teknik është përshkrimi i 22 ditëve të qëndrimit të tij në Nju Jork.

Në qytetin e madh amerikan Misioni Shqiptar pranë Kombeve të Bashkuara që në mobilizim të ethshëm për të qenë i gatshëm të përballonte dërgatën e rëndësishme në ardhje nga Shqipëria. Tensioni u shumëfishojte edhe nga ankthi që do të përjetonin në rrethanat e një shtrëngimi shumë të madh për të qarkulluar.

Në pasditen e pesëmbëdhjetë shtatorit të gjithë drejtuesit e përfaqësive diplomatike të vendeve socialiste u ftuan në ndërtesën e Misionit Sovjetik dhe gjenerali Zaharokin informoi me hollësi për masat e sigurimit ndaj kryetarëve të delegacioneve.

Oficeri i lartë i shërbimit të fshehtë tërhoqi vëmendjen e pjesëmarrësve posaçërisht për kanosjen nga veprime armiqësore kundër Janosh Kadarit dhe Mehmet Shehut. “Kujdes, shumë kujdes!”, përsëriti ai disa herë. Po ashtu këshilloi që secila përfaqësi për çështjen e sigurisë duhej të mbante kontakte të drejtpërdrejta me autoritetet amerikane. Ndryshe as ata vetë, me njerëzit e tyre të specializuar për trupmbrojtje, nuk do të dinin si të vepronin.

Në radiogramin informues që me këtë rast Reis Malile i dërgoi Ministrisë së Jashtme në Tiranë, në përfundim të

tekstit, bëhej e qartë se në Nju Jork “Përgjithësisht atmosfera është shumë armiqësore. Para misionit sovjetik kanë filluar të bëjnë demonstrata”.

Më 16 shtator 1960, ditë e premte, Departamenti Amerikan i Shtetit publikoi një deklaratë rreth masave jo të zakonshme të sigurisë, të cilat qenë të detyruar t’i merrnin për delegacionet e shumta pjesëmarrëse në punimet e OKB-së. Ato priteshin të ishin nëntëdhjetë e gjashtë. “Kubanët, sovjetikët dhe të gjitha delegacionet e tjera janë njoftuar t’i lënë armët e tyre të zjarrit në shtëpi”, paralajmëronte një fragment i saj.

Shtohej se për të realizuar sigurinë e krerëve të dërgatave nuk do të lejoheshin trupat e tyre, sikur edhe të paarmatosur të qenë. Këta mund të rrinin në një rreth të dytë afërsie fizike të udhëheqësve, por nuk do të kryenin asnjë detyrë mbrojtjeje. Kjo do të realizohej vetëm prej agjentëve vendas, lokalë apo federalë.

“Prandaj”, vijonte Departamenti, “janë marrë përsipër të gjitha masat e duhura”.

Shtypi që atë ditë, sapo u shpërnda deklarata dhe u formuluan lajmet e para rreth saj, shpjegoi se kjo siguri e shtuar këtë herë ndodhte për shkak të një viti plot me tensione ndërkombëtare dhe vatrash të tejnxehura në të gjithë globin. Acarimet mes mjaft shteteve qenë shumë të mëdha, përplasjet ndërmjet dy blloqeve politikë, atij kapitalist dhe komunist, mbërritur në vijë të kuqe alarmi. Nuk mungonin tonet nervoze të polemikave edhe mes vetë kampit bolshevik, ku Bashkimi Sovjetik me Kinën flitej se e patën prishur rëndë harmoninë e mëparshme.

Për pasojë kolonat e lajmeve në gazetatat e mbrëmjes së 16 shtatorit 1960, por edhe ato që dolën në mëngjesin e të nesërmes, vinin në dukje se në “Romën e kohëve moderne”, siç kishin ditë që e thërritnin Nju Jorkun në prag të ardhjes së aq shumë delegacioneve të huaja, numri i

agjentëve amerikanë me uniformë dhe të veshur civilë arrinte një shifër gjer ato kohë të paparë.

Ajo armatë e madhe për ruajtje jetësh mund të quhej e paprecedent në të tërë historinë e vetë organizatës.

Edhe pse deklarata publike e Departamentit të Shtetit nuk i thoshte konkretisht, gazetarët kishin rënë në gjurmë të disa hollësive. Kështu nga e gjithë masa e delegacioneve në pritje të zbarkonte në Nju Jork krerët që duhej të mbuloheshin në mënyrë të dendur me roje qenë pesëmbëdhjetë deri njëzetë persona.

Kjo ishte “bërthama” e madhe.

Ndërkohë brenda kësaj gjendej një tjetër “bërthamëz”, masat e sigurisë për të cilën ishin ekstra.

Këta qenë Nikita Hrushov, Fidel Kastro, Janosh Kadar dhe Mehmet Shehu.

Midis këtij rrethi të ngushtë ultrasigurie dhe atij të madh përmendej edhe emri i udhëheqësit të Republikës Arabe të Bashkuar, Gamal Abdel Naser.

Veçanërisht për këta udhëheqës grupi i afërt i sigurisë si rregull normal prej gjashtë deri tetë vetë tashmë qe pesëfishuar. Nga zyra e sigurisë së Departamentit të Shtetit ishte bërë e ditur se për gjithsecilin do të qenë plot tridhjetë truproja.

Për këtë skemë garancie fizike, tashmë më formën përfundimtare, patën rënë dakord të dy palët përgjegjëse: Departamenti i Shtetit dhe ai i Policisë së Nju Jorkut.

Ky i fundit përbëhej nga 23.596 oficerë dhe qe pikërisht ai i cili do të mbante ngarkesën kryesore për sigurinë e mbledhjes së Sesionit XV të Asamblesë.

I shtuar edhe me agjentë federalë gjithsesi mbrojtja fizike e delegacioneve vlerësohej e pamundur pa e bërë të kufizueshme lëvizjen e tyre në Nju Jork dhe jashtë tij. Kështu edhe pse kjo gjë do të shkaktonte pakënaqësi dhe në mos sulme politike kundër Shteteve të Bashkuara të

Amerikës, për territorin e lëvizjes së dërgatave u caktua një “vijë e verdhë”.

Kjo menjëherë iu bë e njohur çdo Misioni pranë OKB-së. Për Hrushovin, Kastron, Kadarin dhe Shehun kjo vijë u ngushtua edhe më shumë: vetëm lagja ishull Manhattan. Që të katërve cenimi i sigurisë dhe për pasojë dëmtimi i punimeve të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, parashikohej t’u vinte nga pakicat e të emigruarve në SHBA, shumica dërmuese e tyre kundërshtarë politikë, antikomunistë.

Në interpretim të deklaratës publike për shtyp të Departamentit të Shtetit gazetarët informonin opinionin se prej katër më të rrezikuarve ardhësi më i kanosur për të qenë objekt sulmi dhe për pasojë problemi më i madh për punonjësit amerikanë të sigurisë nuk gjykohej Nikita Hrushovi, por Fidel Kastro.

Kjo ndodhte sepse ai në qëndrimet e tij që më i paparashikueshmi. Truprojat e Kastros duke iu përshtatur stilit të sjelljes së shefit të tyre nuk do të pajtoheshin me heqjen dorë nga roli i mbrojtjes dhe do t’i rezistonin me mosbindje agjentëve vendas që do të ngarkoheshin me këtë detyrë.

Kjo do të shkaktonte kaos në të gjithë skemën e sigurisë. Kryetari problematik i Partisë Komuniste të Kubës pritej të vinte të nesërmen, më 18 shtator, ditë e diel, dhe menjëherë do të shkonte në hotelin “East Side Shelburne”, në lagjen Harlem. Atje përveç simpatizantëve jo të paktë kishte me shumicë edhe refugjatë kubanë, të gjithë armiq të betuar të regjimit komunist.

Tridhjetë e katërvjeçari Fidel, shkruante një e përditshme e së shtunës, mund të kthehej në dhembjen e parë të kokës për autoritetet amerikane.

Ndërkaq në pritjen e Nikita Hrushovit që do të kryhej një ditë më pas nga mbërritja e Kastros, premtuhej se do të

angazhoheshin tetë mijë agjentë dhe sipas gazetarëve ky numër qe pothuaj sa dyfishi i sasisë së mobilizuar një vit më parë gjatë vizitës që Sekretari i Parë i Partisë Komuniste Sovjetike pat bërë në SHBA si i ftuar i presidentit Duajt Ajzenauer.

Kur njëri prej gazetarëve arriti më në fund të pyeste një zyrtar të Departamentit të Shtetit se çfarë do të bënin nëse Hrushovi do të vendoste të mos i përfillte masat e kufizimit të lëvizjes tij, ai qe përgjigjur: “Kjo nuk ka mundësi të ndodhë”. Ndërkohë pat shtuar se, nëse kjo do të ngjante, ata do të përpiqeshin me mirësjellje dhe maturi ta bindnin për të kundërtën.

Në të përditshmet amerikane të 17 shtatorit e shkruar hollësisht gjendej edhe kjo deklaratë: “Nëse do të jetë e nevojshme agjentët tanë të sigurisë do të ndalojnë dhe makinën e Hrushovit, por patjetër askush nuk do të tentojë t’i shtrijë duart drejt Sekretarit të Parë të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik”.

Nëpër kolonat e gazetave ndodhej edhe fragmenti “Zyrtarët thanë se është e mundur që pavarësisht kufizimeve të lëvizjes, nëse Hrushovi do të kërkojë të bëjë një vizitë në selinë e misionit sovjetik në Glen Cove të Long Island, pra në hapësirën jashtë Manhatanit, ajo mund të lejohej. E vërteta është se zyrtarët mendojnë që udhëheqësi rus do të preferojë më tepër tu bindet kufizimeve të sigurisë, se sa të kërkonte dëfrimin”.

Vapori “Balltika”

Ndërkohë të përditshmet amerikane qenë shumë të kujdesura që ende pa zbarkuar në Nju Jork masa e stërmadhe e delegacioneve komuniste, ta informonin lexuesit për një veçanti: shumica e tyre me në krye Nikita Hrushovin vinin si grup me të njëjtën anije, tragetin sovjetik “Balltika”, qëllimisht.

Sipas vëzhguesve, kjo qe një mënyrë për të treguar se kishin unitet të pandashëm dhe po asnjë moskokëçarje ndaj fjalëve të përhapura se me ato ditë qëndrimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës viheshin në gjendje të vështirë inferioriteti politik. Të përditshmet saktësonin se që nga Moska njeriu numër një i Partisë Komuniste të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike për dy javë rresht nuk e kishte pushuar asnjë ditë sulmin posaçërisht të ashpërsuar kundër imperializmit amerikan. Madje pat shkuar edhe më tej. Kishte deklaruar se në Pallatin e Qelqtë do të vinte jo i përunjur, por me kokën lart, i sigurt se puna më e mirë që duhej të bënte sapo të hynte në të e të ngjitej në tribunë, qe ta demaskonte OKB-në si një vegël të verbër të Uashingtonit.

Mund të jetë me të vërtetë një betejë e ashpër fjalësh në këtë sesion, ngulnin këmbë gazetatat. Atë vit, arsyetonin ato, për herë të parë do të prezantoheshin në Asamblenë e Përgjithshme 22 vende të reja afrikane, që të gjitha me pavarësi të fituar dhjetë vitet e fundit. Në cilën anë do të rreshtoheshin ato, me SHBA-në apo BRSS-në, mbetej një temë e hapur debati dhe baraspeshe globale.

Me në dorë plot njëzetë e dy vota shtesë në votimet e OKB-së mund të përmbysje çdo rezultat të garantuar deri pak kohë më parë.

Me gjuhën e ashpër antiamerikane dhe kundërkolonialiste të nisur që nga Moska, por edhe me ardhjen radhë bashkuar në Nju Jork, Nikita Hrushovi e kishte nisur potershëm luftën për të njëzetë e dytët. Analistët e marrëdhënieve ndërkombëtare paralajmëronin se me parullat e tij ai me të vërtetë mund të bënte për vete një numër të madh të tyre. Për pasojë, shpjegonin ata në rreshtat e gazetave, flitej se qe vënë në lëvizje edhe [Duajt Ajzenauer](#).

Edhe pse republikani ndodhej në javët e fundit të presidencës së tij tetëvjeçare, ndërsa përballë i rrinte si fitimtar i sigurt demokrati me moshë të re Xhon Kenedi (John Kennedy), kishte lënë të nënkuptohej se që nga Uashingtoni do të vinte në Nju Jork për të folur në OKB. Madje do t'i takonte një për një të gjithë përfaqësuesit e vendeve të reja afrikane.

Kati i dhjetë në “446 East, 86 Street”

Në ditën e premte të 16 shtatorit, nëpërmjet telegramit 327, Reis Malile njoftoi Tiranën se “Me rekomandimin e Misionit të SHBA-së në OKB morëm takim me policinë amerikane. Ata thanë se për gjithë kohën që do të qëndrojë shoku Mehmet këtu, gjatë lëvizjeve do të shoqërohet nga katër automobila të policisë efektive e disa motoçiklistë. Jashtë Misionit do të vendosen policë efektive me shërbim natë e ditë”.

Një teleks i koduar i të nesërme, 17 shtator, vazhdonte nga Nju Jorku të vinte në dijeni Tiranën edhe me një zhvillim tjetër: në mjediset e Misionit patën ardhur dy kapitenë të policisë amerikane. Me ta u bisedua për të gjitha masat e hollësishme rreth sigurimit të Mehmet Shehut dhe veçanërisht të selisë, ku ai do të flinte gjatë gjithë kohës së qëndrimit.

Ajo ndodhej në katin e dhjetë të godinës, në “446 East, 86 Street”.

Dy kapitenët patën siguruar se në shërbim të ruajtjes së kryeqeveritarit shqiptar dhe të lëvizjes së tij nëpër Manhattan do të ishte në dispozicion një numër i madh jo vetëm policësh, por edhe detektivësh. Po ashtu dy oficerët e policisë njujorkeze i patën vënë në dijeni se për karshi selisë së Misionit Shqiptar do të viheshin edhe shenjat përkatëse ku mund të lejoheshin demonstrata kundër delegacionit.

Diplomati që kishte pritur dy kapitenët, menjëherë u pat thënë: “Nuk parashikojmë demonstrata, sepse deri tani asnjëherë nuk janë bërë kundër nesh dhe se policia duhet

të marrë masat t'i ndalojë. Ndryshe krijohen kondita pune anormale për delegacionin".

Megjithatë dy kapitenët qenë përgjegjur se "Shenjat e rastit do t'i vendosim për çdo eventualitet".

Në të vërtetë policia amerikane kishte të dhëna për demonstrime të shqiptarëve antikomunistë, madje edhe për një manifestim të dëshiruar shumë prej simpatizantëve të qeverisë së Tiranës.

Kaq gjë e dinin edhe në Mision.

Dy zbuluesit e saj politikë, të veshur me petkun e diplomatit, qenë të informuar edhe për protesta të pritshme të vorioepirotëve. Madje gazetatat e emigrantëve grekë kishin disa ditë rresht që u bënë thirrje bashkëkombësve të tyre të grumbulloheshin ditën e martë në portin e Nju Jorkut dhe t'ia përplasnin në fytyrë zemërimin kryeministrit shqiptar.

Por 17 shtatori, vetëm tre ditë nga çasti kur në Nju Jork do të ancoronte transatlantiku "Queen Elizabeth" dhe prej tij do të zbriste Mehmet Shehu, nuk mund të ishte një ditë e zakonshme pune edhe për arsye të tjera. Në mbrëmje në Misionin Sovjetik pranë Kombeve të Bashkuara qenë ftuar dhe mbledhur sërish të gjithë titullarët e përfaqësive diplomatike nga vendet e kampit socialist.

Gjeneral Zaharokin i pat informuar shkurtimisht kolegët mbi datën dhe orën kur do të mbërrinte vaporit sovjetik "Balltika" me udhëheqësit e Bashkimit Sovjetik, Rumanisë, Hungarisë, Bullgarisë, Ukrainës dhe Bjellorusisë, cilat do të qenë masat e sigurimit si edhe ceremonia e nevojshme për pritjen e tyre protokollare.

Në atë mbledhje secilit përfaqësues i qe kërkuar edhe një listë e personave që do të merrnin pjesë në pritje. Ky duhej të ishte grup i vogël.

E nesërmja do të qe pothuaj për të gjithë Misionet e euro lindjes komuniste një ditë mjaft më e vështirë nga sa e

patën parashikuar zbuluesit e tyre që kishin mbledhur me kohë të dhëna se kundërshtarët politikë të emigruar në Nju Jork dhe në qytetet e shtetet e tjera të SHBA po përgatiteshin të kryenin protesta gjatë gjithë periudhës që delegacionet do të ndodheshin në punimet e OKB-së. Arsyeja përse niste më 18 shtator ky mobilizim qe e thjeshtë.

Këtë ditë fillonte mbërritja e udhëheqësve komunistë. Në fillim do të zbarkonte Fidel Kastro, më pas presidenti çekoslovak Antonin Novotni dhe shefi i komunistëve polakë Vladislav Gomulka.

Protestë e antikomunistëve duke kënduar himnin kombëtar

Rreth orës 12.00 diplomatët shqiptarë që nga dritaret e zyrave të Misionit vunë re se e gjithë godina u qarkua prej një numri të madh policësh.

Kur ende akrepat e sahatit të madh në murin përballë tryezës së punës të Reis Maliles po i afroheshin shifrës 13.00, në hapësirën e mbrojtur e të lejuar nga agentët lokalë erdhën dhe u bënë bashkë me njëri-tjetrin një grup shqiptarësh të arratisur.

Ata përherë e më shumë shtoheshin.

Filluan t'i numëronin. Qenë afërsisht nëntëdhjetë vetë.

Nuk dukeshin të egërsuar. Herë pas here bisedonin plot me humor me njëri-tjetrin dhe disa që kishin marrë me vete fëmijë, u përkëdhelnin flokët. Pas këtij çasti grupi i të grumbulluarve nisi të këndonte. Pas xhamave të Misionit diplomatët shqiptarë mbajtën frymën.

Ishte himni kombëtar.

Për sa kohë përsëritën vargjet e tij bashkëkombësit ndenjën si të ngurosur. Që prej katit të dhjetë shprehjet e fytyrave të tyre nuk u dalloheshin, por zëri i largët u vinte i shtruar, i butë, shumë i kujdesshëm të mos prishte asnjë notë të melodisë.

Tingujt që arritën deri tek dritaret e Misionit Shqiptar qenë të ëmbël. Ngjante sikur ardhësit ia kishin marrë një kënge dashurie.

Pasi himni kombëtar përfundoi grupi papritmas u tendos, shtrëngoi radhët dhe nisi të hidhte parulla kundër Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut.

Tashmë nuk ishin të qetë e të shtruar, mezi vetëpërbaheshin.

Kur i mbaruan thirrjet bënë një grimë pauze, fragment i vetëtimtë kohe kur u duk se diçka po i thoshin njëri-tjetrit dhe pastaj u dëgjua si ia morën një kënge tjetër. Ngjante si motiv nga Rilindja, vargje për një çetë të jugut, e cila kishte vrarë një oficer të lartë osman dhe nga mali në mal marshonte e luftonte për çlirimin e vendit.

Kur ajo melodi u këndua e tëra dhe më në fund tingujt e saj u fikën, protestuesit rifilluan një tjetër. Në mbyllje të melodisë së re sërish u tendosën, filluan të tundnin duart në ajër dhe rinisën të hidhnin parulla kundër diktaturës komuniste. U dëgjuan edhe një tufë brohoritjesh entuziaste për dikë që hipi mbi supet e shokëve dhe kërkoi rrëzimin e qeverisë së Tiranës. Pastaj një i dytë kushtroi për ardhjen e ditës së lirisë.

Këtë çast një telefonatë që erdhi nga Misioni Hungarez u bëri të qartë diplomatëve shqiptarë se emigrantët antikomunistë edhe aty po kryenin të njëjtën gjë. Manifestimi që organizuar si një veprim i tërë nga e gjithë diaspora e të arratisurve. Me siguri si i tillë, në mos këmbëngulës, do të vijonte edhe më pas, kur të mbërrinin delegacionet. Demonstratat e atyre momenteve mbase qenë rregulluar të ishin të përmbajtura aq sa të merrnin përmasat e vetëm një paralajmërimi.

Në sheshin para Misionit Shqiptar protesta e atij 18 shtatori zgjati dy orë. Nga dritaret e katit të dhjetë më pas u pa se si grupi i manifestuesve u nis drejt selisë së Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Qëndruan atje dhe bashkë me demonstrues nga vende të tjera të kampit socialist hodhën parulla edhe për një orë tjetër. Pastaj, si të qenë komanduar nga vetëm një dorë, u tërhoqën dhe ikën, thua nuk kishin ekzistuar kurrë atë mesditë vjeshte njujorkeze.

Që atë pasdite Reis Malile e njoftoi Tiranën për çfarë ndodhi. Ajo duhej ta dinte se vështirësitë për delegacionin dhe kryeministrin Mehmet Shehu qenë edhe më të papritura e të ndërlikuara nga sa mendohej. Sipas tij, qeveria amerikane e kishte marrë seriozisht ta shndërronte praninë e përkohshme të dërgatave të larta nga vendet komuniste në një betejë të vërtetë politike.

Në teleksin e shifruar që dërgoi Malile, shkroi se të gjithë pjesëmarrësit e demonstrimit të asaj dite qenë kriminelë dhe se patjetër manifestimi duhej të qe nxitur dhe organizuar nëpërmjet policisë së fshehtë amerikane.

Në radiogram ai vendosi edhe rreshtat: “Jemi informuar se policia amerikane të gjithë demonstruesit i paguan me dollarë për çdo orë që ata kryejnë veprën e poshtër”.

Vjen Fidel Kastro

Fidel Kastro zbriti në aeroportin Idlewild të Nju Jorkut kur qe mezi i ditës dhe qielli, krejtësisht gri, herë hidhte rruzuj të ujta dhe herë shpërndante nëpër ajër pikla fare të imta. Avioni me të cilin erdhi ishte hijerëndë dhe kthesën e fundit para se të ndalej e kreu me një manovër fodulle.

Kur iu afruan shkallët Kastro bëri ballë tek dera dhe i rrethuar prej të vetëve, personelit të avionit dhe një stjuardese që e ndiqte me sy adhurues, u ndal një çast dhe për të përshëndetur ngriti lart dorën e djathtë.

E tundi atë disa herë, më shumë duke parë përtej, diku në horizont.

Pastaj e uli krahun e shtrirë dhe filloi të shihte me vëmendje cilët qenë ata që po qëndronin poshtë këmbëve të tij. E dinte që nuk e priste asnjë prej simpatizantëve të vet.

As nga përfaqësuesit e vendeve socialiste nuk kishte njeri.

Amerikanët nuk i patën lejuar as të parët dhe as të dytët.

Tek fundi i shkallëve dhe gjithkund në hapësirën para tyre priste vetëm një grumbull i madh me policë dhe detektivë.

Me siguri edhe agjentësh të fshehtë, sepse disa syresh qenë veshur me pardesy të bardha dhe të tjerë i kishin ato me ngjyrë të errët.

Më në fund i hodhi çapat për të zbritur. Ishte i sigurt se që prej këtij çasti ai i kishte të gjitha hiret fizike dhe aftësitë politike t'iu bënte sfidë autoriteteve vendase.

I pat mundur njëherë kur kishte bërë që revolucionin e tij të triumfojë dhe imperialistët e Uashingtonit t'iu dëbonte nga trojet e Kubës. Tani do t'iu mundte sërish.

Kishte ardhur me uniformë ushtarake dhe po ashtu do të rrinte deri në ditën kur do të ikte nga Nju Jorku, pa hequr nga koka as kasketën me në krye simbolin e revolucionit kuban. Me atë veshje mbi trup do ta mbante fjalimin e tij kryesor në tribunën e OKB-së dhe po ashtu çdo qëndrim publik tjetër, kurdo dhe për çfarëdo gjë të ndodhte.

Tani, tek zbriste, e kishte zbërthyer posaçërisht xhaketën. Grimcat e rralla të shiut i ranë më fort mbi fytyrë dhe i sollën ndjenjë ngazëllimi. Atëherë e lëshoi trupin e madh të kapërcente hovshëm shkallët, duke u lëkundur lehtas, si të qe duke shëtitur në një bulevard.

Deri ato çaste shpërfillshëm ndaj ndonjë etike zyrtare, kur shkeli mbi pistë dhe pa se menjëherë policët dhe detektivët e vunë në mes, e lëkundur edhe më shkujdesshim shtatin, kërceu përpara gjoksin dhe futi dorën e majtë në xhep.

Dy hapa më pas, tek nisi të ecte, filloi të përshëndeste me tundje të vogla koke majtas e djathtas. Kur u ndal para tufës së një duzine mikrofonash e ngriti lart dorën e djathtë. E tundi në ajër pëllëmbën disa herë, pastaj hoqi kapelën.

Filloi të fliste me një anglishte që e zotëronte keq.

Kam ardhur, tha, të përshëndes popullin amerikan.

Kur pritej të vijonte më tej heshti dhe në kërkim të fjalëve të tjera i lëvizi njëkohshëm buzët e trupin. Pauza bërbelitëse zgjati disa sekonda. Më në fund u mundua të shpjegonte se anglishtja e tij qe e qëmotshme, e mësuar shumë vite më parë.

Fraza e tretë që tha kishte të bënte me praninë e tij në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

E katërta qe një “faleminderit”.

Adhuresit i ndeshi sapo vargu i makinave me limuzinën e tij në mes po i afrohej daljes nga Idlewild. Qëndronin pas rrjetave me tel. Qenë shumë të gëzuar që e shihnin. Një grumbull grash kishte hapur dhe mbështetur tek kangjellat

një flamur të madh kuban me në skaj yllin. Një vajzë e vogël me një xhaketë me kuadrate bardhë e zi, i tundte pa pushim duart e vogla. Ndoshta të gjithë duke e pritur kishin orë të tëra, duke duruar edhe shiun.

Mbështetësit nuk i munguan edhe kur vargu i makinave doli fare nga aeroporti. Kastro bashkë me dy nga njerëzit e tij qëndronte në ndenjësën e prapme të veturës dhe dritaren nga ana e adhuruesve e mbajti krejtësisht të hapur. Vazhdimisht përshëndeste dhe tërë entuziazëm fliste me të vetët. Një çast dëshiroi të qëndronte për t'i takuar dhe policia amerikane nuk e pengoi.

Kur delegacioni kuban hyri në 37 Street qëndroi para hotelit Shelburne, ku edhe kishin bërë më parë pajtimin për të qëndruar gjatë gjithë kohës së ndënies në Nju Jork.

Vijnë Antonin Novotni dhe Vladislav Gomulka

Në mbrëmjen e 18 shtatorit në aeroportin e Nju Jorkut zbritën njëri pas tjetrit Antonin Novotni dhe Vladislav Gomulka, porse për t'i pritur policia amerikane nuk lejoi asnjë prej përfaqësuesve të misioneve të vendeve socialiste. Qenë të pranishëm në ceremoninë protokollare vetëm personeli i dy Misioneve përkatëse, atij çek dhe polak.

Ishte një natë e cila po qullej nga një shi i butë, por kokëfortë për të mos pushuar, veç disa çasteve fare të shkurtra, ku piklat thjesht rralloheshin e megjithatë nuk reshtnin asnjëherë.

Kronikën e dy ardhjeve televizionet kryesore njujorkeze nuk e transmetuan, por Reis Malile arriti të kapë e shohë lajmet e mesnatës të njërit prej të pakëve që tregoi vëmendje për ngjarjen.

Qenë pamje që iu ngulitën menjëherë në kujtesë.

Ishte një avion i madh dhe elegant i linjës ajrore Swissair. Me një bark ngjyrë të murrmë, ndërsa mbi shtat, sipër, mbështillej me një fashë të bardhë në krem, aeroplani frenoi ngadalë, me një kujdes si të qe prej qelqi.

I kishte dhënë fund të gjithë operacionit të ndalimit, përfshi edhe kthesës në drejtim të një turme me pritës e gazetarë, kur drejt portës së tij rendi një makinë e bardhë si qumështi me mbi shpinë shkallë po aq të shndritshme. Novotni u shfaq në krye të tyre dhe menjëherë dy fëmijë, të cilët ngjanin si pionierë, me tufa lulesh në duar vrapuan për t'i dalë përpara sapo ai të shkelte në pistë.

Bashkë me ta nxituan edhe trumba e diplomatëve polakë. Dy prej tyre mbanin në duar nga një çadër të hapur.

Agjentët amerikanë me uniformat e tyre karakteristike të policisë si edhe detektivët me pardesytë e bardha të gjata krijuan menjëherë rrethin e sigurisë.

Kur Presidenti çek bëri me Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe të vetët shtrëngimin e duarve, dhjetë metra më larg, në të djathtë të tij, shkrepën hovshëm blicet e aparateve fotografikë të gazetarëve. Novotni u drejtua në të majtë, atje ku rrinin në pritje gjashtë mikrofone. Kur u vendos para tyre u dallua që pat veshur një pallto ngjyrë gri, të trashë.

Foli shkurt. Përmendi Republikën Socialiste Çekosllovaqe, paqen, çarmatimin, pastaj tha një urim për mbarëvajtjen e Sesionit të 15-të.

Vladislav Gomulka e dha konferencën e shtypit i dyti. Kishte veshur një pallto me ngjyrë të errët. Edhe syzet me numër të madh optik kishin sipër një rreth të zi.

Kryekomunisti polak foli pothuaj me të njëjtën formulë si kolegu i tij i mëparshëm. Nën dritat e projektorëve të vendosur enkas, ku gjithsesi blicet e fotoaparateve verbonin, në kronikë dukej qartë se ato çaste shiu i asaj mbrëmjeje të 18 shtatorit 1960 nuk qe bezdisës sa për t'i mbuluar Gomulkës kokën e paflokë.

Të nesërmen në mëngjes gazetat nuk e kishin kapërcyer dot me indiferencën e televizioneve ardhjen në Nju Jork të dy kryetarëve të vendeve komuniste. Qenë plot me të dhëna për jetët e tyre. Reis Malile u zhyt në leximin e kolonave të mbushura me të vërteta e mbase edhe thashetheme.

Dy të porsambërriturit që nuk kishin pëlqyer ardhjen e përbashkët me Nikita Hrushovin e vaporin sovjetik "Balltika", ishin bashkëmoshatarë. Vladislav Gomulka qe 54 vjeç dhe vetëm një më shumë Antonin Novotni.

Për Sekretarin e Parë të Partisë Punëtore Polake të përditshmet e atij mëngjesi përfllisnin se përherë kishte refuzuar ta bënte publike jetën e tij private, se qe shumë i

dhënë pas notit dhe volejbollit. Po ashtu edhe përkushtimit ndaj gruas së tij ruso-çifute.

Për Vladislav Gomulkën pothuaj të gjitha gazetat kryesore njujorkeze përpiqeshin të shfaqnin simpati të përmbajtur, duke shkruar se që i vetmi lider i vendeve satelite të Moskës, i cili ishte përballur me Hrushovin ndërsa njëkohësisht ishte edhe pushtetar i një kombi që bënte pjesë në Paktin e Varshavës.

Duke e pasur qendrën e aleancës së madhe ushtarake të vendeve socialiste në kryeqytetin e vet Gomulka, vinin në dukje vëzhguesit e shtypit, gjithsesi kishte pranuar ndihmat ekonomike amerikane.

“Sot është gjallë”, shkruanin tërë kërshëri, “vetëm për shkak të faktit se ishte në një burg polak kur Stalini në vitin 1937 likuidoi pjesën e mbetur të udhëheqjes komuniste të Polonisë”.

I shpëtuar, ndërsa shumica e udhëheqjes marksiste u asgjësua fizikisht, Vladislav Gomulka që shndërruar në një prej komunistëve polakë më të rëndësishëm dhe në vitin 1943 iu imponua Stalinit për të realizuar një formacion politik më liberal.

Kështu bashkësia e re mori emrin Partia e Punëtorëve Polakë.

Prej janarit deri në qershor 1945 Gomulka që në drejtimin e Qeverisë së Përkohshme dhe prej këtij qershori deri në vitin 1947 qëndroi në krye të kabinetit e Qeverisë së Përkohshme të Unitetit Kombëtar. Duke qenë një figurë e rëndësishme ai i ndihmoi komunistët të manipulonin rezultatin e dy votimeve: në 1946 të një referendumi popullor dhe një vit më vonë edhe të vetë zgjedhjeve politike.

Që prej këtij çasti ata mes partive konkurruese u bënë forca hegjemone. Personalisht edhe ai.

Në 1948, ndërsa ishte kryeministër dhe numri një i partisë, Stalini ndërhyri dhe njerëz të shtyrë prej tij e akuzuan për titizëm. I gjykuar si deviacionist nacionalist i djathtë Vladislav Gomulka u përjashtua nga partia dhe nuk i vonoi as arrestimi. Shpëtoi prej qelisë dhe u rehabilitua vetëm pas tri vitesh, kur u publikua raporti i Nikita Hrushovit kundër Stalinit.

Sërish qe emëruar i pari i partisë, por në këtë post aspak me dëshirë e pëlqim të të parit të Moskës. Hrushovi ndaj tij ishte mosbesues.

Gomulka menjëherë çeli rrugën e një reformimi të sistemit politik të vendit, duke realizuar një përzierje të komunizmit me nacionalizmin. Ishte një “rrugë polake” drejt socializmit. Kur 1956-ta solli në Hungari revolucionin ai e sfidoi vendimin kërcënues të Hrushovit për të dërguar trupa sovjetike në Budapest. Kështu u bë popullor mes polakëve, por edhe i njohur jashtë vendit, sidomos në Perëndim. Duke vepruar në një mënyrë të tillë, shkruanin gazetat njujorkeze të mëngjesit të 19 shtatorit 1960, Vladislav Gomulka “i siguroi kësisoj popullit të tij një sasi të konsiderueshme ndihmash ekonomike e reformash sociale”.

Ndërkohë ato që të gjitha i sqaronin lexuesit e tyre se kryekomunisti polak pesëdhjetë e katër vjeçar, tashmë nën trysninë e trupave ushtarake sovjetike brenda territorit të shtetit të tij, e pat zbutur sjelljen kundërshtuese ndaj Moskës. Kështu ai liberal qe shndërruar në një dogmatik të ngurtë dhe mospajtues i ashpër me gjithkënd që kishte frymë tolerante.

“Dikush nga bashkëpunëtorët e tij ka thënë dikur”, shkruante një e përditshme, “T’i kërkosh Gomulkës të jetë i arsyeshëm e të dëgjojë këshillat e të tjerëve, është njëlloj sikur t’i kërkosh ariut të sillet në mënyrë më të natyrshme”.

Për Antonin Novotnin gazetatat nuk qenë më pak të pasionuara të depërtonin në të fshehtat e jetës dhe të karrierës së tij. Vëmendja për të bëhej më madhe dhe kërshëria më e ndezur, sepse me emrin, në mos edhe me pjesëmarrjen e tij, lidhej misteri i vrasjes me varje i një udhëheqësi të mëparshëm të Partisë Komuniste Çekosllovake, Rudolf Slanskit.

Vetë Novotni, shpjegonin të përditshmet, bashkë me të porsashpallurin Valter Ulbriht të Gjermanisë Lindore, i papranishëm në atë mbledhje të Kombeve të Bashkuara sepse drejtonte një shtet që OKB nuk e njihte, ishte njëri nga vetëm dy udhëheqësit e kampit socialist që në të njëjtën kohë qenë kryetar partie dhe president i vendit. “Ai”, shkruante njëra prej gazetave, “të kujton thënien e famshme të Leninit për Molotovin: “Nëpunësi më i mirë në vend”.

“Novotni është një tuberkuloz kronik”, saktësonte po ajo e përditshme.

Në rreshtat për presidentin çekosllovak që të gjithë kronistët shpjegonin se në rininë e vet kishte qenë një punëtor i thjeshtë, madje çelësabërës.

Komunist ishte bërë që 17 vjeç dhe gjatë viteve të pushtimit nga fashistët gjermanë, për shkak të veprimtarisë së tij ilegale, në 1941 qe arrestuar dhe mbyllur në kampin e përqendrimit të Mathauzenit. Pat dalë prej andej vetëm në vitin 1945.

Çështja Rudolf Slanskit: manipulimi i mendjes së kundërshtarëve me meskalinë dhe aktevron

Gjer në 1951 kryetar i degës së Partisë Komuniste të Pragës këtë vit nis hovi i tij drejt postit më të lartë të saj. Pikërisht këtu fillonte prej gazetarëve amerikanë edhe depërtimi në enigmën e zhdukjes së Rudolf Slanskit.

Slanski ishte hebre. Në fillim të viteve njëzetë kishte qenë socialdemokrat, por pastaj qe bashkuar me komunistët. Shefi i tyre, Klement Gotvald, e pat marrë që në fillim nën kujdes. Ishte bërë lufta, pastaj çlirimi dhe deri në mbyllje të viteve dyzetë Rudolf Slansky, sipas gazetave amerikane tashmë sekretar i përgjithshëm i partisë, në shtator 1951 u kritikua ashpër dhe u dorëhoq.

Pas kësaj fushate të furtunshme kundër tij qe vetë Stalini. Ky ndihej i shqetësuar prej një prirjeje të ngutshme të vendeve dhe partive të tjera komuniste për të shpallur gjithsecila rrugën e vet kombëtare drejt komunizmit dhe kështu, po të tolerohej, ato do të dilnin njëra pas tjetrës nga kontrolli i Moskës.

Kanosja do të qe edhe më e madhe kur rrugët nacionale do t'i çonin vendet dhe partitë e tjera komuniste drejt afrimit me NATO-n. Pasi kishte kërcënuar dy partitë komuniste më të mëdha të Evropës Perëndimore, atë italiane dhe franceze, Stalini pat nisur një spastrim masiv të aparateve politike dhe administrative të vendeve satelite.

Procesi i parë kishte nisur në 15 tetor 1949, kur i akuzuar se pat bashkëpunuar me Titon, Vatikanin dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bashkë me një grup të tërë

politikanësh, u dënua për tradhti dhe u var në Budapest ministri i Brendshëm hungarez Laszlo Rajk.

Vetëm në 1956 Matias Rakoshi, atë kohë sekretar i Partisë Komuniste Hungareze, pranoi publikisht se ai proces gjyqësor kishte qenë i ndërtuar tërësisht mbi akuza false.

Në fushatën e pandalur të spastrimeve të dhunshme Rudolf Slanskin, pasi e shtrënguan të dorëhiqej, Stalini në fund të vitit 1951 urdhëroi Klement Gotvaldin ta arrestonte. Akuza që “agjent i Izraelit dhe i sionizmit”.

Me të si edhe me katërmbëdhjetë udhëheqës të tjerë të Partisë Komuniste Çekoslovake, prej 20 deri në 27 nëntor 1952, u zhvillua, i shoqëruar me propagandë ngulmuese, një gjyq i bujshëm. Çuditërisht mjaft prej të akuzuarve, mes tyre edhe Slanski, i pranuan të gjitha fajet. Madje ky i fundit, ndërsa konsiderohej si njeri i durueshëm dhe i papërkulshëm, ra dakord fare lehtësisht se kishte komplotuar me Izraelin dhe Amerikën për ta rrëzuar në Çekoslovakia komunizmin dhe risjellë kapitalizmin.

Slanski foli rrjedhshëm për një rrjet të tërë spiunazhi me të cilin kishte kontakt dhe nën detyrat e të cilit vepronte. Ai pranoi se me qëllim që postin e tij ta zinte vetë, kishte pasur si objektiv vrasjen me helmim të ngadalshëm të presidentit Gotvald.

Shumë pak ditë pas gjyqit, në 4 dhjetor 1952, të njëmbëdhjetëve që u dënuan me vdekje dhe u varën, iu dogjën trupat në mjediset e brendshme të burgut.

Hiri iu hodh në një thes patatesh. Pastaj një shofer, i shoqëruar nga dy agjentë të policisë së fshehtë, e transportoi thesin mbi karrocerinë e një kamionçine të mbyllur deri në periferi të Pragës.

Këtu, mbi rrugën e mbuluar me borë të ngrirë dhe akull, që rrotat e makinave apo këmbët e udhëtarëve ta merrnin me vete e të zhduknin çdo kokrrizë të hirit, e shpërndanë.

Pak vite më vonë, ende të habitur se si njeriu i paepur Rudolf Slanski si të qe pllakë gramafoni pat pranuar të gjitha akuzat e tmerrshme që iu ngarkuan, kuriozët morën vesh se ndaj atij dhe gjithë të dënuarve më pas me vdekje, u qenë përdorur disa ilaçe.

Këto i sillnin në gjendje euforie. Bashkë me dobësimin e rezistencës u shkaktonin aluçinacione si edhe pështjellim e ngatërrim të asaj çfarë mendonin. Kështu çuditërisht me një kujtesë të shkëlqyer recitonin fjalë për fjalë çfarë u kishin përgatitur policët çekosllovakë, gjithnjë të prirë prej ekspertëve rusë.

Këto mjete manipuluese të mendjes njerëzore quheshin meskalinë dhe aktevron. Mjeku që mbi ta i kishte përdorur, thirrej me emrin Sommer.

Atë mëngjes të 19 shtatorit një nga të përditshmet njujorkeze bënte të ditur se Antonin Novotni disa vite më pas nga ngjarja makabre e kishte pranuar se gjithçka që në burg e në procesin gjyqësor ishte përdorur kundër Rudolf Slanskit pat qenë e gabuar dhe e fabrikuar.

Vjen Hrushovi

Ishte mëngjes i vonë i 19 shtatorit kur Reis Malile dhe tetë punonjës e bashkëpunëtorë të Misionit Shqiptar, aq sa në takimin koordinues me gjeneralin Zaharokin qe vendosur si numër pjesëmarrësish prej secilit vend socialist, ndërsa binte një shi i dendur, u gjendën në një hapësirë portale afër selisë së Kombeve të Bashkuara.

Ardhjen e vaporit “Balltika” do ta pritnin aty. Skela ishte jo shumë e përshtatshme, madje sovjetikët ato ditë jo vetëm për të thelluar ujin, por mbi të gjitha sepse hangari ku të porsaardhurit do t’i pritnin qe shumë i vjetër dhe në gjendje pothuaj të braktisur, patën bërë tridhjetë mijë dollarë shpenzime.

Megjithatë edhe pas riparimeve rrangalla mbeti po e njëjtë. Sërish qe një humbëtirë me dritare të shumta ku pothuaj gjithë xhamat ishin të thyera. Nëpër shinat e hekurta që kryqëzoheshin për të mbajtur çatinë, e cila në shumë vende pikonte, Malile dalloi edhe rrjeta merimangash.

Pak minuta më vonë nga mbërritja e grupit shqiptar erdhën edhe titullarët e përfaqësive të tjera të vendeve socialiste, të gjithë të shoqëruar nga stafet. Shumica e diplomatëve komunistë ndenjën afër njëri-tjetrit, gati të formonin një grup të madh radhëngjeshur.

Pritja e Nikita Hrushovit dhe e katër udhëheqësve të tjerë të kampit duhej kryer në mënyrën më entuziaste të mundur. Që këtë çast duhej të niste mësymja e tyre mediatike, tërheqja e të gjithë vëmendjes së opinionit publik.

Kur vapori i madh sovjetik u duk i tëri i bardhë, dhe mbi ujërat e oqeanit mori drejtimin për nga moli i vjetër, u dëgjua t'i binte sirenës disa herë.

Në fillim pranë bashit i qe avitur anija pilot, por pas pak përreth saj u shtuan edhe tri barka. Me sa mund të shihje me sy të lirë, në njërën nga to, edhe kjo e lyer me ngjyrë të bardhë, gjendej një grumbull i ngjeshur simpatizantësh të Fidel Kastros. Ata tundnin duart, flamujt kubanë dhe bashkë me mjaft beze parullash mbi trupin e anijes, gjatë gjithë gjatësisë së saj, patën varur edhe një shumë të madhe.

Në të ngriheshin njëmetërshe fjalët “Kastro është zëri i Kubës”.

Kur atë mëngjes po hynin në port, Reis Malile pat parë një grumbull tjetër kubanësh, por ata qenë kundërkastristë dhe me siguri bëheshin gati ta pritnin me protestë. Qenë pak dhe me parulla të vogla në duar, ndërsa shkëmbeheshin me njëri-tjetrin, në një ec e jake mbi buzët e një ure kalimtarësh.

Tek vinin për në mol, diplomatët shqiptarë patën ndeshur edhe një grumbull më të madh protestuesish, por ata qenë emigrantë hungarezë të arratisur në SHBA që prej vitit 1956, dështimit të kryengritjes së tyre antikomuniste.

“Balltika” u ra sërish bujshëm sirenave. Vapori i madh me katër kate kabinash dhe sallah çlodhjeje, u afrua shumë dhe brenda hangarit, ndërsa shiu që binte jashtë lëshonte edhe aty çurgje uji, disa gra të Misionit të Përherëshëm Sovjetik me fshesa nëpër duar përpiqeshin të mos lagej një qilim i madh i kuq, i bërë gati të shtrihej deri tek fundi i shkallëve të vaporit, në pritje ta shkelnin mbi të Nikita Hrushovi dhe liderët e tjerë.

Reis Malile një moment u bë i vëmendshëm të shihte nëse kishte mbërritur në hangar ndonjë person apo grup i vogël

përfaqësuesish prej qeverisë amerikane apo edhe nga bashkia e Nju Jorkut.

Nuk gjendej asnjë.

Pikërisht këtë çast iu afrua ambasadori i Çekosllovakisë. Dukej i qeshur. I tha gëzueshëm dhe në sy të të gjithë drejtuesve të tjerë: “Nesër kur të mbërrijë shoku Mehmet në Nju Jork, në pritje do të vij unë dhe ministri i Jashtëm, shoku David. Nuk do të ketë mundësi të jetë vetë shoku Novotni për arsyet e vështira të sigurimit”.

Malile e falënderoi. Diplomati i parë çekosllovak e pati shqiptuar deklaratën e tij enkas që ta dëgjonin të tjerët dhe kjo do të thoshte se me këtë rast kishte bërë të ditur nivelin protokollar me të cilin vendi i tij do të vlerësonte kryeministrin shqiptar.

Kur “Balltika” iu avit njëqind metra molit, që prej bregut rendi drejt saj një barkë e vogël sportive e gjatë jo më shumë se tre metra. Vozitej me lopata nga dy njerëz. Ishin me moshë të re. Të tendosur mes trupave të tyre mbanin të shtrirë një banderolë plot shkronja.

Qenë antikomunistë.

Dhjetë minuta më pas vapori sovjetik, duke u lëkundur nga dallgët, më në fund ishte takuar me buzën e molit. Largësia prej hyrjes së hangarit deri tek shkallët zbritëse nuk qe më shumë se pesë metra. Ishte ky moment kur gratë e Misionit Sovjetik e shtrinë qilimin e kuq deri tek shkallarja e fundit, por nga që “Balltika” lëkundej fort, tendosja e tij prishej, rrudhej dhe ato i riktheheshin rregullimit për ta harmonizuar sadopak me trazimin e papërmbajtur të anijes.

Sipër në kuvertë tashmë pat dalë grumbulli i të ardhurve dhe mes tyre, duke bërë gjeste entuziazmi, vetë Hrushovi.

Qe veshur me një pardesy të bardhë dhe kjo, duke e bërë më të dallueshëm prej të tjerëve, ia theksonte edhe më shtat ultësinë.

Tek përshëndeste, dorën e djathtë e tundte shumë shpejt, veç çuditërisht pa lëvizur krahun. Shkundte vetëm pëllëmbën.

Duke zbritur njëri pas tjetrit e herë pas here, nga që “Balltika” vazhdonte të tundej, pas parmakëve të shkallëve, gjashtë udhëheqësit komunistë dhe pas tyre delegacionet, deri sa hynë në hangar shiun e përballuan me kapelat borselino që kishin rrasur në kokë.

Grumbulli i diplomatëve të kampit socialist si edhe policët me detektivët e shumtë amerikanë, mes tyre edhe agjentët sovjetikë për sigurinë fizike, tanimë kishin hapur në mes të tyre një rrugëkalim të mjaftueshëm për të ecur lirshëm të porsaardhurit.

Konferenca e shkurtër e shtypit do të jepej në anën tjetër të hangarit, në prag të portës së madhe të daljes.

Duke shkuar deri atje Hrushovi hoqi dhe ia dha pardesynë njërit prej ndihmësve. Para gazetarëve, fotoreporterëve dhe kamerave u paraqit me një kostum të zi, dukshëm i porsa qepur. Me pëllëmbën e majtë u përpoq të mbante njëherësh kopsën e mesit të xhaketës dhe dy fletët ku ishte shkruar fjala që do të shqiptonte.

Për pak sekonda e tundi në ajër pëllëmbën e djathtë dhe më në fund foli. Pesë minuta më pas, i vënë në mes nga shumë agjentë të veshur me pelerina të errëta dhe detektivësh me pardesy të bardha, që të gjithë tashmë të kapur përdore dhe aq shtrënguar sa çdo agresor fizik do ta kishte të pamundur të çante rrugë deri tek Sekretari i Parë i Partisë Komuniste Sovjetike, hipi në një limuzinë të madhe, të blinduar e mjaft elegante.

Qe makina e tij “Cadillac”.

Reis Malile dhe të tjtë dolën nga porti dhjetë minuta më vonë. Në buzë rrugë këtë herë bashkë me protestuesit rusë, hungarezë dhe polakë, që dalloheshin prej çfarë kishin

shkruar në banderolat e tyre, panë edhe shqiptarë. Nuk qenë pak, rreth pesëdhjetë.

Si të gjithë edhe ata ishin mjaft të acaruar edhe pse Hrushovi me kohë qe larguar. Akoma, mbase thjesht për inerci, e gjithë turma e madhe tundte parullat. Shumica kishin të shkruar tekstin “Hrushovi është një vrasës”.

Më e madhja e tyre, e cila kishte të vizatuar fytyrën plot faqe të kërcyera të Nikitës, bashkë me siluetën e një drapri me çekan, thoshte: “Vrasës, thyej qafën!”

Dikush tundte një fletë kartoni me fjalët “Mos i prisni në port kriminelët!”, kurse dy hungarezë ndernin përpara makinave që u kalonin pranë, bezen me thirrjen “Vrasës, ju keni pushtuar atdheun tonë!”

Ftohtësi e “kampit socialist” në pritje të ardhjes së Mehmet Shehut

Ndërsa kthehej për në seli Reis Malile u bë më i vëmendshëm për të vëzhguar masat e sigurisë në Manhattan. Gazetat me kohë kishin folur që në momentin e zbarkimit të Nikita Hrushovit dhe të delegacioneve të vendeve të tjera komuniste, ditë e pangjarë deri atëherë në qytetin e madh amerikan, do të qenë në shërbim sigurie tetë mijë njerëz.

Tani ai po dallonte qartë jo vetëm patrullat e shumta nëpër pikat kyçe, por edhe me vendosjen e snajperëve mbi lartësitë kryesore.

Kur mbërriti në Mision bashkë dhe diplomatët e tjerë nisën menjëherë të bënin lajmërimet telefonike për secilën përfaqësi të kampit socialist. U rikujtuan se ashtu siç edhe u kishin bërë të ditur në dy takimet e mbajtura në selinë e Misionit Sovjetik, kryeministri Mehmet Shehu do të mbërrinte në Nju Jork me vaporin “Queen Elizabeth” të nesërmen, 20 shtator, në mëngjes.

Duke qenë se policia amerikane në rastin e pritjeve të mëdha publike u kishte kërkuar numrin e përzgjedhur të pjesëmarrësve, diplomatët shqiptarë iu lutën kolegëve t’u bënin të ditur se sa dhe cilët do të vinin prej përfaqësive mike.

Të gjithë premtuan me mirësjellje se të dhënat do t’ua sillnin tepër shpejt dhe kështu nuk do t’i pengonin aspak që pastaj të kishin kohën e mjaftueshme për t’ia dërguar listën policisë lokale.

Mirëpo të gjitha orët e pasdites kaluan një nga një, më në fund ra mbrëmja, por kurrkush nga Misionet e vendeve socialiste nuk u bë i gjallë.

Kur akrepat e orës e patën kapërcyer cakun e shifrës njëzetë dhe Reis Maliles, i cili ndërkohë që ulur në vendin e tij në sallën e madhe të punimeve të Asamblesë së OKB-së, ato çaste në një seancë të jashtëzakonshme me temën e gjendjes në Kongo, iu avit ambasadori i Bullgarisë Çobanov.

E pyeti se cilin nga drejtuesit e vendeve socialiste të mbërritur tashmë në Nju Jork kishin menduar të ftonin për të marrë pjesë në pritjen e kryeministrit Mehmet Shehu. Malile iu përgjigj se për këtë nuk mund të vendoste ai, por palët mike. Përsëriti sjellshëm se përfaqësia shqiptare thjesht u njoftonte datën dhe orën e mbërritjes së vaporit. “Për të dërguarit tuaj vendosni siç ta shihni të arsyeshme”, përsëriti kur te kolegu një çast kur vuri re se po ndihej në një pozitë të vështirë.

Dukej që të gjithë atë gjest afrimi e kishte kryer për t’i pohuar tërthor se po të ndodhte ndonjë gjë e papëlqyeshme nuk do të që me siguri as faji dhe as përgjegjësia e tij. Për ta bërë më të qartë këtë pozicion të sikletshëm Çobanovi nguli këmbë se atë çështje të emrave pjesëmarrës në ceremoninë e pritjes së Mehmet Shehut duhej ta shihnin më mirë së bashku, që ato momente.

“Çfarë propozoni ju”, pyeti menjëherë, “A mendoni për shembull se duhet të ftoni shokun Zhivkov ta presë?”

Malile i pati ngulur sytë si të që në kërkim të një mënyre për ta kuptuar më mirë Çobanovin se ku donte të dilte. Pastaj iu përgjigj: “Unë nuk mund të marr dot guximin të ftoj shokun Zhivkov ose ndonjë personalitet tjetër. Kjo gjykohet nga secili delegacion. Ju lutem vendoseni vetë!”

E megjithatë ambasadori bullgar nuk u tërhoq. Tha: “Nga ana ime unë mendoj se shoku Zhivkov dhe shokët e tjerë

drejtues duhet të dalin ta presin shokun Mehmet. Ai është udhëheqësi i një populli mik dhe ne duhet t'u tregojmë perëndimorëve respektin që kemi për të gjithë miqtë, pavarësisht se përfaqëson një vend të vogël ose të madh". Një grimë më pas shtoi: "Sepse po qe se nuk do dalin, do të lihet përshtypja sikur midis nesh ka mosmarrëveshje".

Çobanov dukej shumë i sinqertë, megjithatë Reis Malile i përsëriti formulën tashmë të bërë gati dhe të pandryshueshme: Ishte një çështje të cilën secili delegacion duhej ta vendoste vetë.

Ambasadori bullgar u largua me një buzëqeshje pezmatimi dhe një ndjenje faji që dukej sikur i kishte mbetur padëshirueshëm në anë të buzëve. Ikte nëpër sallë dhe ngjante me një të kërrusur.

Përreth vazhdonte debati i jashtëzakonshëm për gjendjen në Kongo. Mjaft pjesëmarrës ende nuk kishin folur dhe Malile e dinte se orët e polemikës së nxehtë nuk do të fashiteshin as pas mesnate.

Kur në sahatin e tij të dorës u shënua 23.00 u ngrit nga vendi dhe për të çmpirë pak çaste trupin doli në hollin e madh. Tek dilte vështroi shkarazi nga kolegët e vendeve socialiste dhe vuri re që ata qenë aty, gjithsecili me vëmendjen në tribunën e sallës.

I dalloi të lëviznin e të takonin njëri-tjetrin vetëm pak çaste para mesnatës. Me sa dukej po këshilloheshin.

Dhjetë minuta më vonë dolën nga salla të gjithë bashkë. Kjo donte të thoshte se do të bënin një mbledhje. Përderisa nuk e ftuan edhe atë, tema e të porsa grumbulluarve duhej të qe ajo e pritjes protokollare kur të vinte "Queen Elizabeth".

Reis Malile priti kur në hyrjen e sallës së Asamblesë të rishfaqej i pari prej kolegëve, por pas kësaj iu desh të duronte edhe një gjysmë ore. Ata hynë ashtu siç edhe dolën, në grup. Ishte vetëm bullgari Çobanov që u shkëput

dhe iu afrua. Qe flak i kuq në fytyrë. Tha: “Nga ana jonë në pritjen e shokut Mehmet do të vij unë dhe këshilltari i Misionit”.

Reis Malile e pa ngulshëm në sy. Iu përgjigj me një “Faleminderit!” të ngurtë, vetëm duke përplasur buzët. Kolegu bullgar në të vërtetë po e ndihmonte të kuptohej se çfarë po luhej.

Ndërsa ambasadori bullgar tashmë qe kthyer e ulur në vendin e tij brenda një duzine minutash titullarët e tjerë të Misioneve të kampit socialist erdhën një nga një dhe e vunë në dijeni për personat që të nesërmen në mëngjes, ndërsa në port do të hynte transatlantiku anglez, do të qenë në ceremoninë e pritjes së kryeministrit shqiptar.

Nga sovjetikët do të ishin të dy zëvendës përfaqësuesit e përhershëm në OKB Morozov dhe Mironova, nga çekët ministri i jashtëm David dhe përfaqësuesi i përhershëm, nga polakët zëvendës përfaqësuesi i përhershëm dhe nga delegacionet e tjera të vendeve socialiste përfaqësuesit e parë dhe zëvendësit e tyre.

Shoqëruesit me pistoleta në brez të Fidel Kastros

Çfarë kishte ngjarë me Fidel Kastron dhe njerëzit e tij Reis Malile e mori vesh vetëm kur Sekretari i Parë i Misionit i tërhoqi një çast vëmendjen çfarë po shihej në ekranin e aparatit televiziv të vendosur në sallën e pritjes.

Qe ora dhjetë e natës.

Lajmet thoshin se revolucionari kuban kishte braktisur hotelin “East Side Shelburne” dhe pasi me karvanin e makinave të tij, ku numëroheshin plot 85 vetë, pat parakaluar pothuaj gjithë Manhattanin, qe paraqitur tek një bujtinë tjetër: “Thereza”.

Gjatë kësaj ndodhie, kur po braktisnin hotelin, kishte ndodhur një përplasje fizike e truprojave të Kastros me policinë amerikane.

Një komentator sapo qe shprehur se çfarë pat ngjarë, po shtonte gjithandej fryrjen e thashethemeve se kjo do të përbënte, gjatë kohës së qëndrimit në Nju Jork, edhe vetë strategjinë e sjelljes së Fidel Kastros.

Nuk ishte aspak shenjë e mirë për rendin publik në qytet që grupi i rojeve fizike të tij, plot pesëmbëdhjetë vetë, nuk kishte pranuar tua linte në dorë autoriteteve amerikane sigurinë e shefit. Ata qenë të gjithë të armatosur. Madje me revole në brez dhe një puro të madhe në gojë ishte parë duke ikur nga “East Side Shelburne” edhe vetë Fidel Kastro.

“Faleminderit që më informove”, i tha Malile vartësit të tij, “Në mundesh ndiqi zhvillimet më tej!”

Vjen Tito

Atë natë që tashmë i përkiste 20 shtatorit, Reis Malile gjumin e paktë ia rrëmbeu një dremitje plot ankth. Kur u ngrit nga shtrati dhe pa në pasqyrë sytë e paqetë, me atë përskuqje të turbullt pagjumësie në thellësi të tyre, e para gjë që i shkoi ndër mend ishte t'i dërgonte një teleks Tiranës.

Mbase ashtu edhe e lehtësonte sadopak brengën që po e mundonte që prej çastit kur kolegët e vendeve mike i bënë sfidën me nivelin e ulët protokollar të pritjes së Mehmet Shehut.

Por një çast më pas ndërroi mendje. Do t'ia niste telegramin qendrës pasi të ndodhte pritja, pra porsa akti i shpërfilljes të kryhej.

“Queen Elizabeth” do të anorohej në port në orën tetë të mëngjesit. Detyrimisht Reis Malile bashkë me të vetët duhej të ndodhej atje që një orë më parë. Punëtorët amerikanë të shkarkim-ngarkimit prej disa ditësh qenë në grevë dhe atij i duhej të organizonte zbarkimin e bagazheve të Mehmet Shehut dhe të tjerëve.

Qe ora gjashtë e mëngjesit dhe tek u fut në zyrë gjeti mbi tryezë tufën e gazetave të ditës. E kishte dhënë porosinë vetë të bliheshin aq herët. Duhej ta njihte mirë situatën mediatike, sepse kryeministri mund të pyeste.

Të gjithë titujt e faqeve të para bënë fjalë për ardhjen e Nikita Hrushovit. Thuhej gjithkund se ai qe pritur në mënyrë të trishtueshme, nga pak njerëz, që të gjithë vetëm përfaqësues të vendeve të kampit socialist. Nëpër faqet e para kishte mjaft foto që dëshmonin protestën kundër tij.

“Xhelat gjakpirës” shkruante një nga banderolat e nxjerrë në plan të parë nga disa gazeta njëherësh.

Përreth zyrave të mëdha të Misionit Sovjetik, informonin të përditshmet, për ta mbrojtur Hrushovin nga ndonjë e papritur, me dyqind policë njujorkezë ishte krijuar një unazë e hekurt sigurie. Para godinës dhe në të gjitha rrugët e bërrylat e tyre ndodheshin shumë makina dhe motoçikleta policie. Lëviznin në ec e jake kalorës.

Të gjithë qenë armatosur mjaft rëndë.

Ndërsa kishte parë këtë gjë, disa gazetarë shkruanin se kryeministri sovjetik qe inatosur shumë dhe e kishte akuzuar qeverinë amerikane se me pretekstin se e mbronte, në të vërtetë ia kufizonte të gjitha lëvizjet.

Të përditshmet harxhonin edhe disa hapësira vëmendjeje për Josip Broz Titon.

Presidenti jugosllav vlerësohej i mirëseardhur, i dëshiruar madje.

Më në fund diku, futur nëpër rreshta të ngushtë e germa të vogla, thuhej se me “Queen Elizabeth” pritej të vinte edhe kryeministri i kuq i Shqipërisë Mehmet Shehu.

Një kolonë e shkurtër lajmesh në një nga gazetat shkruante se në të vërtetë komunistin e njohur shqiptar e kishin pritur të qe një ditë më parë në listën e pasagjerëve që zbarkonin nga vapori “Balltika”, por atje pat munguar. Sot pritej të mbërrinte në Manhatan si një pasagjer i zakonshëm i anijes me emrin e mbretëreshës britanike Elizabet.

Kur pati përshtypjen se faqet e para dhe ato në brendësi që lidheshin me delegacionet ardhëse për të marrë pjesë në punimet e Sesionit të 15-të të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, i pat kontrolluar me vëmendje, vështrimi befas i ngriu në një titull.

Ai thoshte se përfaqësitë e Misioneve të vendeve socialiste në ceremoninë e pritjes së kryeministrit shqiptar Mehmet

Shehu e kishin ulur shumë nivelin e tyre të përfaqësimit, çfarë dëshmonte edhe njëherë tjetër për ato që akoma përfliteshin se po ndodhnin në marrëdhëniet e tensionuara mes Tiranës dhe Moskës e ku gjendej e pleksur edhe Partia Komuniste e Kinës.

Reis Malile u ngrit nga poltroni dhe bëri nga dritarja. Jashtë binte shi. Qetësisht. Sikur të kishte një shekull të tërë që nuk pushonte.

Vështroi një kohë hapësirën e paanë, atje ku ndërtesat e mëdha të lagjes Manhattan bënin lart sikur të donin të preknin qiellin.

Nuk e kishte dashur këtë përfolje të shtypit. Deri ato çaste autoritetet amerikane për të gjitha delegacionet nga vendet socialiste qenë munduar të krijonin në opinionin publik përshtypjen se në Nju Jork po vinin njerëz jo vetëm të padëshiruar, por edhe të rrezikshëm.

Ndërkaq me Shqipërinë fushata e sulmit pat qenë më agresive, gati sikur vendin e tyre të vogël, tashmë të zënë edhe me një polemikë me Nikita Hrushovin, ta veçonin si rast që vepronte në të kundërt të vetë objektit që kishte Organizata e Kombeve të Bashkuara: paqes në botë dhe uljes së tensionit ndërkombëtar.

Të gjithë këtë mbrapshti tashmë nuk e kishin kryer vetëm amerikanët, por me qëndrimin e tyre protokollar në pritjen publike të Mehmet Shehut e patën nxitur edhe vendet socialiste mike.

Reis Malile i ktheu shpinën pamjes së Manhatanit dhe doli në sallonin e selisë. I gjithë personeli ndodhej aty, në pritje të iknin sa më shpejt në port.

Kur mbërritën këtu rrugët qenë ende me trafik të durueshëm. Nuk dalluan as grumbullim njerëzish para Misionit të tyre. E pritnin një demonstratë. Nga organizatorët ishte premtuar se do të kryhej kur Mehmet Shehu do të zbriste në Nju Jork.

Në mol agjentët dhe detektivët lokalë qenë mizëri.

Sipas autoriteteve portale, i pari që do të zbriste ishte Josip Broz Tito. Pasi të përfundonte konferencën e shkurtër për shtyp e të largohej me karvanin e tij të makinave, para mikrofonave do të afrohej kryeministri shqiptar.

Reis Malile e hodhi vështrimin në qiell: retë ende kishin plot shi për të zbrazur.

I pari nga përfaqësuesit e huaj që mbërriti dhe u drejtua për t'i dhënë dorën, qe ministri i Jashtëm çekoslovak David. Prej sovjetikëve pak minuta më vonë do të avitej për të kryer të njëjtin rit Përfaqësuesi i Përhershëm i Misionit. Pastaj u afrua ai rumun.

Bullgari nuk vonoi, madje i bëri një shtrëngim të ngrohtë dore.

Polaku e mori me nge, po ashtu nuk u ngut as hungarezi. Shefi i Protokollit të Kombeve të Bashkuara në fillim përkuli kokën, pastaj fare lehtësisht gjysmën e sipërme të trupit.

Papritur u ndje një trazim i turmës së madhe të pritësve. Po zbriste shkallët e “Queen Elizabeth” Tito.

Ecte me hap të ngadaltë e të sigurt, si të vinte në shtëpinë e tij.

Sapo la shkallaren e fundit rojet amerikane të sigurisë e vunë në mes.

Deri sa e shoqëruan tek tufa e mikrofonave u treguan me të shumë të vëmendshëm, por jo ndërhyrës. Dukej qartë: më tepër e ruanin për të dëshmuar nivel të lartë protokolli se sa për ta mbrojtur prej ndonjë kanosjeje reale të jetës. Përballë mikrofonave numri i gazetarëve pjesëmarrës, veçanërisht i fotoreporterëve, qe shumë i madh. Gumëzhinin.

I hodhën blice drite që nuk donin të reshtnin.

Pas një pauze fare të shkurtër, i veshur me një kostum të zi mjaft elegant, Tito shqiptoi vetëm pak fjalë: “Erdhëm në

Amerikë që në Kombet e Bashkuara të paraqesim qëndrimet tona në lidhje me çështjet e ndryshme ndërkombëtare, të cilat sot e shqetësojnë botën dhe që me vullnetin e dëshirën më të mirë të kontribuojmë për zbutjen e gjendjes shumë të acaruar”.

Zbret në Nju Jork Mehmet Shehu, 20 shtator 1960

Mehmet Shehu bashkë me njerëzit e tij i zbriti shkallët e transatlantikut britanik jo vetëm kur Tito me delegacionin e vet u kishin hipur makinave dhe qenë larguar, por edhe kur qe fashitur kurioziteti për të.

I veshur edhe ai me kostum të zi, me syze me rreth të errët, hijerëndë, fjalët e domosdoshme para gazetarëve i shqiptoi shkoqur, ndarë thekshëm prej njëra-tjetrës: “Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë çmon se Sesioni i 15-të i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara që fillon sot, ka rëndësi të madhe për vetë organizatën si edhe për marrëdhëniet ndërkombëtare në përgjithësi. Ai mblidhet në një periudhë tensioni të ashpër. Popujt kanë shpresë se Kombet e Bashkuara do të mënjanojnë rrezikun e luftës bërthamore dhe do marrin masa efektive për të garantuar paqen dhe sigurimin ndërkombëtar. Pikëpamje e jonë është se në kohën e sotme çarmatimi mbetet problemi kyç. Në rast se i vihet fre garës së armatimeve dhe arrihet një marrëveshje mbi çarmatimin e përgjithshëm e të plotë ne mendojmë se jo vetëm kërcënimi i luftës do të mënjanohet, por do të çelet rruga edhe për zgjidhjen gradualisht me anë të bisedimeve të problemeve të tjera të mëdha që preokupojnë njerëzimin dhe Kombet e Bashkuara”.

Mehmet Shehu e ndërpreu një çast të folurën. Drita e bliceve të aparateve fotografikë vazhdonte t'i binte butë në fytyrë. Ndjente freski mbi lëkurën e fytyrës, madje edhe aromën e myshkut të ujërave të oqeanit.

Hodhi sytë në qiell.

Ishte i mugët, por retë e ngarkuara me shi iu dukën të shkrifëta, tamam krijesë fushash. Retë e vendit të tij qenë të sërta, të lindura prej maleve.

Uli sytë mbi dy fletët e shkruara dhe vijoi të fliste. Kur i erdhi radha paragrafit të fundit bëri kujdes ta shqiptonte më qartas: “Republika Popullore e Shqipërisë, besnike ndaj politikës së saj paqësore...do të përpiqet që punimet e këtij Sësoni të mbahen në përputhje me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe që marrëdhëniet mes shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore të zhvillohen mbi bazën e parimeve të bashkekzistencës paqësore”.

Tha edhe diçka tjetër, një gjysmë frazë, e cila në çastin që sapo e shqiptoi, iu duk e panevojshme.

Pastaj nxitoi të hynte në makinën e caktuar për të. Agjentët policorë dhe detektivët e mbanin të rrethuar ngushtë.

Sapo delegacioni shqiptar i futur në autokolonën e katër automobilave dhe nën ruajtjen e detektivëve dhe policëve, gjashtë prej të cilëve hipur në motoçikleta, qe duke dalë nga porti, një grup njerëzish të grumbulluar rrëmujshtëm lëshuan thirrmenë e zgjatur “uuuuuu!”

Për aq sa Reis Malile dalloi, qenë protestues të porositur dhe klithmën ia lëshonin çdo delegacioni që vinte prej vendeve komuniste. Nuk iu duk, për aq sa vetëtimthi u mundua të fiksonte, se mes tyre kishte ndonjë prej të arratisurve të njohur shqiptarë.

Ajo që pritej atë mëngjes të 20 shtatorit iu shfaq para syve kur kolona e katër veturave zyrtare, e ndryrë në mes nga makina policie dhe motoçikleta, hyri në autostradë. Në buzë rrugë i prisnin dy grumbullime protestuesish të organizuara mirë.

Ndodheshin jo afër njëra-tjetrës, por që u acaruan njëlloj sapo i dalluan ardhësit.

Të parët që ndeshën në rrugëkalim qenë bashkëkombës. Disa parulla i kishin shkruar në anglisht dhe të tjerat në

shqip. Kur katër makinat e delegacionit u kaluan afër nisën të lëshonin thirrma të forta. Me vështirime të ngulmëta e kërkonin kryeministrin në makinën e parë, ku qenë të sigurt se ndodhej, por ndërkohë nuk mund ta dallonin dot. Automobili i kishte xhamat të mbuluara me perde.

Vetëm kur i lanë pas Reis Malile dalloi se pranë protestuesve antikomunistë, gjithsesi të veçuar, gjendeshin edhe një duzinë prej miqve të tyre. Pankartat që ata mbanin varur në gjokse, uronin mirëseardhjen e Mehmet Shehut dhe i dëshironin të kishte sukses në ditët e tij të punës në Nju Jork.

Turma e dytë në preh të së cilës ranë, qe me grekë.

Në parullat e kartonta ishin shkruar me germa të mëdha fjala Vorio Epir, diku tjetër fjalia se ato qenë toka helene dhe se regjimi komunist i Tiranës i pat pushtuar me dhunë.

Një pankartë e madhe me shkronja në forma mjaft të parregullta thoshte se ato troje duheshin çliruar e bashkuar me atdheun e tyre mëmë. Një banderolë e gjatë thoshte se në Shqipëri vorioepirotëve u shkeleshin të gjitha të drejtat njerëzore.

Në skajin fundor të turmës dy parulla afër njëra-tjetrës thoshin se me shtetin e Enver Hoxhës dhe të Mehmet Shehut duhej mbajtur ligji i luftës.

Pak sekonda më vonë grumbullin e demonstruesve grekë e kishin lënë pas.

Tashmë të katër makinat e delegacionit qenë futur pranë godinës shumëkatëshe ku ndodhej edhe rezidenca e Misionit shqiptar. Reis Malile doli nga vetura e vet dhe bëri përpara, atje ku nga limuzina do të dilte Mehmet Shehu. Iu gjet afër kryeministrit sapo truproja amerikane i hapi derën.

Po ngjitnin shkallët e hyrjes së godinës kur një nga vartësit iu afrua dhe i pëshpëriti në vesh. Reis Malile ktheu kokën vrullshëm dhe u shtang.

Përtej perimetrit rrethues të selisë, saktësisht atje ku pak çaste më parë kishte protestuar grumbulli i grekëve, pat nisur një përleshje e madhe mes tyre dhe shqiptarëve.

Nga sa mund të dallohej qe shumë e dhunshme.

Njerëzit ndesheshin trup me trup dhe goditnin me çfarë gjëje kishin në dorë. Dukej sikur gjithsecili donte t'i merrte jetën tjetrit. Klithmat më të dhimbshme e thirrjet më të forta ndiheshin deri aty, ku ndodhej delegacioni.

Një çast Maliles iu duk sikur edhe Mehmet Shehu ndjeu diçka dhe ktheu kokën.

U mundua ta ndiqte nga pas pa i lënë të kuptonte se ndërkohë jashtë po zhvillohej një ngjarje që mund të bëhej lakmi e gazetave dhe për pasojë edhe e problemeve për imazhin e Shqipërisë. Pak sekonda më vonë, sapo gjeti një grimë tjetër mundësie, Malile ktheu kokën për të riparë çfarë po ndodhte në sheshin para godinës.

Përleshja vijonte po aq e dhunshme.

Tani dukeshin njerëz të rrëzuar përdhe dhe shumë makina policie që vinin në ndihmë të kolegëve të tyre. Hynin mes dy turmave dhe përpiqeshin t'i ndanin, t'i largonin nga njëri tjetri të kacafyturit e të kapurit grykë më grykë, t'u hiqnin gjithçka që mbanin nëpër duar, veçanërisht ombrellat.

Kur hipën në ashensor ajo që ndodhte ende jashtë u duk si e ngjarë në një planet tjetër.

Në dhomat e Misionit Mehmet Shehu u mbyll menjëherë në apartamentin e tij dhe porositi t'i trokitnin vetëm kur të vinte koha për të drekuar. Reis Malile e kishte informuar ndërkohë se restoranti qe brenda godinës së madhe dhe atje për të gjithë delegacionin do të mjaftonin dy tavolina.

Në njërën do të rrinte kryeministri, ministri i jashtëm dhe përkthyesi.

Në tryezën e dytë do të uleshin për të ngrënë bukë tre njerëzit e tyre të sigurisë dhe të zbulimit politik.

U mblodh me veten në zyrën e tij edhe Reis Malile.

Mendimet që u lëshuan mbi të, si re të ulëta të një qielli të ngarkuar me rrebesh të rëndë shiu, qenë aq të shumta sa e pengonin të kthjellohej. Mes atij kaosi të tyre rregullin e vuri ngadalë, me shumë mundim. Më në fund kishte zgjedhur njërin, mbi të cilin duhej të ngulmonte: grekët dhe gazetatat e tyre gjatë gjithë atij viti.

Në shtypin amerikan njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjeta, ku ngjarja më kryesore për dukshmërinë e Shqipërisë do të qe vetëm ai Sesion i 15-të i OKB-së, për nëntë muaj me radhë kishte qenë i zbrazët. Për çfarë ndodhte në Tiranë duke u mbyllur dimri ishte kujtuar vetëm një gazetë e vogël lokale. Pati botuar një shkrim për tekstin e historisë së Shqipërisë.

Ky sapo qe publikuar dhe dreqi e dinte se si mijëra kilometra larg i kishte rënë në sy asaj të përditshmeje province me tirazh të ulët.

Reis Malile megjithatë ngjarjen ia kishte raportuar menjëherë qendrës. Me sa mbante mend në ato faqe që i dërgoi me postë të mbyllur, nga gazeta e vogël kishte veçuar komentin ku thuhej: “autoritetet komuniste në Shqipëri po rishkruajnë historinë e vendit të tyre” dhe “ata shqiptarët shkruajnë se në të shkuarën në fatin e tyre ka qenë shumë i pranishëm ndikimi i faktorëve të huaj”.

Por ndërsa shtypi amerikan pat bërë indiferentin e madh nuk kishte ngjarë e njëjta gjë me atë grek. Ai i kishte fryrë faqet me shkrime për Shqipërinë, kryesisht me temë “Epirin Verior”.

I marrë nga e përditshmja e Athinës “Ipirotikon Mellon” dhe i ribotuar në gazetën e diasporës helene në Shtetet e

Bashkuara “Ethnikos Qiriks”, në një rast shkruhej se “regjimi i sotëm shqiptaro-komunist ka filluar një propagandë intensive në drejtim të vorioepirotëve në mërgim...në mënyrë të veçantë në drejtim të atyre të Amerikës...me anë të radios, me anë të dërgimit të materialeve të ndryshme të shtypit dhe me anë të agjentëve të stërvitur...që të shuajnë rezistencën vorioepirote”.

Kishte qenë po ashtu gazeta e diasporës “Atlantis” e 29 shkurtit, e cila pati botuar një përmbledhje të një fjalimi që në Athinë kishte mbajtur ish ambasadori grek në Uashington Jorgo Mellas.

Në fjalimin e vet ky pati kritikuar qëndrimin e qeverisë greke të kohës së Luftës së Dytë Botërore, e cila sipas tij, atëherë nuk kishte guxuar të hidhte për veprim thirrjen për marrjen e Epirit të Veriut.

Pallati i Qelqtë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara

Seanca e parë e Sesionit 15-të të Kombeve të Bashkuara do të niste mëngjesin e të nesërmes, por pasditen e 20 shtatorit Asambleja do të shqyrtonte kërkesat për pranim në radhët e saj të disa shteteve të reja afrikane.

Flitej se prej tyre atë mbrëmje do të miratonte shumicën, për t'i lënë pakëve të mbetur ta gëzonin atë status brenda gjysmës së parë të tetorit.

Prej diplomatëve që e njihnin mirë mjedisin e Pallatit të Qelqtë seanca e asaj pasditeje pritej të qe spektakolare, e mbushur me përshëndetje dhe përbetime miqësie e kujdesi për anëtarët e rinj. Për t'i bërë ata për vete pritej të ndesheshin veçanërisht tre politikanë: Ajzenauer, Hrushovi dhe Tito.

Kur në kolonadën e madhe në hyrjen e Pallatit të Qelqtë nisi njëri pas tjetrit mbërritja e delegacioneve, në hapësirën përtej autostradës, atje ku shpengueshëm lëviznin kalimtarët, me thirrje dhe pankarta në duar demonstronin grumbuj protestuesish. Fjalët që shqiptonin me zë të lartë dhe sidomos germat e shkruara nëpër faqet e bardha të kartonëve citonin masivisht dy emra: Hrushovin dhe Kastron.

Dikush në parullën e vet e kishte vendosur kryekomunistin sovjetik në qendër të një karikature dhe përreth pesë a gjashtë koka të tjera të drejtuesve të vendeve socialiste. Këta i pat vizatuar me kokën në formën e një sqepi të madh grabitqar. Sipër karikaturës kishte shkruar “Bijtë e Nikita Hrushovit”.

Në një grumbull tjetër protestuesish një njeri i veshur me një pardesy gri me cipë të shkëlqyeshme kishte vënë mbi krye kokën e një oktapodi të madh, duke i lënë gjymtyrët e tij të gjata të vareshin deri në tokë.

Sipas asaj që me zë të lartë thërriste demonstruesi, ai oktapod qe komunizmi. Në një grup tjetër disa kartela të kartonta përmbanin fjalën mostër.

Fare pranë protestuesve që nuk ishin të shumtë, por gjithsesi nuk pushonin një çast, lëviznin gjithë vëmendje agjentët e policisë. Asnjëri në alarm. Kureshtarët i ndalnin hapat dhe për minuta të tëra dukeshin sikur binin në magjepsje me pamjen që shihnin.

Gazetarët, fotoreporterët dhe kameramanët nuk reshtnin së mbajturi ndonjë shënim, fotografuar dhe filmuar.

Delegacionet vinin njëri pas tjetrit.

Afrikanët me veshjet e tyre tradicionale gjithë ngjyra, por që atë pasdite e kishin çastin e tyre historik të pranimit në OKB, i tundonin shumë njerëzit e shtypit.

Këta zhurmëruan si bletët në zgjoje kur në hyrjen e dhjetëra katëshit të Pallatit të Qelqtë u afruan në fillim Nikita Hrushovi dhe pastaj Fidel Kastrot.

Sekretari i Parë i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, me në krahun e djathtë Andrej Gromikon, pas me gjithë të tjerët, nuk shoqërohej prej asnjë uniforme polici apo pardesyje të bardhë detektivi. Delegacioni dukej i qetë dhe bënte gjeste të lirshme.

Kostumin e zi mbi trupin e shkurtër e barkun e kërcyer Hrushovi e kishte shoqëruar me një kravatë të errët, ndërsa ministri i jashtëm, i gjatë dhe elegant, hijeshinë e veshjes së vet e kishte zgjedhur me ngjyra më të çelëta.

Asnjë distinktiv nuk mbante Gromiko mbi kostum, porse shefi i tij në të dy thiletë e xhaketës, majtas e djathtas, pat mbërthyer dy yje Heroi si edhe medalje nga Lufta e Dytë Botërore.

Ndërsa hynte në Pallatin e Qelqtë Nikita Hrushovi dukej gjithë energji. Buzëqeshte pa pushim, veç përmbajtshëm dhe përherë në drejtim të fotoreporterëve dhe kameramanëve.

Kur në hyrjen e qiellgërvishëshit të Kombeve të Bashkuara u shfaq Fidel Kastro, përreth tij qenë ngjitur një mizëri e tërë me agjentë policie. Nuk i rrinin më larg se një metër dhe dukej se më shumë ndiqnin gjestet e tij se të ndonjë personi që papritur mund t'i shkaktonte agresion fizik.

Kastro këtë herë ishte ndryshe nga sa qe paraqitur në aeroport.

Xhaketën ushtarake sërish e mbante të pa mbërthyer, por gjithsesi jo gjoks hapët. Po ashtu nuk ecte duke e tollovitur trupin, por duke e tendosur sa më drejt.

Shtathedhur, përpiqej të linte përshtypjen se gjithë të tjerët dëshironte t'i shihte nga lart.

Gazetarët i përshëndeti ngrohtë. Të tjerëve nuk ua vari fare.

Në çastin kur në prag të hyrjes së Pallatit të Qelqtë me një kostum të zi e kravatë të kuqe u afrua Mehmet Shehu, përreth bashkë me të vetët, fotoreporterët i hodhën dritë blicesh, por pa ndonjë ngut e pothuaj në heshtje. Dukeshin kuriozë, veç jo të interesuar profesionalisht. Regjistrinin kronikën, por me sa dukej jo sepse shefat e tyre në gazeta parashikonin t'i hapnin vend pranisë së kryeministrit shqiptar.

Ky përshëndeti me kokë, mjaft sjellshëm, por ngazëllim nuk i doli prej buzëve.

Çuditërisht fytyrën e tij pa asnjë rrudhë e kishte të mbushur me një ndriçim të shtrirë harmonishëm mbi çdo tipar.

Ngjashmëria e Mehmet Shehut me jugosllavin Koça Popoviç

Në sallën e madhe të Asamblesë, ndërsa hynë, gjithkund kishte njerëz që rrinin ulur nëpër poltrona apo lëviznin mes rreshtave e rrugëkalimeve. Gumëzhinte gjithçka si në një tregtore të madhe.

Reis Malile i tregoi kryeministrit ku ndodhej delegacioni bullgar. Mehmet Shehu bëri për atje. Zhivkovi ia dha dorën si të qe një copë druri, porse ministri i tij i jashtëm gjestin e takimit e kreu me shumë ngrohtësi.

Pas atij çasti të shkurtër Malile e orientoi shefin e vet t'i shmangej një rrugëkalimi afër delegacionit jugosllav, i cili ndodhej vetëm pak rreshta larg bullgarëve.

Për të shkuar deri në vendin e caktuar për Shqipërinë Mehmet Shehu vazhdoi të ndiqte lëvizjet e Reis Maliles. Gjendeshin në skajin tjetër, buzë rrugëkalimit anësor, në krahun e majtë të sallës.

Kur një kameraman britanik nisi t'i filmonte, i gjithë delegacioni shqiptar ndodhej ende në këmbë dhe Shehu akoma në buzë të hyrjes për në gjashtë poltronat e vendit të tyre.

Reis Malile qëndronte poshtë tij, shtatlartë, duke iu përgjigjur pyetjeve që kryeministri ato çaste po i bënte. Ministri i Jashtëm Behar Shtylla ndërkohë pat hyrë në brendësi të karrigeve, por ende nuk ulej. Priste të vinte në vendin e tij kryeministri.

Në sallë Novotni po lexonte materialin që i kishin vënë përpara bashkëpunëtorët. Edhe Gomulka pat ulur kokën pa flokë mbi tufën e letrave. Dezhri me ballin e madh po

ashtu shfletonte. Pranë, me mjekrën e tij të bardhë e të gjatë, i qëndronte ministri i Jashtëm. Kadari në radhët e para të sallës një sy e mbante mbi fijet e letrave dhe tjetrin duke ndjekur me vëmendje çfarë ndodhte përreth.

I zhytur në lexim e duke kthyer një nga një fletët, me pamje mjaft hijerëndë dhe pa e çuar kokën, qe Tito.

Në të majtë e ndiqte me një vështrim të përdëlluar ministri i tij i jashtëm Koça Popoviç.

Maliles i mbetën sytë tek ky i fundit.

Kur ende pak kohë më parë ndodheshin në selinë e Misionit e pat pyetur një nga anëtarët e delegacionit si e kishin shmangur kontaktin fizik me Josip Brozin. Ky i qe shpjeguar se gjithçka nuk pati qenë aq fort e vështirë sa e kishin kujtuar në fillim.

I druheshin vërtet ndonjë provokacioni të jugosllavëve, qoftë edhe në formën e një përshëndetjeje rastësore, thjesht një tundjeje koke, sepse edhe kaq fare pak do të mjaftonte të shpërthente një lajm sa për të mbushur kolona të tëra në gazetatat e Amerikës.

Mirëpo nuk pat ngjarë asgjë e tillë, jo thjesht se ata u qenë shmangur dhe se vetë Mehmet Shehu u mbyll në kabinën e tij, por nga që të padëshiruar për t'i ndeshur përballë qenë edhe vetë jugosllavët.

Madje një drekë, kishte rrëfyer tjetri, kur në restorant po shkonin të zinin një tryezë të lirë, rruga për atje kalonte pranë tavolinës ku po drekonte Tito me të vetët. Diplomateve shqiptarë me në krye Behar Shtyllën u kishte bërë përshtypje se kur u gjendën afër, jugosllavët heshtën dhe i ndoqën me sy me një ankth të dukshëm.

Me siguri druheshin prej ndonjë fjale të hedhur nga shqiptarët.

Më i alarmuar ishte dukur Koça Popoviç.

Këtë gjendje shpirtërore të ministrit të Jashtëm Jugosllav pjesëtari i delegacionit të ardhur nga Tirana ia shpjegoi Reis Maliles sipas një mendjeje të tij.

Ai qe i bindur se Konstandin Koça Popoviç qe Mehmet Shehu i Jugosllavisë, kopja e tij. Ndryshimet mes tyre qenë fare të vogla: i pari ishte 52 vjeç dhe i dyti 47. Popoviç ishte poet, Shehu thjesht nuk kishte mundur dot të bëhej shkrimtar, sepse penën e përdorte me talent.

Të dy qenë besnikë të palëkundur të shefave të tyre, po ashtu edhe mjaft të disiplinuar, karaktere të hekurt.

Si Shehu edhe Popoviç ishin natyra të heshtura, pothuaj vetmitare. Që të dy përdornin më shumë veprimin se fjalën. Qenë të pajisur me një mendje ushtarake gjeniale. Gjatë luftës Mehmet Shehu dhe Koça Popoviç jetonin mes trupave e luftonin në krah me ta, ishin për to idhuj.

Por ngjashmëria mes Shehut dhe Koçës shkonte edhe më tej. Kishin qenë vullnetarë në Luftën e Spanjës, veç ndërsa Mehmet Shehu bënte pjesë në një nga brigadat internacionale, Koça Popoviç u rreshtua drejt për së drejti në njësitë republikane.

Gjatë luftës për çlirimin e Jugosllavisë i ngjashmi qe komandant i Brigadës së Parë të ushtrisë partizane dhe në krye po ashtu kur ajo u bë divizion.

E njëjta pat ndodhur edhe me Mehmet Shehun.

Gjatë kësaj kohe, kishte shtuar anëtarë i delegacionit, si Shehu ashtu edhe Popoviç mbanin mustaqe, madje të të njëjtit model. Edhe nga fytyra ngjanin jo pak.

Pas lufte që të dy u bënë shefa shtabesh të ushtrive, veç në kohë dhe me qëndrime të kundërta. Kryeministri shqiptar bashkë me Enver Hoxhën u rreshtuan me Moskën dhe Stalinin, kurse prej vitit 1948 deri në 1953 Koça Popoviç bashkëpunoi me amerikanët për modernizimin e ushtrisë së vendit të tij.

Në këtë periudhë të nxehtë të luftës së angloamerikanëve dhe jugosllavëve për rrëzimin e Hoxhës Mehmet Shehu qe ministër i Brendshëm. Kështu të dy të ngjashmit qenë në betejë të drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin.

Ndërsa mbaroi këtë shpjegim tjetri bëri një pauzë dhe e mbylli të gjithë bisedën e me fjalët “Jo Tito, por nga takimi qoftë edhe i rastësishëm me Mehmet Shehun, ankthin e kishte binjaku i tij, Popoviçi”.

“Përse kriminelët shqiptarë u rrahën me fashistët vorioepirotë?”

Radhët e para të sallës së Asamblesë papritur u trazuan. Vrapuan një tufë fotoreporterësh. Kishte hyrë Nikita Hrushovi.

Delegacioni kuban që ulur në radhët e para, në mes. Menjëherë u çua për t'i dalë përpara.

Mes bliceve që i fotografonin pa pushim, Fidel Kastro dhe kryeministri sovjetik u përqaftuan, duke i rënë shpatullave njëri-tjetrit. Pastaj Hrushovi i dha dorën një për një të gjithë anëtarëve të dërgatës së ardhur nga Havana.

Qe gjithë entuziazëm kur iu rikthye sërish shtrëngimit të duarve me Kastron.

Pak minuta më pas, i ndjekur nga fotoreporterët, ndërsa u duk se po shkonte drejt rreshtit ku do të ulej, ende me fytyrë nga salla, Nikita Hrushovi bëri majtas dhe u kuptua menjëherë se po shkonte drejt Josip Broz Titos.

Ky sapo e dalloj u ngrit në këmbë.

U takuan me gëzim dhe shkëmbyen përshëndetje të shkurtra. Blicet i mbuluan me shkrepje.

Jo vetëm sepse që trupshkurtër, por edhe nga që vinte prej kreut të sallës, e cila lartohej shkallë pas shkalle, para presidentit jugosllav Hrushovi ngjau me një xhuxh.

Më në fund Nikita Hrushovi me hapin e tij të shkurtër e të shpejtë u kthye në vendin e vet, te gjashtë poltronat e delegacionit sovjetik, në të majtë të sallës. Ndodhej vetëm dy metra më pas nga rreshti ku gjendeshin shqiptarët. Sekretari i Parë i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik kishte kaluar ngutshëm para Mehmet Shehut dhe nuk ia

pat hedhur sytë. U mundua të linte përshtypjen se nuk e kishte dalluar, por këtij i qe dukur se Hrushovi pat vepruar qëllimshëm.

E ndoqi me bisht të syrit se si njeriut të fuqishëm të Moskës, sapo u ul, iu afruan me ngazëllim Kadari dhe Gomulka. Të dy palët u përshëndetën dhe u përqafuluan gjatë.

Të gjitha veprimet i bënë me shpinë nga shqiptarët.

Kur ata u larguan Mehmet Shehu u ngrit nga vendi i vet dhe shkoi tek Nikita Hrushovi. E përshëndeti me mirësjellje dhe i zgjati dorën. Ky ia dha shumë ftohtë. Po ashtu veproi edhe Gromiko, një shtrëngim prej akulli.

Pak minuta më pas, ndërsa qe ulur në vendin e vet, nisi edhe seanca e asaj pasditeje.

Mehmet Shehu u përqendrua tek folësi në tribunë. Ishte Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Dag Hammarskjold. Njoftoi se kishin bërë kërkesat për t'u pranuar si shtete të pavarura Kameruni, Togo, Madagaskari, Kongo (Leopoldvil), Kongo (Brazavil), Somalia, Dahomei, Nigeria, Volta e Sipërme, Bregu i Artë, Çadi, Gaboni, Qipro dhe Afrika Qendrore.

Tashmë gjithsecili përfaqësues do të merrte fjalën.

Mehmet Shehu ra në heshtje të plotë. Nisi të ndiqte i përqendruar çfarë tashmë nga tribuna shqiptohej. Po ashtu edhe prej sallës si qe reagimi. Prej vendit të tyre ndiqej qartë si vepronte Tito.

Papritmas një çast kryeministri e ktheu kokën nga Reis Malile. I kishte sytë të zvogëluar, si dy maja gozhdësh. Pasi ja nguli vështrimin drejt e në bebëza tha se duhej ta informonte mbi atë zënkë që pat ngjarë tek hyrja e selisë së OKB-së.

“Përse kriminelët shqiptarë u rrahën me fashistët vorioepirotë?”, e pyeti me një zë të çuditshëm, as të ashpër dhe as të butë, e gjithsesi me një tingëllim të veçantë.

Ajo mënyrë të foluri Reis Maliles u duk sikur ia paralizoi mendjen dhe në kërkim të përgjigjes nuk i gjeti dot në kohë fjalët më të përshtatshme. Nisi t'i tregonte për agresivitetin në rritje të shtypit grek të diasporës, por që patjetër nuk ishte ide e tyre, por duhej të që harmonizuar me një politikë të caktuar të Athinës.

Pastaj, ndërsa e pa që Mehmet Shehu donte më shumë shpjegime, shtoi se sapo të ktheheshin në rezidencë do t'i bënte një raport më të plotë.

Kryeministri tundi lehtas kokën dhe iu rikthye heshtjes së tij të mëparshme me vështrimin drejt foltores së Asamblesë.

Maliles i pat bërë përshtypje ngulëkëmbja e tij për atë që kishte ngjarë tek portat e OKB-së. Në gjuhën zyrtare shqiptarët e arratisur quheshin kriminelë dhe në më të shumtën e herëve qarqet vorioepirote greke si profashiste. Kur do t'i bënte raportin e radhës Tiranës edhe ai do të përdorte të njëjtat emërtime, por në ato pak çaste pyetje-përgjigje kur me kryeministrin qenë parë sy më sy, pat dalluar në bebëzat e tij si dridhej papërmbajtshëm një gëzim i fshehtë.

Në të vërtetë edhe ai ngazëllente nga trimëria e antikomunistëve të arratisur. Kishin braktisur menjëherë protestën ndaj Mehmet Shehut dhe sapo vorioepirotët i qenë sultur Shqipërisë, iu turrën vrulltazi atyre.

Fjalë se Misioni Jugosllav në OKB do të goditet me predha reaktive

Në Pallatin e Qelqtë seanca e asaj pasditeje të 20 shtatorit u mbyll pas katër orësh.

Të trembëdhjetë shtetet afrikanë u miratuan.

Ngjarjen e përshëndetën shumë delegacione, doemos dukshëm amerikanët dhe sovjetikët. Veç nuk qëndroi mënjane as Koça Popoviç.

Ky ndërsa në fillim u duk se do të mjaftohej me urimet për të porsa pranuarit papritmas nisi të ankohej për pasigurinë që i ishte krijuar delegacionit jugosllav për shkak të lejimit të protestave para hotelit apo selisë së përfaqësisë së tyre diplomatike.

Kemi të dhëna, ngulmoi ai, që prej armiqsh janë instaluar përballë Misionit tonë predha reaktive. Kërkojmë të jemi të mbrojtur, ngriti zërin Popoviç.

Disa delegacione e duartrokitën dukshëm, mes tyre edhe prej të shpallurve si shtete neutralë, vende të Azisë dhe Afrikës.

I përplasi duart fort edhe Nikita Hrushovi.

Gjestin e tij e ndoqën menjëherë anëtarët e tjerë të delegacionit sovjetik.

Mehmet Shehu u bë nervoz. I tha Behar Shtyllës se titistët po bënin lojën e të persekutuarve nga imperializmi amerikan, kur në të vërtetë qenë shërbëtorë dhe agjentë të tyre.

Kur u ngritën për të ikur Hrushovi sakaq qe larguar. Për katër orë të tëra, përveç atij shtrëngimi të shkurtër e memec duarsh, nuk patën shkëmbyer asnjë fjalë.

“Mos harro të shkosh në mbledhje”, i kujtoi Shehu ministrit të Jashtëm një takim që do të mbahej menjëherë në një nga sallat e vogla të Pallatit të Qelqtë. Të gjithë ministrat e Jashtëm të vendeve socialiste me këtë rast do të këshilloheshin të koordinonin kandidaturat e tyre për në strukturat drejtuese të Kombeve të Bashkuara. U takonte vendi i një nënkryetari të Asamblesë.

Qe projektuar që në atë post të vihej një bullgar, kurse Shqipëria mund të garonte për vendin e kryetarit të Komisionit Juridik. Ndërkohë kjo nuk qe e mundur, sepse personi i kandiduar duhej të ishte jurist shumë i njohur dhe tepër i përgatitur. Të tillë pala shqiptare nuk kishte, prandaj që më parë patën rënë dakord që këtë post tua ofronin bullgarëve.

Behar Shtylla me një nga ndihmësit e tij dhe Mehmet Shehu me pjesën tjetër të delegacionit sapo dolën nga salla e madhe e Asamblesë morën drejtime të ndryshme. Kur mbërritën në seli kryeministri u tërhoq në apartamentin e tij të hartonte informacionin për Enver Hoxhën. Qe i dyti i asaj dite, por kryesori.

Radiogrami i parë ishte përpiluar nga Reis Malile dhe në të qenë thjesht disa radhë, të cilat bënë dijeni për orën e mbërritjes së tij në Nju Jork dhe po ashtu fjalët që pat shqiptuar në port në konferencën e shkurtër për shtyp.

Në orën njëzetë e dy në apartamentin e Mehmet Shehut kishte hyrë Behar Shtylla. I porsakthyer nga mbledhja e ministrave të Jashtëm të vendeve socialiste ai e vuri në dijeni kryeministrin për çfarë atje pat ndodhur.

Ishte vendosur që kandidatura për postin e nënkryetarit të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara të qe një bullgar dhe ndërkohë Andrej Gromiko pat reaguar nervoz kur ministri i Jashtëm i Sofjes ishte shprehur për të pranuar propozimin e palës shqiptare për vendin e kryetarit të Komisionit Juridik.

“Jo!”, kishte shqiptuar ministri i Jashtëm sovjetik, “Ajo është vendosur”.

Kështu takimi pat përfunduar me një kandidaturë bullgare për nënkryetarin e Asamblesë dhe rumune për drejtuesin e Komisionit Juridik. “Gjesti Gromikos që haptas kundër nesh”, i kishte thënë Behar Shtylla Mehmet Shehut.

“Shqiptarët e Amerikës, që kurrë nuk kanë protestuar dhe kurrë nuk protestojnë kundër Shqipërisë, protestojnë kundër komunistëve”

Reis Malile hyri në dhomën e punës të kryeministrit vetëm kur ky e thirri.

Ishte pragu i orës njëzetë e tre.

Teksti që ai i zgjati për t’u koduar dhe pastaj nisur drejt Tiranës që i gjatë.

Reis Malile u bë gati të largohej kur Shehu i kujtoi se që nga salla e Asamblesë kishin lënë përgjysmë një bisedë. “Sigurisht”, u përgjigj tjetri, “për përleshjen e kriminelëve me vorioepirotët kam marrë disa të dhëna shtesë”. Kryeministri u bë gati ta dëgjonte.

–“Shumica e lajmeve kanë pasur si burim kryesor agjencinë Associated Press”, nisi Malile, por u pendua menjëherë përse e kishte çelur raportimin e tij me këtë hollësi që duhej të që e fundit. Prandaj shtoi: “Në të gjitha rastet, shoku kryeministër, duke cituar edhe arsyen përse ajo përleshje ndodhi, mediat kanë bërë të dukshme praninë tuaj në punimet e Sesionit të 15-të të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara”.

Mehmet Shehu nuk lëvizi asnjë tipar të fytyrës. Mbi cipën e lëkurës së tij të faqes kishte rënë ngrica.

Megjithatë Reis Maliles iu krijua përshtypja se kryeministri e kishte akoma të ndryrë në thellësi të bebëzave atë dallgëzim të padukshëm ngazëllimi të fshehtë që ia pat dalluar në sallën e Asamblesë.

–“Po “Dielli” a ka shkruar?”, e pyeti Shehu.

–“Po”.

-“Çfarë thotë?”

Malile u gëlltit. Fjalët në fyt sikur iu ngjitën në një lëndë viskoze dhe ngecën atje. Mezi i nxori një nga një.

-“Titullin e artikullit kryesor e kanë ca të gjatë”.

-“Më thuaj çfarë thotë?”, - rëndoi tonin Mehmet Shehu.

-“Shqiptarët e Amerikës, që kurrë nuk kanë protestuar dhe kurrë nuk protestojnë kundër Shqipërisë, protestojnë kundër komunistëve”.

Ndryshe nga nxjerrja e zorshme e fjalëve të mëparshme, të porsa shqiptuarat Reis Malile i bëri të rendnin pa marrë frymë.

-“Sidoqoftë do të kemi një tablo më të plotë nesër në mëngjes”, - vijoi vrulltas, - “kur të marrim shtypin e ditës”.

-“Dakord”, - bëri njëhershëm shenjë me dorë dhe fjalë kryeministri.

Mehmet Shehu dëshiron të vizitojë Broduej

Ndërsa Malile po bënte të dilte nga dhoma e kryeministrit, ky papritur i tha: “Dua të dal në ajër të pastër e të shoh ndonjë gjë”.

Tjetrit iu mpinë gjymtyrët.

“Vetëm një gjysmë ore, sa për t’u trazuar nervat edhe amerikanëve”, vijoi kryeministri.

Pyeti: “Cila është pika më e afërt interesante për ta vizituar?”

Më në fund Reis Malile e mblodhi veten: “Broduej”.

“Atëherë të shkojmë atje kur të afrohet mesnata”, shqiptoi me zë të fortë Mehmet Shehu.

Malile doli nga apartamenti i kryeministrit pothuaj me vrap. Radiogramin ia dorëzoi shifrantit dhe mblodhi menjëherë të vetët. U tha çfarë dëshironte kryeministri dhe çështja e parë që duhej zgjidhur ishte të njoftonin rojet amerikane.

Të vënë në dijeni këta nuk shfaqën ndonjë mospëlqim.

“Shoku Enver, në vapor e detyruam Titon të qëndronte mbyllur në kabinë dhe evitua çdo takim me njerëzit e tij”

Ishte dhënë urdhri kategorik që gjatë qëndrimit të Mehmet Shehut në Nju Jork shkëmbimi i mesazheve mes tij dhe Enver Hoxhës të mos vonohej asnjë minutë dhe për asnjë arsye.

Radiogramet e nisura nga Nju Jorku fillimisht do të mbërrinin në ambasadën shqiptare në Pragë dhe prej andej do të riniseshin për në godinën e Ministrisë së Jashtme në Tiranë.

Ato do të deshifroheshin me një frymë.

Pas zbardhjes njëra nga dy kopjet e daktilografuara me një motoçiklist të shpejtë do të vraponte për tek Komiteti Qendror i PPSH.

Aty e priste Enver Hoxha.

Kur ky e mori radiogramin e nisur nga Nju Jorku natën e 20 shtatorit, që pasmesdita e vonë e 21 shtatorit. Ora shënonte minutat e para të kapërcimit të tetëmbëdhjetës. Mesazhi mbante numrin 330: “Shokut Enver, 1) Në vapor e detyruam Titon të qëndronte mbyllur në kabinë dhe evitua çdo takim me njerëzit e tij. I biri i Çërçillit, Randolfi, ishte në vapor dhe kërkoi takim me ne. Duke e njohur si ish këshilltar i Titos, oficer i Inteligent-Servisit e vagabond, nuk pranua takim. 2) Sot ora 8 zbritëm në Nju Jork. Me qindra policë kishin bllokuar portin dhe çdo 20 metra në anët e rrugës gjer në Mision kishte policë. Na shoqëronin shumë vetura me policë e detektivë. Vetëm për ne janë caktuar 140 policë e detektivë që ruajnë shtëpinë e

shoqërojnë mua. Manhatani është si gjendje lufte, për të ruajtur delegacionet mbi 8 mijë policë. Gjatë lëvizjeve bllokohen rrugët, bien sirenat e zjarrfikësave. Këto bëhen më tepër për të krijuar alarm, përshtypje rrezikshmërie në popull për ne. Mbasi mbërritëm Mision, erdhën disa dhjetëra vorioepirotë në trotuar e bërtisnin, por policia qëndronte në roje me shumicë, vetëm tek porta jonë ka mbi 20 permanent”.

Pika 4 e raportimit të Mehmet Shehut thoshte: “Hrushovin e pritën në port me përbuzje të madhe e poshtëronjëse”.

Më tej radiogrami i komunikonte Enver Hoxhës: “Ambienti është shumë i nderë nga të gjitha anët. Ne e ndjemë veten kaluar. Mos kini merak. Gjithëve të fala. Përqafime. Mehmeti”.

Pak minuta më vonë mbi një fletë të bardhë me vija Hoxha nisi të shkruante mesazhin e tij: “I dashur Mehmet, 1) Andej nga e di ti, morëm një material të mrekullueshëm, por fatkeqësisht s’mund ta dërgojmë ta këndosh, se je larg. Por mjaft që e lexuam ne që ty të zhduket çdo mërzi nga mizerjet e Nju Jorkut. Materiali është i atillë sikur ta kemi shkruar vetë. Besoj se shpjegimet janë të mjafta që çdo gjë atje të të duket mizë. 2) Për çdo propozim të ri që mund të bëhet në OKB, por që sipas mendimit tënd nuk është në rregull, jo vetëm politikisht por edhe ideologjikisht, jo vetëm me efekt imediat, por edhe me efekt të largët, mos u ngut të japësh aprovimin e menjëhershëm, gjoja për të mos u ndarë nga “tufa”. Prandaj, siç e kemi vendosur, na vur edhe ne në korrent, pse mundet për eventualitet politik të rreshtohemi, por njëkohësisht t’u parashtrosh “miqve” vërejtjet tona me gojë dhe me shkrim. 3) Përsa i përket fjalimeve të tua zyrtare, duke ruajtur kurdoherë formën diplomatike dhe pavarësisht se të tjerët mund ta zbutin, zëri të tëra kyçet, kundër imperializmit amerikan e të tjera e të tjera. Kështu që askush në asnjë kohë të mos guxojë të

na akuzojë për zbutje. Të tjerat i di vetë. Këtëj çdo gjë është shumë në rregull. Po përgatitim vajtjen e delegacionit në Moskë. Shume të fala, Shpati”.

Gazetat amerikane: “Nacionalistët dhe antikomunistët shqiptarë në Amerikë për shkak të Shqipërisë “mbrojnë” udhëheqësin komunist”

Njëzetë e një shtatori ishte dita e parë e çeljes së punimeve të Sesionit të 15-të të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara. Do të kishte një seancë të paradites dhe një të dytë, pasdite.

Pritej një bum i paparë lajmesh jo sepse merrte jetë kjo ngjarje, rreth të cilës mbështilleshin si fijet në një furkë dërgata nga e gjithë bota dhe emrat më të dëgjuar të politikës globale. Vërshimi mëngjesor i titujve të zhurmshëm të faqeve të para të gazetave nuk vinte aq shumë se qenë fiksuar nëpër foto takimet e Nikita Hrushovit me Fidel Kastron dhe Josip Broz Titon, por sepse një ditë më parë kishte pasur demonstrata, qenë marrë vesh të reja rreth sherrit të bujshëm të Kastros me pronarin e hotelit “East Side Shelburne”, ishin shpërndarë thashetheme për një dashnore sekrete të tij, e cila thuhej se pat hyrë pasmesnate në shtratin e kryekomunistit kuban.

Qenë shpërndarë po ashtu fjalë të pakonfirmuara zyrtarisht se diku në një qoshe të lagjes Manhattan i qe vënë flaka një flamuri sovjetik dhe se në hotelin e dytë Kastros i kishte shkuar për një vizitë inkurajuese vetë Nikita Hrushovi.

Ndërkohë pritej një reagim i shtypit edhe për atë që pat ndodhur një ditë më parë përkundruall rezidencës së Misionit shqiptar.

Reis Malile qe zgjuar shumë herët dhe në kioskën më të afërt e kishte blerë të gjithë tufën e gazetave. Sapo shfletoi dy të parat u shtang. Përleshja e shqiptarëve me grekët kishte tërhequr vëmendje të dukshme.

Titujt për të qenë kudo germë mëdhenj, shumica shoqëruar me foto: “Gjakoset rruga përballë Kombeve të Bashkuara”, “Në Nju Jork hapet “lufta” midis Greqisë dhe Shqipërisë”, “Nacionalistët dhe antikomunistët shqiptarë në Amerikë për shkak të Shqipërisë “mbrojnë” udhëheqësin komunist”, “Shqiptarët treguan se janë nacionalistë të mëdhenj”, “Për hir të kombit të tyre harruan udhëheqësin komunist”.

Malile nuk po u besonte syve.

Nisi të nxitonte për të marrë ashensorin dhe ngjitur sa më parë deri në zyrë. Në kabinën e tij kishte edhe tre persona të tjerë dhe diplomatit shqiptar i dukej sikur faqet e gazetave flisnin me zë që t'i dëgjonin të gjithë: “New York Times”, “USA Today”, “Washington Post”, “Denver Post”, “Chicago Tribune”, “St Petersburg (FL) Times”, “Christian Science Monitor”.

Vetëm kur u ul në poltronin e zyrës dhe mbushi gjoksin me frymë kuptoi se duhej ta përballonte më qetë atë që pati ndodhur. Zënka midis shqiptarëve antikomunistë dhe grekëve vorioepirotë, ndërsa dukej se i kishte bërë shumë mirë imazhit të vendit, lëndonte atë të Mehmet Shehut.

“Ne jemi krenarë që kemi dalë këtu për të protestuar kundër një kryeministri që nuk përfaqëson denjësisht Shqipërinë”, para se të ndodhte përleshja kishte deklaruar një nga demonstruesit.

“Jemi sot këtu për të pritur me protestë Mehmet Shehun”, pohonte një shqiptar tjetër.

Pastaj rreshtoheshin pa fund fjalët që përshkruanin pjesën e dytë të ngjarjes, zënkën.

Ato vraponin njëra pas tjetrës cila të qe më mbresëlënëse: “Përleshja ishte e fortë”, “U thyen ombrella dhe pankarta në

kokat e të dy palëve”, “U gjakosën dhe disa prej tyre u dërguan në spital”.

Në “New York Times” një prej vorioepirotëve kishte deklaruar se atë dhe bashkëkombësit e tij i kishte sulmuar një grup i vogël prej njëzetë komunistësh shqiptarë. Gazeta e madhe amerikane shkruante edhe për një shqiptar të arrestuar, me emrin Gj.D., sepse kishte goditur me çadër policët.

Mirëpo kjo ngjarje që zhvilluar në mbrëmje gjatë një demonstrate pranë hotelit ku kishte bujtur Fidel Kastro. Për fat këtë herë nuk përmendej fare Mehmet Shehu.

Kur pati përshtypjen se i kishte shfletuar mirë të përditshmet dhe më në fund mund të shkonte tek kryeministri, syri i kapi në brendësi të thellë të “The New York Times” emrin e transatlantikut “Queen Elizabeth”.

E nguli vështrimin në radhët e para të artikullit dhe gjithçka e shkruar iu përthith si ta kishte kujtesën një hapësirë vakumi. “Dy njerëz për të cilët i gjithë gadishulli i Ballkanit do të ishte shumë i vogël për të jetuar të dy së bashku, kanë udhëtuar “përkrah” njëri-tjetrit në anijen britanike “Queen Elizabeth”, e cila i solli ata drejt Nju-Jorkut për të ndjekur punimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

Këta janë mareshalli Tito i Jugosllavisë dhe kryeministri shqiptar, Mehmet Shehu, që zëvendëson Enver Hoxhën, e ardhmja e të cilit mbetet e panjohur”.

Reis Malile mbajti pezull frymën: “Atij iu urua mirëseardhja nga rreth 100 persona që ishin mbledhur përpara portit. Moli i lumit Hudson ku u ankorua anija “Mbretëresha Elisabet”, ruhej nga 500 policë. Këto masa sigurie ua kalonin vetëm atyre të mbërritjes së Sekretarit të Parë të PKBS-së, Nikita Hrushov.

Menjëherë, sapo Tito la kuvertën, dy fëmijë jugosllavë u afruan dhe i dhuruan dy buqeta me lule. 68-vjeçari dukej i

nxirë dhe i shëndetshëm. Në momentin që anija iu afrua molit binte një shi i lehtë. Tito hyri në një limuzinë dhe iu bashkua misionit të tij të përhershëm në Kombet e Bashkuara në Rrugën 5 të rezidencës së tyre në Nju-Jork”. Malile u mbush me frymë: “Kryeministri shqiptar, Shehu, priti që të largohej Tito dhe doli nga anija 25 minuta më pas. Ai theksoi edhe një herë tjetër vendosmërinë e Shqipërisë ndaj “bashkekzistencës paqësore”.

Thelbi i deklaratës së tij ishte i njëjti me ato të udhëheqësve të tjerë komunistë, të cilët mbërritën këtu ditën e hënë.

Nuk është ende e qartë se çfarë masash qenë marrë nga kapitaneria e anijes “Mbretëresha Elisabet”, por mendohet se nuk ka pasur asnjë takim mes dy delegacioneve “armike”, ndërsa në mëngjes kryenin ushtrimet e tyre fizike në kuvertën e anijes”.

Tashmë Reis Malile po ndjente ngazëllim. Prej këtij shkrimi Mehmet Shehu do të ndihej mirë.

Shkoi me shpejtësi drejt rreshtave përmbyllës të artikullit. Autori ishte qartësisht protitist: “Sulmi i fundit i jugosllavëve ndaj komunistëve shqiptarë ndodhi më 9 shtator kur qeveria e Beogradit lëshoi një protestë të fortë ndaj “veprimtarisë diversioniste shqiptare në Jugosllavi”, një akuzë që drejtohet në mënyrë konstante nga Tirana drejt Beogradit.

Në një letër dorëzuar të ngarkuarit shqiptar me punë në Beograd, i cili, me që ra fjala, refuzoi ta lexonte i pari, qeveria jugosllave protestonte “jo ndaj dhjetë, por qindra artikujve antijugosllavë të botuar në shtypin shqiptar”.

Për më tepër, jugosllavët pretendojnë në letrën e tyre se qeveria shqiptare kishte organizuar dhe arritur me sukses një sërë infiltrimesh të shtetasve të vet në Jugosllavi, përfshirë dhe shumë oficerë, me detyrën që të kryenin akte terrori dhe sabotazhi” (eliminime të personaliteteve të

veçanta dhe krijimit të një rrjeti spiunazhi dhe sabotimi në këtë vend)...

Është pothuajse e pamundur që Mehmet Shehu dhe miqtë e tij të jenë ndjerë rehat në udhëtimin komod me anijen luksoze angleze, ku shumë “gangsterë” jugosllavë (ashtu siç shqiptarët i quajnë) kanë ndarë hapësirën e kuvertës me “besimtarët e vërtetë” nga Shqipëria”.

Kur Malile shkoi tek kryeministri dhe u përpoq t’i bënte një pasqyrë të përgjithshme të reagimit të shtypit ky i kërkoi gazetat dhe u zhyt menjëherë në leximin e tyre. Tjetri u tërhoq heshtur dhe doli. Ishte i paqetë. Ai njëzet e një shtator do të qe sërish një ditë protestash, shumica larg mjediseve të rezidencës së tyre dhe selisë së Kombeve të Bashkuara, por nuk përjashtoj edhe ndonjë befasi.

Këtë herë organizuesit hungarezë të demonstratave, të cilët patën ftuar antikomunistë prej të gjitha vendeve socialiste, si fushë beteje kishin zgjedhur lagjen Harlem, kryesisht sheshin para hotelit “Negros”, atje ku qenë strehuar shumica e kryetarëve të shteteve të lidhura me Moskën.

Reis Malile e dinte se mes protestuesve do të kishte edhe shqiptarë. Ky informacion i kishte ardhur jo vetëm prej miqve të përfaqësisë së tyre, por edhe sepse ngjarjen e pritshme dhe kombet e pjesëmarrësve i patën shpallur publikisht vetë sipërmarrësit e saj. Për ta ajo do të qe demonstrata më e fuqishme ndërkombëtare që ishte bërë ndonjëherë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe entuziazmi i shifrave të parashikuara bënte fjalë për të paktën pesëdhjetë mijë vetë.

Kur po atë mëngjes u ritakua me Mehmet Shehun lajmin e asaj që pritej të ndodhte në lagjen Harlem ia dha me një ton të kujdesur që të mos i jepte mjaft rëndësi.

Kryeministri e dëgjoi pa e vështruar.

Një çast u duk sikur donte të thoshte diçka, por në të vërtetë nuk shqiptoi asgjë. “Reaksioni po bën një provë

force”, tha disa minuta më vonë ndërsa shkonin tek ashensori.

Kishte një zë të thellë, të brendshëm, tamam sikur më shumë se me të tjerët donte të fliste me veten.

Kur shkuan drejt makinave kryeministri e thirri të hynte në të tijën. Qe atje edhe Behar Shtylla. Sapo nën klithjen e sirenave të mjeteve të policisë autokolona e tyre u nis, Mehmet Shehu tha se kundër Fidel Kastros kishte shpërthyer një sulm i shtypit kapitalist amerikan vetëm e vetëm për ta njollosur.

“Çfarë nuk po i sajojnë”, pyeti më shumë veten dhe pastaj ngriti zërin: “Nuk e kuptoj sjelljen e sovjetikëve. Gjenerali Nikolai Zaharokin qe futur mes protestuesve, kishte filluar t’i shtynte majtas e djathtas, gjoja për sigurinë e Nikitës, por policët amerikanë i patën thënë se nuk ishte puna e tij të merrej me turmat. Mirëpo Zaharokin na i qenka përgjigjur me grushte dhe më në fund një polic shumë i bëshëm e paska kapur prej shpatullave dhe ngritur peshë në ajër. E paskërka lëshuar vetëm kur qenka siguruar se gjenerali ishte qetësuar”.

Pas këtyre fjalëve Mehmet Shehu heshti. Pak çaste më pas shfryu: “Hrushovi i paska bërë një protestë qeverisë amerikane dhe bashkisë së Nju Jorkut, por kjo nuk zgjidh asgjë. Në vend të ishte hero komunisti Zaharokin gazetat po e shpallin të tillë një polic të shtetit kapitalist!”

Në makinë, për një kohë, mëshoi një heshtje e zgjatur. Reis Malile u kujtua se kryeministri tufën e gazetave të ditës e kishte mbajtur në dhomën e tij dhe atij do t’i duheshin orët e drekës që t’i rimerrte për t’i shfletuar gjer në fund.

-“Gazetat thonë se Tito kur paska zbritur nga anija qenka sharë prej një grupi shqiptarësh që na duan ne”, - foli Mehmet Shehu me një zë gati ngazëllimtar, - “Cilët mund të kenë qenë vallë?”

Reis Malile u kap në befasi.

-“Mbase kanë qenë shqiptarë të Kosovës”.

Kryeministri e vështroi në sy.

-“Kështu mendoj edhe unë”.

Pasi rrodhi një copë heshtjeje Mehmet Shehu shqiptoi fjalët “Fidel Kastro është shumë simpatik. Duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet për ta takuar”.

Malile nuk ia vonoi asnjë sekondë përgjigjen: “Do t’i nis kontaktet që sot”.

Kryeministri mëmëriti diçka si “Po”. Ndoshta qe një mënyrë për ta inkurajuar apo falënderuar.

“Lexova se dje e paskan vizituar disa persona”, vijoi Shehu, “por ti duhet t’i njohësh ose të paktën t’i kesh ndjerë”.

“Po, i kam dëgjuar”, tha Reis Malile, “K kanë qenë udhëheqësi mysliman zezak Malcolm X, poeti i njohur Allen Ginsburg, po ashtu një profesor i “Columbia University”, i cili po shkruan një libër për revolucionin kuban”.

Kur në mëngjesin e herët i kishte pasur në duart e tij gazetatat, pas çfarë shkruhej për përleshjen mes shqiptarëve antikomunistë me grekët vorioepirotë, Malile pat lexuar me nxitim thashethemet për Fidel Kastron. Të gjitha gazetatat përpiqeshin sa më shumë ta përshkruanin si një aventurier, si njeri skandalesh.

Shkruhej se në “East Side Shelburne” truprojat e tij të armatosura komandonin ashensorët dhe kishin marrë në kontroll të gjitha banjat e katit ku ndodhej apartamenti i shefit të tyre. Po ashtu ata flisnin me zë të lartë.

Artikujt e shumtë përpiqeshin të dëshmonin se gjatë njëzetë e katër orëve të qëndrimit në atë hotel kryekomunisti kuban, edhe pse e kishte justifikuar ikjen e tij të bujshme me pakënaqësinë se pronari i pati vënë kusht parapagesën e dhjetë mijë dollarëve, bashkë me stafin e vet kishte shpenzuar dyfishin e çmimit, sepse qe nginjur me mish, pat pirë pa fund rum dhe tymosur cigare puro.

Ndërsa ishin larguar nga hoteli pa asnjë paralajmërim kubanët patën lënë pas dhoma të kthyer në kazanë plehrash, të mbushura me mbeturina ushqimesh dhe erë duhani, shishe të zbrazura dhe mobilie të dëmtuara. Gazetat shkruanin se me karvanin e madh të makinave dhe të futur në mes prej sirenave të policisë Fidel Kastro, pasi kishte dërguar më parë një marrëveshës të tij në hotelin “Theresa”, që kthyer në selinë e Kombeve të Bashkuara. Pati kërkuar takim me Dag Hammarskjold dhe ky e kishte pritur menjëherë.

Edhe pse Kastro tërë kohën pati folur me zë të lartë, madje shpesh edhe bërtitur, Sekretari i Përgjithshëm, duke qenë një suedez me temperament të qetë, e kishte dëgjuar me buzën në gaz. Nuk që nervozuar as kur ai pati sharë Manhattanin apo kishte kërcënuar se do të flinte demonstrativisht në oborrin e selisë së OKB-së.

Hammarskjold mezi e kishte përmbajtur të qeshurën dashamirëse kur revolucionari i ardhur nga ishulli i Kubës pati paralajmëruar se do t’ia fuste gjumit në Central Park. “Kurrë nuk do të fle në hotelet kapitaliste të Nju Jorkut”, kishte bërtitur një çast dhe përplasur mbi gju grushtin.

Kur u duk se Fidel Kastro e pat derdhur shumicën e zemëratës Hammarskjold e kishte ftuar atë, me të gjithë bashkëpunëtorët e shoqëruesit, të hanin në tarracën e Pallatit të Qelqtë. Po ashtu u vinte në dispozicion dhoma falas në hotelin “Comodore”, madje edhe me garancinë të mos bezdiseshin nga demonstratat.

Por pasi kishte mbaruar të gjithë poteren dhe që siguruar se atë e kishin marrë vesh gazetatat, Fidel Kastro u nis për në strehën e re, hotelin “Theresa”. Aty tashmë patën marrë me qira një kat të tërë dhe paguar në dorë më shumë se dyfishin nga sa i kishte kërkuar një ditë më parë “East Side Shelburne”.

Pikërisht këtu e kishte vizituar krejt pa e paralajmëruar Nikita Hrushovi. Ai i pat hipur makinës së tij luksoze “Cadillac” dhe ja kishte shkelur gazit pa u thënë fare agjentëve amerikanë të sigurisë. Këta mezi e kishin mbledhur veten dhe me ulërima sirenash hipur makinave të tyre.

Pamja e përqafimit entuziast të Fidel Kastros me Hrushovin, krahët e tyre të hapur dhe rënia e shpatullave njëri-tjetrit gjendej masivisht nëpër faqet e brendshme të përditshmeve. Fotoreporterët i kishin fiksuar në të gjitha planet.

Kronistët patën regjistruar dhe hedhur në reshta fjalët e bujshme të kryeministrit sovjetik “Vizita ime bëhet te një njeri heroik”.

Kur mbërritën në sallën e madhe të Asamblesë i njoftuan se të gjitha delegacionet qenë sistemuar në vende të tjera. Kjo pat ndodhur thjesht për shkak të futjes të trembëdhjetë anëtarëve të rinj.

Mehmet Shehu nuk e fshehu harenë kur pa se rreshti i tyre i ri ndodhej shumë larg sovjetikëve, por kërkoi një çast me sy ku qenë rregulluar jugosllavët.

Ndodheshin afër grupit të Hrushovit.

Vuri re se mes njerëzve të dërgatës së Beogradit Tito ato çaste nuk qe.

Kryeministri tha se nuk ndihej keq që fqinjë tani kishin bullgarët. Ajo prani nuk e trishtonte, edhe pse Zhivkovi vazhdonte të rrinte buzëvarur, mbase enkas i paafrueshëm se mos kryeministri shqiptar i hapte çështjen e ndihmës me drithëra. Por vazhdonin të ishin të çiltër e shumë të sjellshëm ministri i tij i Jashtëm si edhe Përfaqësuesi i Përhershëm i Bullgarisë në OKB.

Në afërsi të rreshtit me tabelën “Albania” gjendeshin edhe delegacionet angleze dhe amerikane, por për ta Mehmet Shehu nuk u shfaq as i bezdisur dhe as i interesuar. Vetëm

kur filloi mbajtja e seancës të parë u kuptua se Josip Broz Tito atë paradite nuk do të vinte. Vendi i tij mbeti bosh. Ndoshta kjo ishte mënyra që presidenti jugosllav kishte zgjedhur për të tërhequr vëmendjen e shtypit dhe vazhduar të mbetej lajm.

Në krye të ekipit të Beogradit rrinte me vëmendje të mprehtë tek folësit në podium Koça Popoviç.

Reis Malile, që herë pas here e mbante nën vëzhgim dyshen jugosllavo-sovjetike në skajin tjetër të sallës, vuri re një çast si nënministri i Jashtëm i Moskës doli nga salla bashkë me kolegun e tij beogradas. Të dy ecnin e bisedonin me mjaft intimitet.

Pak më vonë në drejtimin e të larguarve doli edhe Hrushovi bashkë me përfaqësuesin e Përhershëm të Jugosllavisë në OKB. Në të vërtetë ata në fillim biseduan kokë më kokë për pesë minuta dhe vetëm më pas dolën që të dy nga salla.

Gjatë seancës Mehmet Shehu, shumicën e kohës i heshtur, shprehu habinë se si ata që flitnin, të gjithë kryetarë shtetesh apo qeverish, nuk kishin një kufi kohor. Mund të mbanin fjalime edhe një apo dy orëshe.

Kur u kthyen në rezidencë, ndërsa kryeministri u mbyll në apartamentin e tij, Reis Malile u fundos në leximin e gazetave.

“Demonstrata kundër komunizmit që do të mbahet mend në Nju Jork”, kishin zgjedhur si titullin më të pëlqyer shumica e tyre.

Prej të gjithë korrespondentëve të pranishëm në ngjarje pjesëmarrja vlerësohej mjaft imponuese: afro dhjetë mijë protestues shumë aktivë, çfarë sipas tyre donte të thoshte një njeri që vepronte sa për dhjetë.

Manifestimi kishte zgjatur plot dyzetë minuta, aq sa edhe pati dhënë leje policia lokale. Gazetat po ashtu saktësonin se ndërsa që korrekt me vendin, orarin dhe kohën e zhvillimit, demonstrata kishte pasur disa momente në të

cilat mund të dilte nga kontrolli jo vetëm i organizatorëve, por edhe i trupave të shumta të policisë.

Alarmi më i madh u shkaktua jo prej pasionit protestues të antikomunistëve, por prej pranisë së shtuar, aspak të parashikuar më parë, të emigrantëve dhe madje edhe të qytetarëve amerikanë pro qeverive të vendeve të kampit socialist. Kundër antikomunistëve këta jo vetëm patën tundur grushte dhe banderola, por disa nga më zemërakët u qenë vërsulur kundërshtarëve ideologjikë edhe me grushte dhe shkelma.

“Pati shumë urrejtje”, shënonte një e përditshme dhe pastaj merrej me këtë zbulim që kishte bërë. Autori i komentit ndihej me të vërtetë i shtangur nga ajo që i patën parë sytë: furia e mllëfit të shprehur ndaj njëra-tjetrës.

Ngulte këmbë se kjo karakteristikë e dallonte shumë qartë atë turmë të madhe të irrituar ideologjikisht nga çdo grumbullim tjetër demonstrues i qytetarëve amerikanë, përherë i përmbajtur në gjestet e shprehjes së zemërimit.

Që të gjitha gazetat, secila sipas mënyrës së vet, bënë të dukshëm edhe një episod: ndërhyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Dag Hammarskjold. Rrëfenin se ai kishte marrë në duar një altoparlant dhe gjer në lodhje u pat bërë thirrje protestuesve të qenë më të vetkontrolluar, të paktën para syve të kaq shumë delegacioneve të huaja dhe gazetarëve të ardhur nga e gjithë bota.

U kishte kërkuar disa herë të manifestonin kulturë demokratike. Pa reshtur së shpjeguari dhe pa e ulur fortafolësin për një gjysmë ore të gjithë dhunën Hammarskjold e pat quajtur të padobishme si për ata që në vendet e tyre të origjinës përkrahnin qeveritë komuniste si edhe për të tjerët, mbështetësit e të kundërtës.

Gjithsesi ndërsa me t’u mbushur kohëzgjatja e dyzetë minutave pjesa e qetë e protestuesve ishin shpërndarë,

kacafytësit e veçuar u përleshën edhe më, madje për një kohë të gjatë. Policia mezi i ndau.

Një pjesë, veçanërisht ata që thyen xhama vitrinash apo përmbysën makina, i ndaluan.

Të tronditura nga ajo dëshmi e pazakonshme zemërimi gazetat nuk mungonin të bënin të ditur edhe shifrën e dëmit material. Manifestimi i protestuesve antikomunistë dhe i rivalëve të tyre pat shkaktuar një humbje prej më shumë se dhjetë mijë dollarësh.

“Shoku Enver, mbrëmë natën, për inat kërkuam të shëtisim në Broduej...”

Dy orë para se të niseshin për në seancën e dytë, përkundruall Misionit, si të qe një lumë që fryhej përherë e më shumë, mbërritën një numër i madh policësh dhe detektivësh. Po ashtu nisi të shtohet nga çasti në çast edhe sasia e automobilave të tyre. U kuptua që pritej ndonjë demonstratë.

Megjithatë për ca kohë protestues nuk u panë.

Kur këta u shfaqën, masë ato çaste çuditërisht e pa zë, qenë rreth pesëdhjetë vetë. Nga parullat e kartonta dalloheshin që shumica ishin antikomunistë shqiptarë.

Reis Malile shkoi menjëherë në apartamentin e kryeministrit dhe e vuri në dijeni për çfarë po ndodhte. Ky e pa ngultas, por nuk tha asnjë fjalë. U duk vagëllimthi sikur kishte dëshirë ta pyeste rreth diçkaje jo të qartë.

Kur Malile hyri në zyrën e tij ra telefoni, por në fillim ai vendosi të mos e ngrinte dorezën. Pastaj ktheu mëndje. Në receptor zëri matanë fillit i tha emrin.

I shprehte solidaritetin kryeministrit shqiptar.

Me zë të lartë, si të bënte një deklaratë solemne, tha “Jam amerikan. Ata që janë mbledhur para Misionit tuaj nuk shprehin ndjenjat e popullit tim, as të emigrantëve shqiptarë. Na vjen keq seriozisht kur shohim veprime të tilla të ulëta në një kohë që në OKB pritet të diskutohen probleme shumë të rëndësishme”.

Reis Malile e falënderoi dhe sapo e uli dorezën telefoni tringëlliu përsëri. Qe një shqiptar. Edhe ai ishte në mbështetje të Mehmet Shehut dhe mendimit se

protestuesit para Misionit po kryenin një punë të gabuar. Në fund shqiptoi “Mirë u pafshim!”

Të dy telefonuesit duhej të ishin fare afër, me siguri në vende prej ku e shihnin çfarë po ndodhte. Ndoshta përdornin ndonjë kabine rruge.

Ndërkohë jashtë demonstruesit vazhdonin të protestonin. Shfaqnin zemërim, por gjithsesi të përmbajtur. Më shumë se gjest i fortë kundërshtimi ajo që po bënin ngjante me një veprim në formë spektakli.

Ndoshta të gjithë inatin e patën shkarkuar në manifestimin e parë dhe këtë herë kishin ardhur për të kryer një akt formal, të sigurt se sidoqoftë nuk do të mbetnin duarbosh. Protesta e tyre do të binte në sy të gazetave.

Dhjetë minuta më vonë zërat jashtë u fashitën. Reis Malile shkoi sërish tek dritarja dhe pa se grumbulli i demonstruesve po ikte. Morën dalëngadalë drejt Pallatit të Qelqtë. Patjetër do të protestonin edhe atje. Ishte koha kur fillonin të vinin delegacionet.

Vorioepirotët u shfaqën shumë shpejt. Dukej sikur kishin qenë fshehur në një nga kthesat dhe me të parë që shqiptarët ikën, hynë në shesh. Nisën të demonsttronin, por edhe ata nuk dukeshin se kishin ndonjë mlllef të veçantë. Për një gjysmë ore nuk hodhën me zë asnjë thirrje. Mbajtën pllakate nëpër duar dhe vetëm erdhën rrotull në heshtje. Dallohej qartë që i kishin shtuar kartonët me sipër fjalët “Vorio Epiri është tokë greke”.

Pastaj u shpërndanë.

Malile trokiti në derën e apartamentit të Mehmet Shehut për t’i thënë se tashmë mund të niseshin. Ky sapo e pa i zgjati tekstin e një radiogrami për Enver Hoxhën.

“Të niset ky”, tha prerë, “Pastaj ne!”

Malile shkoi menjëherë tek zyra e shifrës dhe përcolli urdhrin e kryeministrit. Mesazhi nuk ishte shumë i gjatë dhe mund të kodohej brenda dhjetë minutave.

Në njërin nga paragrafët e shkurtra, të gjitha të nisura me numra rendorë, Mehmet Shehu shkruante “Mbrëmë natën, për inat kërkuam të shëtisim në Broduej, rruga kryesore. Duallëm me makinë gjysmë ore dhe u tund Nju Jorku nga sirenat shurdhonyjëse si edhe karvani prej 10 makinash e shumë motoçikleta me detektivë e policë, që na shoqëronin, e mijëra policë që kishin bllokuar gjithë rrugët prej 15 kilometra nga kaluam. Miletë shikonin të habitur nga karvani policor”.

Reis Malile vuri buzën në gaz. Shehu i raportonte çdo gjë Enver Hoxhës, menjëherë sapo ajo të ndodhte. Po të qe për të, si Përfaqësues i Përhershëm pranë OKB-së, ato çaste nuk do t’i jepte rëndësi raportimit për një kalim gjysmë orësh në zonën e të pasurve të Nju Jorkut, në Broduej.

Do ta bënte këtë njoftim në një përmbledhje të mëpasshme, kur të raportonte me nge edhe vizitat çlodhëse të kryeministrit. Në momentet që po kalonin, kishin rëndësi informacionet politike dhe analizat e para mbi to.

Në një nga paragrafët e atij radiogrami të mesditës së 21 shtatorit Mehmet Shehu ia bënte një të tillë “Atmosfera është e nderë. Sundon policia sikur të ishte ngritur gjithë Nju Jorku për të na vrarë dhe ata të na mbrojnë. Unë ngado që shkoj jam i rrethuar nga 20 policë e detektivë me makina me sirena të vazhdueshme e shurdhonyjëse si zjarrfiksa dhe të armatosura etj. Tek porta rrinë vazhdimisht mbi 20 policë, shkallët e korridoret ruhen nga njerëz të tjerë. Atmosferë terrori. Rrugës çdo 10 metra ka policë. Kavaleria, kamionët e armatosur, veturat me detektivë, bllokojnë rrugët e demonstrojnë. Para OKB-së qëndrojnë mbi 1000 policë. Hrushovi është mbyllur në Mision e del vetëm për në OKB. Por, si gjithë herët, bën shakara me këdo që i del përpara e gazetarët e rrethojnë ngado. Çfarë do të ndodhi nuk dihet, vetëm se Ajzenaueri do të flasë e thuhet se do kërkojë që t’i jepet ndihmë

Afrikës. Flitet se Tito pas presidentit amerikan do të paraqesë mendim për grupimin e neutralëve rreth tij. Hrushovi do të flasë pas tyre”.

Në radiogramin raportues për Enver Hoxhën atë pasdite Mehmet Shehu nuk kishte harruar edhe përleshjen e antikomunistëve me vorioepirotët: “Dje para OKB-së u rrahën shqiptarët me grekët. Nuk dimë çfarë shqiptarë qenë”.

Më pas e informonte “Gazetat thonë se Titon e shanë një grup tek porti kur zbriti e gjoja këta qenë shqiptarë simpathizantët tanë, po ne s’dimë gjë”.

Reis Malile ishte duke u kthyer në zyrën e tij dhe radiogrami akoma tërësisht i shifruar, kur kryeministri doli nga apartamenti.

“Ikim për në OKB!”, i tha.

Pak minuta më pas u hipën makinave dhe si përherë të shoqëruar nga policët, detektivët, motoçikletat dhe sirenat e shumta, u nisën për në seancën e dytë. Ndërkohë Reis Maliles i ra në sy se rojet amerikane silleshin disi më kujdesshëm, qenë më të butë.

Kur nuk ishin veç njëqind metra larg Pallatit të Xhamtë papritur Mehmet Shehu shqiptoi emrin e Fan Nolit. Pastaj në pak sekonda e bëri të qartë gjithçka. Donte nga Malile që në rastin e parë të mundshëm të pinin së bashku një kafe dhe të bisedonin lirisht për jetën e tij në SHBA.

Kur u futën në sallë fjalimet e përfaqësuesve të shteteve Shehu i ndoqi ulur në vendin e vet, në heshtje dhe duke mbajtur ndonjë shënim. Megjithatë një çast u ngrit e shkoi tek Antonin Novotni.

E përshëndeti ngrohtësisht, por edhe ky ia shtrëngoi dorën me dashuri.

Kështu ndenjën bashkë për disa çaste kur seanca e dytë u mbyll dhe delegacionet, para se të iknin nëpër hotelet apo

rezidencat e tyre, kishin zakon që në Pallatin e Qelqtë të kryenin kontakte pune.

Mehmet Shehu dhe Novotni u takuan në sallon. “Kush e priti Titon në port nga qytetarët amerikanë?”, pyeti një çast presidenti çekoslovak.

“Titos as ja kam parë fytyrën e jo të di se kush e priti”, iu përgjigj kryeministri shqiptar.

“Po juve cilët ju pritën në port?”, vijoi tjetri me sa duket i shtyrë jo thjesht prej ngasjes së kërshërisë.

“Vetëm policia dhe disa të dërguar nga vendet miq”, i tha Shehu.

“Sikurse edhe mua”, shtoi Antonin Novotni.

Të kthyer në Mision kur nata ishte bërë e thellë në fillim kryeministri hëngri darkë dhe pastaj u mbyll në apartamentin e vet. Kishte pyetur një çast t’i kujtonin orarin e transmetimit në valë të shkurtra të radios të emisionit shqip dhe kur i thanë se për atë ditë ajo mundësi kishte kaluar, u përgjigj se do ta provonte të nesërmen. Ishte edhe mjaft kurioz për forcën e zërit dhe cilësinë e programit.

Pastaj u përul mbi tufën e fletëve të fjalimit që do të mbante në 26 shtator.

Ndërkohë ai i plotësuar i duhej nisur sa më shpejt Enver Hoxhës në Tiranë.

Mehmet Shehu: “Ata që u rrahën dje me grekët ishin ballista”

Nuk kishte shkuar ende ora 22.30 kur Mehmet Shehu i dha Reis Maliles radiogramin e dytë të asaj dite.

Në kthinën e tij sekrete shifruesi i vuri numrin 339: “Shokut Enver, 1)...Do veprojmë sipas porosisë...

3) Ata që u rrahën dje me grekët ishin ballista... Sot pas dite disa dhjetëra vorioepirotë demonstruan para Misionit, por ka më shumë policë rreth nesh se sa protestues. Gazetat botojnë fotografi sensasionale me policë duke rrahur e zvarritur demonstrues. Atmosfera e alarmit policor sundon rëndë. Neve nuk na bëhet qejfi qeder...

5) Unë do flas javën që vjen. Merak mos kini, nervat i kemi në rregull, armiqtë na duken si miza e i pështyjmë.

6) Hrushovi do flasë të premtën por gjer tani nuk na kanë thënë asgjë mbi çfarë do shtrojnë dhe ne as që kemi për t'i pyetur vetë. Ne jemi të qartë për qëndrimin që duhet mbajtur. Përfaqime. Mehmeti”.

Tek rikthehej për në zyrën e tij Maliles ende nuk i ishte hequr nga mendja ajo mënyrë të shprehuri e kryeministrit “Merak mos kini, nervat i kemi në rregull”. Edhe tek radiogrami i pasdites kryeministri pati “Merak mos kini. Jemi shumë mirë. Nervat i kemi të qeta”.

Ndërkohë nuk qe rikujtuar për atë kafën e përbashkët dhe bisedën e shpenguar rreth Fan Nolit.

Buqetë e madhe me lule nga Komiteti i Partisë Komuniste të Nju Jorkut

22 shtatori ishte dita kur do të fliste presidenti amerikan Duajt Ajzenauer dhe Josip Broz Tito.

Ndërkohë që në mëngjes dy të përditshme njujorkeze shkruanin se pasditen e shkuar delegacionin ukrainas si edhe godinën e Misionit jugosllav e kishin qëlluar me domate dhe vezë.

Nuk thuhej cilët qenë të zemëruarit, të çfarë kombësie apo bindjeje politike.

Para se delegacioni shqiptar të nisej për në sesion mbërriti një buqetë e madhe me lule. E kishin dërguar nga Komiteti i Partisë Komuniste të Nju Jorkut.

Në kartëvizitën shoqëruese nuk mungonte edhe një tekst i shkurtër përshëndetës.

Mehmet Shehu u emocionua dhe e ngarkoi menjëherë Reis Malilen të hartonte disa radhë falënderimi, veç t'i bënte bukur. Do të qe në emër të tij. E porositi t'u thoshte komunistëve amerikanë se qenë të ftuar për një drekë. Pastaj shtoi nëse do të ishte e mundshme që atë tufë lulësh ta mbante në apartamentin e tij.

Në sallën e Asamblesë, tek po uleshin në vendin e tyre, u afrua menjëherë përfaqësuesi i Përhershëm i Bullgarisë dhe i vuri në dijeni se kishin rënë dakord që kur presidenti amerikan të hynte për të mbajtur fjalimin ata të ngriheshin në këmbë, por jo të duartrokitnin.

Mehmet Shehu u zbeh nga një zemërim i beftë.

“Ne as edhe në këmbë nuk do t’i çohemi”, shqiptoi me fjalë të ngurtësuara si kallëpe akulli.

Diplomati bullgar heshti.

“Nuk do t’i ngrihem në këmbë, as Titon nuk do ta duartrokasim”, vijoi kërcitshëm kryeministri. Pastaj vazhdoi: “Do të shkojmë edhe më tej, pra do të dalim demonstrativisht nga salla, në rast se ai agent i imperialistëve sulmon vendin tonë”.

Bullgari vuri buzën në gaz. Tha: “Ju kuptoj” dhe iku për t’u ulur fare pak metra më tej, në vendin e vet.

Ndërkohë Ajzenauer me limuzinën e tij gjysmë të zbuluar, i vënë në mes nga makina të tjera dhe motoçiklistë, u shfaq në rrugën që të çonte në hyrjen e pasme të Pallatit të Qelqtë.

Me ta parë kalimtarët ndalën në buzëtrotuare. Ai vetë, në këmbë, herë me të dyja duart dhe herë me njërin prej tyre, sepse me tjetrën mbështetej mbi supin e një truproje që rrinte në ndenjësën e parë, i përshëndeste të gjithë, shumë sjellshëm.

Fjalimi që do të mbante atë paradite në debatin e përgjithshëm të Sesionit të 15-të do të qe sfidues për atë që pritej më pas të mbante Nikita Hrushovi. Ai ballafaqimi i madh i atij shtatori 1960 ishte gati pjesë e garës elektorale me Xhon Kenedin. Edhe pse tashmë qe në mbyllje të mandatit dhe në poltronin e Shtëpisë së Bardhë pritej të ulej i riu demokrat, pikërisht për këtë arsye plaku Ajzenauer dëshironte të linte pas një mbresë dhe po ashtu një fitore të bukur.

Kjo do të bëhej e realizueshme në rast se do t’u tregonte bashkëkombësve të vet dhe gjithë botës se ëndrra e njerëzimit ishte shoqëria e lirë dhe aspak ajo e mbërthyer në një diktaturë. Në rast se këtë alternativë vazhdonin ta refuzonin vendet e kampit socialist, nuk kishte përse të

mos e pranonin shtetet e reja afrikane apo shumë kombe të tjera në Azi.

Ata që tashmë quheshin neutralë, nuk duhej të binin preh e ndikimit sovjetik. Le të qëndronin të paangazhuar në politikën tyre të jashtme, bashkëpunues me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Sovjetik, njëherësh me Perëndimin dhe Lindjen, por në sistemin e tyre të brendshëm politik të mos zgjidhnin qeverisjen tiranike.

Menjëherë sapo hyri në godinën e Pallatit të Qelqtë Ajzenaueri në një nga mjediset takoi fillimisht Jawaharlal Nehrunë dhe më pas presidentin Gamal Abdal Nasser. Mes neutralëve India dhe Egjipti nuk ishin vetëm dy vende të mëdhenj, por edhe shtete prijës, mjaft ndikues në grupin e tyre paangazhues.

Për t'i rreshtuar në krahun e vet nuk qe përpjekur më pak edhe Nikita Hrushovi. Ai e kishte pritur që një ditë më parë Naserin në vilën me kopsht të madh të rezidencës sovjetike në periferi të Nju Jorkut, në Glen Cove të Long Island. Ndërkohë atë 22 shtator në kontaktin me presidentin egjiptian ishte treguar më i shpejtë Josip Broz Tito.

Ai e kishte takuar disa orë më parë në rezidencën e Misionit jugosllav në Manhatan. Në pritje që të dilnin para godinës, ku në një rën prej dritareve të katit të tretë qe nderur një flamur i madh tre ngjyrësh, me yllin e kuq në mes, ishte grumbulluar një grup të vogël emigrantësh beogradas.

Kur Naseri dhe Tito, që të dy elegantë, zbritën shkallët e tre kateve dhe presidenti jugosllav e shoqëroi kolegun egjiptian deri sa hipi në makinën e tij, kryetari i shtetit federativ jugosllav qe i veshur i gjithë me të bardha.

Naseri ishte me një kostum gri shumë të errët dhe një shami të bardhë në xhepin e sipërm të xhaketës. Qe Josip Broz Tito që me pëllëmbën e dorës së majtë i ra dy herë

shpatullave presidentit egjiptian, pastaj ia qarkoi krahun rreth mesit. Ishte një gjest intim grishjeje për ta përqaftuar. Papritmas Naser u prek dhe para gazetarëve dhe bliceve të fotoreporterëve e ktheu trupin e tij të gjatë nga Tito. Pastaj iu lëshua në krahë. Një sekondë më vonë e rrëzoi kokën e bukur, me flokë të shkurtër kaçurrelë, mbi supin e majtë të presidentit jugosllav.

Ndenjën ashtu një kohë, më pas u përqaftuan duke i kryqëzuar duart në shpatullat e njeri tjetrit. Kur më në fund i shkëputën trupat nga ajo përqaftje malluese u rikthyen përballë fotoreporterëve dhe bënë një gjest tjetër dashurie: u kapën prej dore.

Flet në OKB presidenti amerikan Duajt Ajzenauer

Kur më në fund presidenti amerikan, duke ardhur nga dera e pasme afër podiumit, hyri dhe u shfaq para mizërisë së pjesëmarrësve të Asamblesë, e mbuluan me duartrokitje. Veç asnjëri prej kaq shumë delegacioneve mirëdashëse nuk u çua në këmbë.

Në një gjest dukshëm refuzimi duart nuk i përplasën vetëm dërgatat e vendeve socialiste.

Mehmet Shehu qëndroi fare i ftohtë, i palëvizur.

Reis Malile u mundua të shquante nëse mosduartrokitjen e kishte bërë edhe Fidel Kastro, por prej vendit të tyre kjo që shumë e pamundur të dallohej. Ndërkohë ishte e kapshme çfarë gjesti kreu Tito. As ky dhe të tijtë nuk e duartrokitën hyrjen në sallë të Duajt Ajzenauerit.

Por si kishte vepruar presidenti i Federatës Jugosllave e kishte vëzhguar me kujdes edhe Mehmet Shehu. Mblodhi buzët, si në një përtallje.

Fjalimi i presidentit amerikan u ndoq me shumë vëmendje. Ajzenaueri nguli këmbë për një përpjekje të vërtetë për çarmatimin botëror, të përgjithshëm dhe të plotë dhe pas kësaj e detyrës që binte mbi Kombet e Bashkuara për të vigjiluar dhe parandaluar sulmet ushtarake të befasishme.

Kur mbaroi nuk zbriti në sallë të ulej në vendin e delegacionit me në krye tabelën USA, siç kishte vepruar në 20 shtator, ditën e çeljes së punimeve, por doli menjëherë prej të njëjtës derë nga hyri.

Kur erdhi radha e Titos ky u ngrit prej poltronit dhe me hap të ngadaltë, dukshëm hijerëndë, parakaloi sheshin para radhëve të para të sallës, doli prej derës anësore dhe

një gjysmë minute më pas u shfaq në lartësinë e butë të sheshit të tribunës.

Shfaqja e tij para dy mikrofonave të foltores nuk e nxiti sallën t'i bëjë ndonjë duartrokitje të posaçme. U dëgjuan aty-këtu vetëm disa përplasje të shkurtra duarsh.

As prej vendeve socialiste nuk i shfaqën vëmendje.

Heshtën hungarezët dhe rumunët, po ashtu edhe polakët. Indiferentë u treguan edhe anglezët e amerikanët. I dërguan duartrokitje vetëm sovjetikët dhe bullgarët.

Kur prej shumë pjesëmarrësve në atë sallë nuk pritej, presidenti jugosllav mbështeti qëndrimet e qeverisë sovjetike për çështjen e çarmatimit e të paqes botërore. Kjo Mehmet Shehut ia përzjeu në fytyrë habinë me inatin.

Kur në kohën e drekës dolën nga salla për të shkuar në Mision kaloi shumë afër delegacionit shqiptar Arkadievi, zëvendëssekretari i Përgjithshëm i OKB-së. Sovjetiku në fillim u duk se do të ikte më tej, duke bërë ndoshta lojën e një njeriu që nuk i kishte parë, porse në të vërtetë i ndali menjëherë këmbët dhe Mehmet Shehut sa nuk iu hodh në qafë. U përshëndet ngrohtë edhe me të tjerët.

Në ato pak çaste kryeministri shqiptar e pyeti se si i qe dukur fjalimi i Titos.

“Më i arsyeshëm se i Ajzenauerit”, u përgjigj Arkadiev.

“Po ai foli si revizionist i poshtër dhe agjent i SHBA-së”, brofi Shehu. Shtoi: “Edhe pranimi i qëndrimit sovjetik ishte një hipokrizi. Tito nuk tha asnjë fjalë kundër imperializmit amerikan. Ai dukej qartë se nuk e thoshte dot me fjalë, por me zemër qe me Ajzenauerin”.

Arkadiev vuri buzën në gaz.

“Sidoqoftë ishte një fjalë më e logjikshme se e shefit të imperialistëve”, tha.

“Po të na prekte në fjalim ne do të iknim demonstrativisht nga salla”, njëra pas tjetrës përplasi fjalët kryeministri shqiptar.

Ndërsa hipën në makina qielli mbi Nju Jork dukej më i vrenjtur se sa kish qenë në mëngjes.

“Këtu shiu është më i butë se në anët tona”, tha mendueshëm, pa ja hequr sytë qiellit, Mehmet Shehu.

“Megjithatë bie shumë. Ta kishim do t’i bënte mirë bujqësisë sonë”.

Vritet aksidentalisht nga truprojat e Fidel Kastros një vajzë nëntë vjeçare

Pasdite seanca nisi e mërzitshme, pa asgjë të re. Ajo nuk u trazua sadopak as nga hyrja e Nikita Hrushovit dhe e një grupi të vogël me të. E ndiqnin ngulmues nga pas disa gazetarë.

Ai u shfaq papritur jo nga krahu i djathtë i sallës së Asamblesë, prej ku ishte më e zakonshme hyrje-dalja e delegacioneve, por në të kundërt. Ndoshta këtë herë e kishte bërë zgjedhjen sepse pikërisht në atë anë gjendej vendi i delegacionit sovjetik. Mbase edhe sepse atë çast i interesonte të mos tërhiqte mbi vete asnjë vëmendje të qindra pjesëmarrësve në sallë.

Mundej të qe kjo e dyta sepse sapo hyri bëri një shmangie nga rruga më e drejtpërdrejtë për në poltronin e tij dhe iu afrua Mehmet Shehut.

I zgjati dorën.

Ky mbeti disi i hutuar, po arriti t'ia shtrëngonte dhe t'i buzëqeshte. Pas këtij veprimi të heshtur Hrushovi shkoi në vendin e vet dhe dy nga bashkëpunëtorët e tij i bindën qetësisht gazetarët të largoheshin.

Këta dolën nga salla duke ngrënë nëpër dhembë copëra fjalësh.

Një gjysmë ore më pas, i shoqëruar nga Behar Shtylla, kryeministri shkoi tek rreshti i delegacionin hungarez dhe takoi Janosh Kadarin. Ky dukej i padëshiruar ta kapërcente bisedën përtej fjalëve të rëndomta “si jeni” dhe “si shkoni”.

Më pas Mehmet Shehu eci drejt vendit të delegacionit rumun. George Dezhi u ngrit në këmbë dhe i doli përpara. Përpiqej të qe i sjellshëm.

Çështja e vetme e rëndësishme që zgjonte interesimin e tij doli kërshëria nëse në transatlantikun “Queen Elizabeth” kryeministri shqiptar e kishte takuar Titon.

“As e kam takuar dhe as kam për ta takuar kurrë”, iu përgjigj Shehu.

Papritmas fytyra shumë lëkurëbardhë e Dezhit u mbush me rremba të lehta të kuqërremta, thua ato çaste i gjithë gjaku i qe grumbulluar në cipë të faqes.

–“Po sikur këtu në Nju Jork, në OKB për shëmbull apo në ndonjë vizitë në Manhatan, të ndesheni rastësisht dhe të jetë ai që t’ju përshëndesë?”

–“Në asnjë rast nuk e përshëndes dhe nuk i flas sepse është agent”, - preu shkurt Mehmet Shehu.

Dezhi lëshoi një gulç të qeshuri dhe u ul në vendin e tij.

Kur ora iu afrua nëntëmbëdhjetës Nikita Hrushovi u ngrit nga vendi dhe i shoqëruar nga disa prej të vetëve mori rrugën për të dalë. Sikur të kishin qenë fshehur poshtë tavolinave të sallës ia behën sërish gazetarët dhe e vunë në mes.

Ai u dredhoi siç bëri kur hyri. U shmang duke shkuar drejt rreshtit ku gjendej Mehmet Shehu. Sapo iu avit iu lut: “Shpëtomë nga këta! Do të mbrohem nga shqiptarët”.

“Jemi gati!”, iu përgjigj tjetri, por ndërkohë u skuq në fytyrë.

“Hajde të ikim fshehurazi si anglezët”, pëshpëriti Hrushovi.

“Jepni shëmbullin e do u ndjekim”, e vijoi shakanë Shehu. Por ndërkohë Nikita i nxitoi hapat drejt daljes dhe gazetarët iu ngjitën sërish nga pas.

Një çerek ore më vonë edhe delegacioni shqiptar u nda mëdysh. La të ndiqnin punimet e sesionit tre nga anëtarët,

përfshi edhe Reis Malilen, kurse kryeministri dhe ministri i Jashtëm u kthyen disa çaste në Mision.

Pak më vonë morën rrugën për në darkën e organizuar nga kryeministri i Togos. Kur mbërritën e kuptuan se tek për zgjedhja e pjesëmarrësve kishte vepruar një protokoll i rreptë. Qenë ftuar vetëm kryetarë qeverish apo shtetesh. Nga vendet e kampit socialist të tillë ishin vetëm Nikita Hrushovi, Antonin Novotni dhe Mehmet Shehu.

Zhivkovi, Kadari, Dezhi e Gomulka, të cilët mungonin, qenë vetëm sekretarë të parë të partive të tyre.

Për kryeministrin shqiptar ajo darkë që në fillim u duk e mbarë. Vuri re se mund të bisedonte me përfaqësues të vendeve afrikane dhe aziatike dhe me këtë rast t'i bënte një sfidë Titos. Gjatë dy orëve ia arriti shumë takimeve me ta, madje edhe një rezultati. Kryeministri pakistanez iu shpreh për lidhje marrëdhëniesh diplomatike.

Ndërkohë i la përshtypje të ngrohtë biseda me dy funksionarë të lartë të Partisë Komuniste Sovjetike, njëkohësisht qeveritarë.

E kaloi shumë çiltër edhe takimin me zëvendëskryeministrin e Bjellorusisë. Kiseljov i pohoi se fjalimi i Ajzenauerit ishte i zbehtë dhe pa gjë konkrete, madje fare pa brendi. Ai i Josip Broz Titos i qe dukur deri diku mirë.

Mehmet Shehu iu përgjigj se ishte shumë dakord për çfarë mendonte rreth fjalës së presidentit amerikan, porse ajo që pat shqiptuar në Asamble njeriu i Beogradit ishte e poshtër, tipike për një revizionist, për një demagog që nuk ka qëllim tjetër veç të gënjejë popujt në botë.

“Ne shqiptarëve Tito nuk na hedh dot hi në sy”, i mëshoi fort fjalëve Mehmet Shehu.

“Dakord, dakord!”, u përgjigj me të shpejtë Kiseljov, më shumë për të mos ja prishur humorin. “Nuk mund të

presësh me tepër nga Tito. Ai i tillë është gatuar”, vazhdoi menjëherë.

Pak minuta më pas, duke e larguar bisedën nga presidenti jugosllav, Shehu e pyeti zëvendëskryeministrin bjellorus se për sa kohë Nikita Hrushovi mendohej të qëndronte në Nju Jork.

Mori gjashtë fjalë të shkurtra: “Jo më pak se një muaj”.

Kur u kthye në Mision Reis Malile i dha Mehmet Shehut dy lajme. I pari kishte të bënte me Fidel Kastron. Ky i pat pranuar të takohej me kryeministrin shqiptar.

Ndërkohë e informoi kryeministrin se kishte ndodhur një aksident, të cilin media amerikane po e përhapte pa pushuar. Qe vrarë aksidentalisht nga truprojat e Fidel Kastros një vajzë nëntë vjeçare, venezuelase. Radiot e televizionet e përsëritnin vazhdimisht historinë e saj. Si shpërblim që e vogla kishte dalë mirë me mësimet dy prindërit e patën marrë me vete në një vizitë turistike në Nju Jork. Të tre qenë duke darkuar në një restorant, kur ndërkohë kishin hyrë brenda për t’u grindur me disa disidentë antikomunistë të ulur në tryezën pranë, një tufë nga rojet e Fidel Kastros.

Zënka me fjalë pat përfunduar në të shtëna mes dy palëve dhe njëri prej plumbave vrau në vend vajzën e vogël.

Pas deklaratës së Shtëpisë së Bardhë se krimi kishte autorë agresorë nga regjimi komunist i Havanës, pat dalë para medias edhe vetë Kastro. Kishte shprehur keqardhjen, por pati ngulur këmbë se plumbi kishte dalë prej armëve të “kriminelëve kubanë që strehon Amerika”.

Mehmet Shehut Reis Malile i dha edhe një lajm të dytë. Atë mbrëmje kishin pasur mbi dhjetë telefonata përgëzuese nga bashkëkombës që jetonin në SHBA. Shumica patën kërkuar një takim dhe fotografi me të.

“Sa më shpejt do t’i ftoj, u thuaj!”, brofi kryeministri.

Malile e informoi edhe për një thashetheme: thuhej se paradite në një nga sallat e vogla të Pallatit të Qelqtë Tito qe takuar me Ajzenauerin.

Tema e bisedimeve kishte qenë për mosmarrëveshjet kino-sovjetike.

Mehmet Shehu rrudhi vetullat, por papritmas shqiptoi fjalët “Ai bën gjithçka. Është agjent”.

Pastaj, ndërsa pa që Reis Malile qe ende i mëdyshtë për vërtetësinë e lajmit, shtoi: “Sidoqoftë për këtë gjë shokun Enver do ta njoftojmë që sot”.

Tekstin e radiogramit të mbrëmjes Shehu e nxori pas një gjysmë ore. Raportonte një për një të gjitha sa kishte kryer gjatë ditës së 22 shtatorit. Kishte futur edhe atë historinë e takimit mes Titos dhe presidentit amerikan, madje si të kryer.

Në rreshtat e fundit shtonte se pat kuptuar që “kjo mbledhje e OKB-së nuk do të arrinte asgjë konkrete, sepse aty si nga imperializmi ashtu edhe nga revizionizmi vihej thjesht për të kryer luftë cili do ta fitonte më shumë opinionin publik”.

Radiogramin për Hoxhën kryeministri e mbyllte me fjalët “Nga shëndeti jam mirë. Përqafime. Mehmeti”.

Sovjetikët rishikuan vendimin për ndihmë në drithë për Shqipërinë dhe e akorduan një sasi me klering dhe me ar

Në mesditën e 23 shtatorit, e premte, Enver Hoxha i dorëzoi sekretarit të tij tekstin e mesazhit që duhej nisur për në Nju Jork. Vartësi, sapo u rifut në paradhomë, bëri në fund të dy fletëve shënimin “Të niset!”

Qe ora 14.10.

Pasi me motorçiklin e një korrieri të posaçëm zarfi i mbyllur mbërriti në Ministrinë e Jashtme, shifrantët e koduan menjëherë tekstin.

“Shoku Mehmet”, thuhej, “Radiogramet i marrim, vazhdoni të na dërgoni se janë “zbavitëse”.

Më pas: “Me ata që të tregohen të afruar dhe që s’kanë ndryshuar qëndrim ndaj nesh afrohu dhe gjej mënyrat me shpartallue frontin dhe me ju krijue turbullira në kokë, pse ata duhet të kenë lëkundje”.

Në vijim: “Sovjetikët, pas kërkesës sonë që ti e di, rishikuan vendimin për drithë dhe na akorduan një sasi me klering dhe me ar. U thamë që prapë nuk jemi të kënaqur, por do t’i blejmë. Rumunët s’japin gjë fare”.

Paragrafi në parambyllje të radiogramit shënonte: “Këtej çdo gjë është fare mirë. Radioja jonë protestoi te sovjetikët, pse në emisionin e Radio Moskës në gjuhën shqipe as të zë fare në gojë ku je, flet a s’flet. Por këto i jep në emisionet arabisht. U thamë se protestojmë dhe në rast se vazhdon ky qëndrim i poshtër, atëherë nuk do t’i ritransmentojmë më emisionet e Radio Moskës nga Radio Tirana”.

Rreshtat e fundit: “Shira kanë rënë këto ditë. Në familje i ke shumë mirë. Shokët janë mirë, të bëjnë të fala. Përqafime. Shpati”.

Kur radiogrami i kyçur në shifra mbërriti në Misionin shqiptar në Nju Jork qe ora kur Mehmet Shehu sapo do të nisej për në punimet e OKB-së. Ishte dita kur do të fliste Nikita Hrushovi.

E lexoi mesazhin ndërsa ndodhej në sallon. Letrën e futi menjëherë në xhep. I endej nëpër mollëzat, si shenjë e moszotërimit të tyre nga emocioni, një dridhje e lehtë.

Kur mbërritën në sallën e madhe të Asamblesë dhe me kohë qenë ulur në vendin e tyre, kryeministri u kthye nga Reis Malile dhe i tha: “A nuk të duket se këta policët amerikanë po sillen me më shumë kujdes me ne?”

“Po, u përgjigj tjetri, është pasojë e protestave tona”. Mehmet Shehu heshti, pastaj u kthye me fytyrë nga podiumi.

“Është rezultat edhe i seriozitetit të delegacionit tonë, vijoi Malile, nuk u kemi dhënë asnjë shkak”.

Kryeministri sërish nuk reagoi.

Më në fund u lajmërua se do të mbante fjalën e tij Nikita Hrushovi. Ky u çua prej vendit të vet dhe plot gjallëri bëri përpara. Ndërsa po kalonte para delegacionit shqiptar u duk sikur hodhi andej një vështrim me bisht të syrit. Ndërkohë salla vazhdoi gjendjen e saj të zakonshme, mermërimën e vazhdueshme, edhe pse u dëgjuan mbytur disa duartrokitje.

Në vendin e tij Mehmet Shehu dukej sikur e kishte shikimin të mbajtur pezull prej një mendimi të koklavitur, të cilit nuk po i jepte dot qartësinë. Pak sekonda më parë, sapo dëgjoi përmendjen e emrit të Hrushovit, ai e pat kthyer kokën andej nga ku ky pritej të zbriste, ndoshta për t'i dhënë një shenjë të sjellshme se e uronte që fjalimi t'i

dilte mirë, por ku pa që tjetri nuk kishte nevojë për të, e tërhoqi vështrimin atje ku foltorja vazhdonte të ishte bosh. “Shekulli ynë është shekulli i luftës për liri, nisi kryeministri sovjetik, është shekulli kur kombet çlirohen nga robërimi i huaj. Popujt dëshirojnë një jetë të denjë dhe po luftojnë për ta fituar atë...”.

Salla tashmë qe bërë shumë e vëmendshme, edhe pse duke folur Nikita Hrushovi kryente me dorën e djathtë disa gjeste të çuditshme, si të qe në një miting. Kryeministri sovjetik ngrinte lart pëllëmbën dhe shpesh e mblidhte në formën e grushtit.

I vuri shumë theks kolonializmit si sistem shtypës.

Dhjetë minuta më pas, ndërsa hyri në çështjen e çarmatimit, mori në dorë shishen e ujit, e kthehu nga ana e etiketës dhe si t’ia tregonte sallës, ngriti zërin “Borzhomini ynë është shumë i mirë”.

Pastaj mbushi gotën fare pak dhe nisi ta pinte me gllënjka të shkurtra.

Ndërsa bëri gjestin që donte të thoshte se sapo pat cituar një gjë të mrekullueshme, ujin mineral sovjetik, rifilloi të lexonte fjalimin. Arritjet e mëdha shkencore dhe teknike kanë sjellë për njerëzimin shumë të mira, tha, por edhe fatkeqësi. Nënvizoi se të tilla qenë armët e shkatërrimit në masë. Ato aktualisht nuk po përdoren, por kjo mund të ndodhte shumë shpejt. Ja pse, sipas tij, ato duhej të shkatërroheshin që të gjitha.

“Në marrëdhëniet ndërkombëtare sot ka dy vija politike që i kundërvihen njëra-tjetrës”, u ngulit Hrushovi në një temë tjetër. “Ato mund të përplasen”, paralajmëroi.

Pastaj foli për nevojën e paqes, se këtë frymë e dëshirojnë të gjithë popujt, punëtorët dhe fshatarët, intelektualët dhe borgjezia, por i pengojnë një grusht militaristësh dhe monopolistësh. Bashkimi Sovjetik kishte bërë gjithçka për

t'u rreshtuar me forcat dhe tendencat pozitive të botës, vuri në dukje.

Pastaj për paragrafë të tërë duke iu referuar avionit spiun amerikan që në pranverën e shkuar kishte shkelur hapësirën ajrore të Bashkimit Sovjetik dhe të drejtën ndërkombëtare, akuzoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ngulmoi se kjo qe një politikë banditizmi.

Në sallë u dëgjuan disa duartrokitje. Mes këtyre entuziastëve më shumë i kishte përplasur duart Fidel Kastro.

Nikita Hrushovi, edhe pse tashmë e kishte kapërcyer me kohë gjysmën e orës, iu kthye sërish leximit të tufës së letrave. Nisi të sulmonte politikën amerikane të bazave ushtarake. Të shpërndara në të gjithë globin ato kërcënonin qëndrueshmërinë e shumë vendeve të tjera. Pesë minuta më pas me ton zëri të ngritur mbrojti revolucionin kuban. Më vonë nisi të shprehte zemërimin që Republika Popullore e Kinës ende nuk po pranohej të qe anëtare e Kombeve të Bashkuara. Për këtë bëri fajtorë qeverinë e SHBA-ve, e cila mbështeste Tajvanin, shtetin paralel dhe kukull të tyre.

Në vazhdim Hrushovi iu rikthye temës së çarmatimit të përgjithshëm, por këtë herë më me nge, duke qëndruar në hollësira. Sërish për mosrealizimin e tij akuzoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

“Nuk zbuloj ndonjë sekret kur them se nuk kemi asnjë simpati për kapitalizmin, tha një çast, por ne nuk dëshirojmë që sistemin tonë tua imponojmë me forcë popujve. Por edhe të tjerë shtete, të cilët ndjekin një politikë të kundërt dhe kanë një sistem shoqëror ndryshe nga yni, duhet të heqin dorë prej përpjekjeve të pafrytshme për të imponuar vullnetin e tyre. Politika e bashkekzistencës paqësore kupton një dëshirë e gatishmëri për t'i zgjidhur të gjitha problemet ndërkombëtare pa iu

drejtuar forcës, por vetëm nëpërmjet bisedimeve dhe kompromiseve të arsyeshme”.

Nikita Hrushovi pa nga salla, vuri buzën në gaz dhe kapi shishen me ujin sovjetik Borzhom. Ngadalë hodhi një sasi të vogël në gotë, e ngriti lart si të qe riti i një dollie dhe hodhi në fyt disa gllënjka.

Pas pak sekondash rifilloi të fliste. Mbi mërmërimën e njëtrajtshme të sallës së madhe të Asamblesë tashmë zëri i tij, disi i lodhur, dukej sikur vinte prej një këndi tjetër të saj. Po hynte në pjesën mbyllëse të fjalimit, në spektaklin e finales. Ishte përfolur se do të shpallte kërkesa të forta.

“Tani ne jemi ngulmësisht të bindur se ka ardhur momenti të marrim masa për të krijuar kushte që të përmirësohet funksionimi si i Kombeve të Bashkuara në tërësinë e vet ashtu edhe vetë drejtimi ekzekutiv i organizatës”.

Salla e kishte tulatur mërmërimën.

“E përsëris, çështja ka të bëjë me Sekretarin e Përgjithshëm dhe stafin e tij. Duhet të kemi parasysh veçanërisht nevojën për disa ndryshime dhe përmirësime, për të ardhmen e shpejtë..”

Ajri mbi sallën e Asamblesë dukej sikur nuk lëvizte më.

“Ngulim këmbë se do të qe e arsyeshme për organin ekzekutiv të OKB-së që të mos ketë një subjekt të vetëm si Sekretari i Përgjithshëm, por tre persona të pajisur prej Kombeve të Bashkuara me besimin më të madh. Zgjedhja e tyre të bëhet në bazë të shteteve që përbëjnë sot tre blloqet më kryesore, ai ushtarak i fuqive perëndimore, i shteteve socialiste dhe i vendeve neutrale”.

Salla zhurmoi, por Nikita Hrushovi e shtyu më tej fjalën e tij. Tha se selia e OKB duhej të ikte sa më parë nga Nju Jorku.

Zhurma tani qe kundërshtim i hapur.

Moskokëçarës Hrushovi zbriti nga podiumi. Ndihej triumfues.

Fjalimi i tij tridhjetë e gjashtë faqesh pat zgjatur afërsisht dy orë e gjysmë, kurse ai i presidentit Ajzenauer kishte nisur e qe mbyllur brenda vetëm dyzetë e një minutave.

Ndërsa zbriti në sallë u drejtua për në vendin e tij. Edhe këtë herë nuk i hodhi sytë nga rreshti ku ndodheshin Mehmet Shehu dhe shqiptarët.

Kur seancës i erdhi fundi dhe dolën në sallon shumica e pjesëmarrësve u duk që nuk kishte fort dëshirë të ikte pa shkëmbyer në këmbë ndonjë opinion. Ndërsa Shehu qëndroi mënjanë, duke biseduar me Behar Shtyllën, Reis Malile pas dhjetë minutash kontakte me disa kolegë erdhi dhe solli lajmin më të fundit. Vendet neutrale dëshironin të kishin në udhëheqje të bllokut të tyre jo Titon dhe Jugosllavinë, siç përflitej se qe projekti amerikan, por Indinë dhe Xhavaxharlal Nehrunë, siç duhej të ishte qëndrimi sovjetik.

Mehmet Shehu u bë shend e verë.

Kur seanca i reshti punimet dhe dolën në holl Reis Malilen e thirri mënjanë njëri prej trumbës lëvizëse të gazetarëve. Pasi biseduan fare pak ai u kthye tek kryeministri dhe i tha se revista “United States News and World Report” i kërkonte një intervistë. Pastaj i shpjegoi se ajo nuk qe dashakeqe ndaj vendeve komuniste dhe se po ashtu lexohej në rrethet politike dhe diplomatike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Mehmet Shehu nuk dha përgjigje, por vështrimin e mbajti të ngulmët.

-“Dakord”, - tha pastaj, - “Gazetarin e pres të dielën. Orën caktoje ti me të”.

Ndërsa dolën për të hipur në makinat e tyre shumë afër u kaloi vrulltazi Nikita Hrushovi me të vetët. Sërish ai nuk ia hodhi sytë Mehmet Shehut. Ndërsa hyri në makinë kryeministri sovjetik i tha trupprojës të mos e mbyllte derën. Dukej që priste të tjerë.

U pa tek nxitonin drejt limuzinës së tij Dezhi, Podgorni dhe Morozovi. Me siguri do të hanin darkë së bashku. Mirëpo ndërkohë që këta tre mbërritën Hrushovi gjithsesi nuk u qetësua. Doli hovshëm nga makina dhe thirri me zë të lartë emrin e Gomulkës. Ky qe ende tepër larg, mes turmës së madhe të njerëzve dhe në fillim nuk e dëgjoji. E ndjeu që e thirrën vetëm kur kryeministri sovjetik ia behu një të thirrurë të dytë, pothuaj piskamë.

Përreth disa prej kolegëve të delegacioneve të tjera qeshën. Ndërkohë Mehmet Shehu bëri një lëvizje të shpejtë të trupit dhe ia kthehu shpinën të gjithë kësaj skene.

Truproja përgjegjëse e grupit amerikan të shoqëruesve, ndërsa kryeministri shqiptar kishte hyrë në makinën e tij, i tha Reis Maliles se atë mbrëmje mund të shëtisnin në Manhatan.

Kur mbërritën në selinë e Misionit kryeministri u mbyll pak kohë në apartamentin e tij, dëgjoji emisionin radiofonik të Tiranës dhe pas një gjysmë ore doli me në dorë tekstin e një radiogrami. I raportonte Enver Hoxhës se në punimet e Asamblesë perëndimorët nuk bënë asnjë lëshim prej qëndrimeve të tyre dhe se ndeshja mes të dy palëve vazhdonte të qe luftë për të fituar opinionin publik.

“Unë do flas të hënën, 26 shtator”, shkruante, “Do të mbështes propozimet sovjetike. Nuk gjej asgjë të diskutueshme. Ju e kuptoni sepse kini lexuar fjalimin e Hrushovit”.

Pak më pas rreshtonte fjalët: “Fidel Kastro është ...bërë njeriu i ditës, më simpatiku i të gjithëve. Do organizoj takim me të”.

Ndërsa teksti i Mehmet Shehut po përfundonte kodimin, në zyrën e errët të shifrantit shkoi edhe Reis Malile. Kishte hartuar edhe ai një radiogram për Tiranën. Informonte për debatet e pritshme në OKB dhe se pozitat e amerikanëve mbeteshin të dobësuar.

Sapo shifranti mori në dorë tekstin e këtij radiogrami të dytë i propozoi shefit të vet shkurtimin më të mundshëm. Shifra që kishte pasur gjer atëherë në dispozicion, qe mbaruar. Duhej të priste të tjera nga qendra e vet, Ministria e Brendshme.

Malile bëri një redaktim të shpejtë dhe kur më në fund radiogrami u nis drejt Tiranës, në mbyllje të tij, edhe për të shpjeguar psenë e vetëm atyre pesë radhëve të ngushta, qenë fjalët “Shifra na mbaroi. Telegramë nuk bëjmë dot”.

Ndërsa shkoi në apartamentin e tij dhe hëngri diçka të shpejtë, ndoqi kronikën e lajmeve.

Sekretari amerikan i Shtetit Kristjën Heter (Christian Herter) e kishte përshkruar fjalimin Hrushovit si një shpallje lufte kundër Kombeve të Bashkuara.

Kur edhe Mehmet Shehu pat ngrënë darkën e doli nga restoranti me humor të mirë, tashmë të shoqëruar nga agjentët amerikanë, grupi i vogël shqiptar u nis menjëherë për një shëtitje në Manhatan.

E kishin zgjedhur ndërkohë çfarë do të shihnin: Uollstritin.

Një tortë për Hrushovin, e dyshuar si bombë

24 shtatori, duke qenë e shtunë, ishte bashkë me të dielën ditë pushimi. Nëntëdhjetë e dy delegacione pjesëmarrëse në Sesionin e 15-të mund të shëtisnin lirisht edhe jashtë Nju Jorkut.

Policia vendase i dha leje edhe Hrushovit të shkonte në vilën me kopsht jashtë qytetit. Atje qenë ftuar të drekonin bashkë me kryeministrin sovjetik edhe sekretarët e parë të vendeve të kampit socialist, por duke përjashtuar Mehmet Shehun.

Qe oficeri amerikan që drejtonte grupin shoqëruës, i cili e vuri në dijeni për drekën që kishte shtruar Nikita Hrushovi dhe pjesëmarrësit e saj. Madje i tha se në dëshironte të shkonte edhe ai, nuk do ta pengonin, edhe pse vila e sovjetikëve në Glen Cove gjendej jashtë Manhatanit. Por Mehmet Shehu, pasi e falënderoi, iu përgjigj oficerit se nuk e kishte atë dëshirë.

Në të vërtetë pas shëtitjes së një nate më parë ai tashmë nuk kishte ndërmend tjetër gjë veç gjatë ditës të përgatitej sa më mirë për fjalimin që do të mbante të hënën dhe në mbrëmje t'ia kalonte sa më gëzueshëm me një grup shqiptarësh që do të vinte për vizitë.

Por do të kryente edhe një punë të lënë pezull: bisedën me Reis Malilen për Fan Nolin.

Sapo hëngri mëngjes fillimisht kërkoi gazetën. Kishte dëgjuar në radio rreth një ngjarjeje komike, e cila në fillim qe interpretuar si përpjekje për atentat kundër Nikita Hrushovit.

Kur nisi t'i shfletojë të përditshmet për të ndjekur fillin e saj gjithçka iu bë edhe më qesharake. Një postier pati sjellë në selinë e Misionit Sovjetik, i cili ndodhej në Park Avenue, një pako pa adresë të dërguesit.

Ajo i drejtohej Nikita Hrushovit dhe sipër mbante fjalët "Tortë. Mall i brishtë".

Policia amerikane kishte bllokuar menjëherë të gjithë trafikun prej rrugës 68-të deri tek ajo 72. Pakua u vëzhgua me reze X dhe specialistët e eksplozivëve vunë re se në brendësi kishte disa tela apo fije lidhëse të dyshimta.

E transportuan në një shesh të zbrazët dhe xhenierët e hapën me kujdes. Brenda nuk gjendej bombë, por një tortë molle dhe një gjerdan, në të cilin qenë shkruar Dhjetë Urdhëresat.

Po ashtu edhe emri i personit që ia pati dërguar ëmbëlsirën Hrushovit. Quhej Virginia McCleary. Ishte nga Texas.

Ajo qe e bindur se vetëm me një tortë karakteristike amerikane dhe Dhjetë Urdhëresat e besimit të krishterë mund të ndikonte tek kryeministri sovjetik që ta kuptonte SHBA-në më shumë se prej çdo debati politik.

Një gjysmë orë më pas Mehmet Shehu thirri përkthyesin. Ky iu paraqit menjëherë dhe sapo hyri në dhomë mësoi se në fjalën pesëmbëdhjetë faqëshe që do të mbante më 26 shtator kryeministri kishte bërë disa ndërhyrje të vogla dhe ato tani duheshin përkthyer në rusisht. Duke përfshirë edhe ridaktilografimin e të gjithë tekstit, këtë punë, i mbyllur në Mision, përkthyesi duhej ta bënte brenda ditës. Madje pa rënë ende mbrëmja, në rast se dëshironte të merrte pjesë edhe ai në takimin me bashkëkombësit. "Kështu pra", ngulmoi Shehu, "Do të ritakohemi sonte".

Pastaj vijoi me një urdhër të dytë. I tha se ndërkohë në çdo fjalë të diskutimit duheshin vendosur shenjat ku binte theksi që kur ta lexonte rusisht në sallën e madhe të Asamblesë, të mos bënte gabime në shqiptim.

Ndërkohë Reis Malile kishte nisur për në aeroport një zarf të dyllosur me brenda dy kopje të daktilografuara të dy fjalimeve në shqip që kryeministri do të mbante në debatin e përgjithshëm dhe tjetrin për çështjen e anëtarësimit të Kinës në OKB.

Me postë ajrore që atë ditë zarfi do të mbërrinte në Romë dhe sërish pa rënë në Tiranë ende mbrëmja, me një avion tjetër të linjës do të ndodhej në Ministrinë e Jashtme.

Prej andej një kopje do t'i nisej Komitetit Qendror dhe tjetra duhej të mbahej aty gjer në çastin kur prej Misionit do të vinte porosia për ta botuar. Sipas rregullit kjo do të ndodhte menjëherë pasi kryeministri ta mbante fjalën.

Mot Fishman

Tek akrepat e orës shkonin ngadalë dhe ende nuk kishin kapur dhjetën, ndodhën pothuaj njëherësh dy ngjarje. Në fillim qe postieri. i cili bashkë me paketën e madhe të zarfeve, solli edhe një që binte në sy për shkak të emrit të dërguesit, shkruar i tëri me germa të mëdha të kuqe: Mot Fishman.

Me po atë ngjyrë të përflakur më poshtë shënohej “Sekretar i Përgjithshëm i Veteranëve të Brigadës “Abraham Linkolm”.

Letra qe personalisht për Mehmet Shehun.

Reis Malile me zarfin në dorë u nis menjëherë për në apartamentin e kryeministrit dhe sa u bë gati të trokiste, dera u hap vrullshëm dhe në kornizën e hapësirës së saj u shfaq Shehu. Edhe ai mbante në dorë dy fije letre. Dukej qartë se ishte teksti i një radiogrami.

“I shkëmbejmë?”, bëri shaka.

Kur dalloj mbi zarf emrin e dërguesit, tha tërë ngazëllim “Brigada “Abraham Linkolm” ka luftuar në Spanjë. Përbëhej vetëm nga vullnetarë amerikanë”.

Malile ja zgjati letrën me dorën e djathtë. Mehmet Shehu kreu të njëjtin gjest. Kështu zarfi dhe radiogrami u këmbyen njëherësh, si të qe një ceremoni.

Kryeministri qeshi çpengueshëm. Qeshi edhe Reis Malile.

-“Sot do të gjejmë pak kohë të bisedojmë për Nolin”, - tha.

-“Kur të dëshironi”, - u përgjigj tjetri.

Pastaj u ndanë.

Kur Shehu e hapi zarfin pa se brenda ndodhej një letër përshëndetëse. Mot Fishman i kujtonte kohën kur patën

luftuar për të mundur jo vetëm fashizmin spanjoll, por edhe atë botëror. Në rreshtat e fundit të saj shkruante me germa të theksuara dukshëm: “Në emër të amerikanëve që luftuan së bashku me ju kundër fashizmit në Spanjë në radhët e brigadave ndërkombëtare ju uroj mirëseardhjen në SHBA dhe nëpërmjet jush i dërgojmë popullit shqiptar përshëndetjet tona”.

“Hiqi duart, more vesh apo jo!”

Ndërkohë në dhomën e errët të shifruesit po bëhej gati për t’u kyçur radiogrami i radhës për Tiranën: “Shoku Enver, 1)...Zhivkovi rri shumë i mërzhitur, sikur i ka ngrënë gomari bukën. Nuk buzëqesh jo vetëm me ne, por as me të tjerët. 2) Situata po zhvillohet interesante. Gjë konkrete nuk do realizohet se, siç duket amerikanët janë zëmëruar shumë nga qëndrimi i Hrushovit e gjendja po ashpërsohet, kurse Titoja përfiton, paraqitet i ndërmjetmi, situata e favorizon ta forcojë bllokun e tretë. Bisedimet e tij me Ajzenauerin kanë pasur qëllim thellimin e grindjeve në kampin tonë, grupimin e neutralëve dhe hartimin e planit të bashkëpunimit me perspektivë të gjatë. Kjo thuhet haptas nga shtypi...

3) Me rrugën që po merr gjendja fjalimet tona do jenë demaskuese për imperializmin, të matura në gjuhë por të rrepta e parimore në përmbajtje.

Të hënën flet i pari Novotni, pastaj argjentinasi e një tjetër, pastaj unë, pas meje Fideli, i cili po u jep grusht amerikanëve me çdo gjest të tij.

Demonstratat u rralluan, regjimi policor po zbutet pak, masat e sigurimit janë të plota. Pardje një polic për të më treguar derën e ashensorit më preku pak në krahë se pandehte se s’ia marr vesh gjuhën po të më fliste. Unë i thashë me rreptësinë që e meritonte: “Hiqi duart, more vesh a po jo! Mos më prek më dhe duhet të dish se unë jam i paprekshëm”.

Polici e shefi kërkuan ndjesë, u ra damllaja. Që atëherë e hoqën atë polic, sillen me politesë e korrekt. ...

5)...Në OKB Hrushovi takohet me Titon e bisedon të paktën një herë çdo ditë.

6) Sonte në darkë do vijë një grup shqiptarësh të njohur për takim në Mision. Pastaj do vinë edhe të tjerë. Me shëndet jemi mirë. Mehmeti”.

Kur erdhi koha e drekës dhe pasi hëngrën bashkë që të gjashtë, gjithsecili në tryezën e tij, përkthyesi i tha kryeministrit se e shumta në orën gjashtëmbëdhjetë do t’ia dorëzonte fjalimin me në çdo fjalë shenjat e theksimeve. “Takohemi në shtatëmbëdhjetë”, preu Mehmet Shehu.

Kur u kthye në apartamentin e tij porositi të vinte Reis Malile.

Fan Noli

Në Tiranë mbi gjendjen e kolonisë shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kryeministri kishte kërkuar nga Ministria e Jashtme vetëm një informacion, i cili i erdhi në gusht. E donte të përditësuar, sepse çdo vit merrte raporte mbi situatën e tyre në të gjitha vendet ku diaspora kombëtare qe shpërndarë dhe kështu në shkurt të atij viti një të tillë për SHBA-në e kishte shfletuar.

Porse kur qe fjala për ndonjë person të veçantë, për shembull Arshi Pipën, nga burime të tjera ai dinte jo pak dhe për pasojë nuk shpresonte se informacionet e ardhura nga Misioni i tyre në Nju Jork mund t'i shtonin ndonjë gjë të re.

Nuk e priste këtë edhe për Fan Nolin. Në informacionin e gushtit thuhej se ndaj tij vepronin tre grupe kundërshtarë. Njëri e akuzonte për simpati dhe lidhje me qeverinë e Tiranës. I dyti e bënte përgjegjës për përçarjen në shoqatën Vatra dhe i treti shkonte akoma më tej: e denonconte Nolin si shkaktarin dhe përgjegjës të kryesor të përçarjes së shqiptarëve në Amerikë.

Por Enver Hoxha pati vendosur një përmasë të caktuar sjelljeje me kryeministrin shqiptar të vitit 1924. Miqësia me të duhej ruajtur palëkundshëm. Ndërkohë nuk duhej edhe ta komprometonin me nxitje të ngutura për të mbajtur qëndrime që i dëmtonin raportet e tij me bashkësinë e shqiptarëve si edhe vetë qeverinë amerikane.

Ishte kjo arsye që në të gjithë ditëqëndrimin në Nju Jork Mehmet Shehu nuk kishte as hamendësuar ndonjë bisedë telefonike me Fan Nolin, as kërkuar shkëmbim letrash a

telegamesh, ca më pak ndonjë takim. Po ashtu as që priste prej tij të vepronte ndryshe.

Por pikërisht gjithë kjo mungesë e bënte të dëshiruar të dinte diçka më shumë. Që kur kryeministri e paralajmëroi për bisedën e shoqëruar me kafe Reis Malile e kuptoi çfarë duhej t'i thoshte.

Gjatë gjithë kohës që foli, Mehmet Shehu e dëgjoji me vëmendje të dukshme.

E kishte takuar Fan Nolin në 6 shkurt të atij viti në një hotel të Manhatanit. Që i shoqëruar me disa shqiptarë të tjerë, për të cilët Misioni nuk kishte informata të qarta. Mes tyre mund të kishte ndonjë bashkëpunëtor të Departamentit Amerikan të Shtetit, kështu që në atë takim të dy nuk patën hapur bisedë pune, madje as edhe mbi gjendjen e kolonisë.

Që prej atij çasti nuk qenë takuar më. Noli nuk kishte ardhur në Nju Jork, por as Malile, për shkak të kufizimit të lëvizjeve, nuk mund të shkonte dot tek ai në Boston, në Kishën e Shën Gjergjit, në të cilën shërbente.

–“Në atë takim të vetëm përgjithësisht u tregua mjaft miqësor dhe si me më pak frikë për t’u takuar edhe herë të tjera”, - saktësoi Reis Malile.

“Vetëm tre ditë më pas, vijoi, këtu në kishën shqiptare të Nju Jorkut, për shkak të moshës, dha dorëheqjen prifti i vjetër dhe në vend të tij u caktua një fare i ri. Ky është duke e përfunduar shkollën fetare, madje këtë po e kryen me ndihmën ekonomike të disa shqiptarëve. Mirëpo ky prift i ri di fare pak shqip dhe lutjet më së shumti i bën në anglisht. Ne jemi përpjekur që kisha shqiptare të përdorë gjuhën tonë. Edhe Noli doemos është dakord me këtë gjë, por në caktimin e priftit të ri në Nju Jork nuk pat kundërshtim”.

–“Po gjuhën greke vazhdojnë ta përdorin?” pyeti Mehmet Shehu.

Kishte një si ëndërrim në thellësi të bebëzave dhe Malile nuk arriti dot të kuptojë nëse kryeministri, ndërsa ai po shpjegonte Fan Nolin, e kishte mendjen tërësisht aty apo edhe gjetkë.

Iu përgjigj se herë pas here për rite të veçanta të fesë së krishterë ortodokse përdorime të greqishtes kishte, por shqipja zotëronte kudo. Noli që mjaft luftarak në këtë mision.

-“Një lloj shqetësimi, besoj i panevojshëm, vazhdoi Malile, u shkaktua në mes të muajit maj, kur me rastin e Pashkëve Fan Noli pati përmendur shkurt “gjendjen e mjeruar të kishës në vendet prapa Perdes së Hekurt”. Nga zëvendësministri Budo na erdhi porosia ta hetonim mirë këtë pjesë të fjalimit, por arritëm ta bindim se një frazë e tillë nuk kishte për qëllim ndonjë kritikë për Shqipërinë”. “Shqetësim i arsyeshëm, shpjegoi më pas Malile, na u krijua kur në një seminar të Vatrës me temë Shqipërinë, që u mbajt këtë gusht, krahas kriminelit Arshi Pipa u ftua të fliste edhe Fan Noli. I dërguam një letër që të mund ta shmangte dhe se po të merrte pjesë kjo do ta komprometonte rëndë të ardhmen e tij. Noli menjëherë na u përgjigj po me letër, duke na thënë se lutej që ta kuptonim, se po të shpallej do të goditej si armik, se ka qenë, është dhe do të jetë me ne. Po ashtu kërkoi ndjesë që në seminarin për Shqipërinë do të fliste vetëm për Skënderbeun dhe jo për ndonjë udhëheqës tjetër”.

Mehmet Shehu tundi kokën ngadalë. Ai rrëzëllim i ëndërrit në brendësi të bebëzës ende i gjallonte.

-“Si përfundim?”, pyeti me zë të butë.

-“Mendimi i Misionit është se qëndrimi i Fan Nolit nuk është i qartë”, u përgjigj Reis Malile, “Ai shprehet në mënyrë miqësore në takimet me shokët tanë dhe nga ana tjetër në një darkë të Vatrës ndodhi që u ul në tavolinë me një kriminel”.

Në heshtjen që papritur u krijua e ndërsa në vështrimin e Mehmet Shehut që fikur përfundimisht ai vagëllim mendimi si ëndërr, Malile shqiptoi me ngut fjalët “Përveç më sipër Misioni nuk ka asnjë të dhënë mbi ndonjë qëndrim të hapët armiqësor të Nolit kundër nesh”.

Pas këtij çasti pjesa tjetër e bisedës, ndërsa ende filxhanët me kafe nuk i patën mbaruar, ia kushtuan përkthimeve të Fan Nolit në gjuhën angleze, librit të tij atë vit të botuar në Boston “Pesëdhjetë vjetori i Kishës Ortodokse Shqiptare në Amerikë 1908-1958”, si edhe një telegrami që në fillim të qershorit i pati dërguar Mehmet Shehut presidenti i Vatrës, Kristo Thanasi.

Ky pas tërmetit që në 26 maj kishte rënë në zonën e Korçës, i lutej kryeministrit që të afërmeve të tyre të dëmtuar shqiptarët e Amerikës të mund t’u dërgonin ndonjë pako me ilaçe, veshje dhe ushqime.

Këtu edhe biseda u mbyll. As Shehu dhe as Malile nuk shqiptuan qoftë edhe një fjalë për atë që realisht, pas asaj letre lutëse, kishte ndodhur: ardhja e pakove nuk qe lejuar. “Shteti ynë është në gjendje ta përballojë të gjithë ndihmën e nevojshme”, kishte qenë përgjigja.

“Shoku Enver, vajtëm një orë e gjysmë nga Uollstriti”

Në mbrëmje, para se Mehmet Shehu të takohej me bashkëkombësit, Malile e informoi se në drekën e Hrushovit kishin qenë vetëm Dezhi, Novotni dhe Zhivkovi, kurse Gomulka nuk dihej përse pat munguar.

Mosprania e Kadarit mund të shpjegohej me kufizimin e madh të lëvizjeve të tij nga policia lokale. Ndërkohë kryeministri e porositi të hynte në kontakt me Mot Fishman dhe ta ftonin atë në një darkë të veçantë.

Ende nuk kishin mbërritur vizitorët shqiptarë kur drejt Enver Hoxhës u nis edhe vetërrëfimi i Shehut mbi shëtitjen e një nate më parë: “Vajtëm një orë e gjysmë nga Uollstriti ku shëtitëm edhe në këmbë, pa alarme sirenash.

Kur u kthyem na u lutën t’i lejonim të përdornin sirenat se do të shkonim nga një rrugë tjetër, ku s’qenë marrë masat. Nga do që ishim, kishte me qindra policë e detektivë me makina me radio dhe na ruanin në çdo hap se mos ndodhte gjë. Me ne shëtisin në këmbë vazhdimisht gjashtë detektivë kalorës me nga dy kobure e bomba e shihnin me dyshim çdo kalimtar. Një djalë i ri thirri “Hajl Hitler” e ngriti dorën. Shoqëruesit amerikanë na thanë “Po të kini armë i mbani, por fshehtas”.

U thamë nuk kemi dhe ata qeshën”.

Bisedë me gazetarin e revistës “United States News and World Report”

E diela kaloi me më shumë punë nga sa do të qe një ditë e zakonshme pjesëmarrjeje në Asamble. Në mëngjes Mehmet Shehu priti gazetarin e revistës “United States News and World Report”.

Ai dukej njeri i sjellshëm dhe për të mos i marrë kohë kaloi menjëherë në pyetje: “Cilat janë arsyet që ju dhe udhëheqës të tjerë të vendeve socialiste vendosët të vini personalisht në SHBA?”

Kryeministri iu përgjigj: “Republika Popullore e Shqipërisë ashtu si edhe vendet e tjera të sistemit botëror socialist ndjek me vendosmëri politikën e paqes e të miqësisë midis popujve...”

Tjetri nuk hezitoi: “Cilat janë sot kërcënimet kryesore ndaj paqes botërore...”

Shehu i tha menjëherë: “Kërcënimi kryesor i paqes botërore në kohën e sotme vjen nga politika agresive e qarqeve reaksionare imperialiste në përgjithësi dhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës veçanërisht...”

Gazetari bëri një pauzë të shkurtër, aq sa mori frymë: “Sipas jush si paraqitet gjendja sot lidhur me marrëdhëniet mes vendit tuaj dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe çfarë ndryshimi do të dëshironit të shikonit në këto marrëdhënie?”

Mehmet Shehu e shkëndijoi vështrimin: “Për fajin e qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës midis dy vendeve tona nuk ekzistojnë marrëdhënie diplomatike. Ne dëshirojmë që midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe

Shteteve të Bashkuara të Amerikës të vendosen marrëdhënie të rregullta diplomatike në bazë të parimeve të barazisë, respektit reciprok dhe të mos ndërhyrjes në punët e brendshme të njeri tjetrit”.

Pauza e dytë e gazetarit që më e gjatë se e para, por gjithsesi e shpejtë: “Ka pasur të dhëna mbi mosmarrëveshje serioze për çështje ideologjike midis Bashkimit Sovjetik dhe Kinës Komuniste. Çfarë qëndrimi mbani ju lidhur me këto mosmarrëveshje?”

“Ne nuk dimë që të ekzistojnë mosmarrëveshje të tilla”, i erdhi përgjigja.

Fytyra e të dërguarit të revistës “United States News and World Report” u duk sikur u tendos.

-“Si janë marrëdhëniet e vendit tuaj me Jugosllavinë?”

-“Marrëdhëniet tona me Jugosllavinë, shqiptoi thekshëm Mehmet Shehu, janë në gjendje të nderë jo për fajin e Republikës Popullore të Shqipërisë...”.

Gazetari vuri buzën në gaz e la të kuptojë se tashmë do t’i paraqiste kërshërinë e tij të fundit: “A ka gjë tjetër që do të dëshironit t’u thoshit ju lexuesve tanë?”

-“Unë uroj që lexuesit e revistës suaj si edhe mbarë populli amerikan të kuptojnë karakterin e rrezikshëm agresiv të politikës së qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të mobilizohen për ta mbrojtur paqen së bashku me popuj të tjerë”.

Gazetari dy minuta më pas nuk ndodhej më aty dhe Shehu kërkoi t’i sillnin përkthyesin. Do të që e frytshme që, në prani të tij, nga diskutimi që do të mbante ai vetë ta lexonte dhe shqiptonte çdo fjalë aq herë sa ta mësonte të mos gabonte të nesërmen.

Ndërkaq Reis Malile u mbyll në zyrën e tij dhe u mundua të mos dukej pranë apartamentit të kryeministrit. Kjo jo thjesht sepse duhej t’i linte të qetë, por sepse atë ditë pat dalë revista javore “Life”.

Ajo kishte një shkrim të gjatë për demonstratën e vorioepirotëve dhe sidomos përleshjen e tyre me shqiptarët antikomunistë. Njëra nga fotografitë shoqëruese paraqiste një shqiptar të përgjakur, diku tjetër dukej një skuadron i madh policësh, hipur të gjithë mbi kuaj të lartë.

Disa demonstrues i kishin veshjet të grisura dhe mbanin shenja dhune në fytyrë.

Duke qenë se në shkrim paraqiteshin edhe opinione jo dashamirëse për kryeministrin ai vendosi ta vinte në dijeni vetëm kur të mbaronte punën me përkthyesin. Ky çast mundësisht të qe para se të binte mbrëmja. Nuk duhej, që duke lexuar çfarë amerikanët kishin shkruar, Mehmet Shehut sadopak t'i prishej humori. Për ta mbajtur me sukses fjalimin të nesërmen duhej të ndihej sa më i qetë.

Ballistët: “Nashti jemi me Tiranën e do themi rroftë Mehmet Shehu”

Kur Reis Malile më në fund hyri në dhomën e kryeministrit dhe ja zgjati revistën e ilustruar, ky e la atë mbi syprinën e tavolinës së punës. Pastaj i tha me entuziazëm se gjithçka me përkthyesin pat shkuar fare bukur. Në leximin e fundit ai nuk i kishte gjetur asnjë shqiptim të pasaktë.

Një minutë më pas i zgjati tekstin e një radiogrami për Enver Hoxhën. “Kur ta lexojë do të gëzohet”, i tha.

Reis Malile e mori dhe doli në korridor. Teksti nuk qe shumë i gjatë. Në rreshtat e fundit Mehmet Shehu shkruante “Mbrëmë qenë disa shqiptarë në Mision e ndenjën një orë. Të mallosur, por të frikësuar. Thanë se për rrahjen greko-shqiptare para OKB-së ballistët u akuzuan nga grekët si komunistë dhe këta u rrahën jo vetëm nga grekët por edhe nga policia. Njërit nga krahina e Salarisë i çanë kokën me shkop dhe u plagosën shumë.

Disa ballistë kishin thënë në kafene se “Nashti jemi me Tiranën e do themi rroftë Mehmet Shehu”.

Revista “Time” shkruan...

E hëna, 26 shtatori, ndërsa pritej që për delegacionin shqiptar të ishte ditë mediatike e qetë, pra thjesht e mbushur me fjalënaja për Fidel Kastron, diskutimi i të cilit atë ditë në OKB pritej me kuriozitet mjaft të madh, mbarti me vete një të papritur.

Qe botuar një shkrim tjetër, shumë i hidhur.

Kësaj radhe ishte e përjavshmja “Time”.

Titulli thërrmonte fjalët “Khrushcevi’s rogues’ gallery”, çka në shqip do të thoshte “Fotoalbumi i horrave të Hrushovit”. Në të shkruhej për të gjashtë shefat e shteteve komuniste. Niste me Shqipërinë, pikërisht sepse sipas rendit alfabetik germa fillestare që “A”.

Pas nëntitullit “Albania” teksti vijonte menjëherë me përshkrimin e figurës së Mehmet Shehut.

“...është një ushtarak 47-vjeçar”, thoshte kapitulli për të. Pastaj shkonte më tej: “I biri i një mullai, Shehu është i vetmi nga udhëheqësit komunistë të vendeve satelite të Moskës që flet anglisht, gjuhë të cilën e mësoi gjatë studimeve të fëmijërisë në shkollën amerikane të Tiranës. Përtej fjalimeve të tij të buta dhe kujdesit që shfaq në dukje, Shehu njihet përndryshe si “kasapi i Shqipërisë” për shtypjen gjakatare që, si shef i policisë sekrete, u ka bërë antikomunistëve... Karriera e tij politike kryesisht u ndikua nga papajtueshmëria e ashpër ndaj Jugosllavisë. Qëkurse Moska u prish me Titon, kjo me shumë gjasa e çoi Hrushovin në favorizimin e Shehut përkundrejt Sekretarit të Parë të Partisë Komuniste në vend, Enver Hoxhës”.

Reis Maliles, ndërsa me “Time” në dorë po bëhej gati të nisej drejt apartamentit të kryeministrit, i hyri në zyrë shifranti.

Sapo kishte mbërritur nga Tirana një mesazh i Enver Hoxhës.

Do ta zbardhte sa më shpejt, sepse kishte të ngjarë të lidhej me ndonjë porosi urgjente para se Mehmet Shehu të mbante fjalimin. Kjo kuptohej lehtë nga që ora e nisjes nga Tirana qe afër trembëdhjetës. Pra ishte mesazh i llogaritur që në Nju Jork të mbërrinte në shtatë të mëngjesit.

Shifranti iku pa u ndjerë dhe u rikthye pas një gjysmë ore. Tekstin e çkyçur e kishte futur në një zarf të mbyllur dhe la të kuptojë se do t’ia dorëzonte vetë kryeministrit.

Malile i bëri shenjë të vepronte siç e kishte në kokë.

Kur më në fund Mehmet Shehu grisi buzët e sipërme të zarfit fija e bardhë e letrës, e mbushur me shkrimin e dorës së shifrantit, i kërciti nëpër duar. E mbajti me të butë, me mollëzat e gishtave.

Enver Hoxha ja kishte çuar posaçërisht para mbajtjes së fjalimit, me siguri për ta inkurajuar.

Nisi ta lexonte me kujdes, duke përthithur kuptimin e çdo fjale. Në fillim e vinte në dijeni se të nesërmen, e martë, do të nisej për në Moskë një delegacion i partisë. Në krye do të qenë Hysni Kapo dhe Ramiz Alia. Bashkëpunëtorë do të kishin disa specialistë nga sektori i agjitacion-propagandës. Mehmet Shehu ndali leximin një çast dhe vetëm pastaj e kapërceu vështrimin një paragraf më poshtë: “Delegacionin kinez thonë se do ta kryesojë Ten Hsiao Pini. Si do të zhvillohen situatat do të të mbaj në korrent”.

Mehmet Shehu e kërceu vështrimin në rreshtat më pas: “Sovjetikët vazhdojnë të bëjnë provokacione; na bënë edhe në personelin e marinës. Tanët ua dhanë përgjigjen e merituar. Mos u bëj merak, poshtësirat u bien në fytyrat e tyre. Ata tërhiqen me bisht në shalë”.

Kryeministri e frenoi leximin e mëtejshëm. Një si shkarkim elektrik i përshkroi tej për tej të dy tëmthat.

Çfarë kishte ngjarë në Flotiljen Luftarake? Mos sovjetikët kishin ndërmend ta hiqnin bazën detare të Vlorës apo punët patën shkuar më keq se kaq dhe u kishin bërë thirrje marinarëve të ngriheshin në kryengritje?

Ato ditë nga biseda me njerëz të Gomulkës i pati mbërritur deri në vesh përfolja se në propozimet e Nikita Hrushovit për një çarmatim të përgjithshëm global, në rastin kur kjo nuk mund të realizohej, për Uashingtonin që bërë gati edhe një ofertë tjetër: ajo e një Ballkani të lirë nga armët bërthamore dhe raketat.

Sipas kësaj projekt marrëveshjeje, në këmbim e njëjta gjë duhej të ndodhte në Turqi.

Prej këtij, ku bazat raketore amerikane qenë të shumta, Bashkimi Sovjetik kërcënohej rëndë. Po të realizohej pakti i Ballkanit, Hrushovi, duke larguar bazën ushtarake të Vlorës do të fitonte heqjen e tyre të ndërsjellët nga rajonet veriore të Turqisë dhe në pamundësi të saj të paktën nga Greqia.

Mehmet Shehu e shtyu vështrimin më poshtë radiogramit. Enver Hoxha e porosiste: “Me gjakftohtësi, por qëndroju top të gjithë atyre që do të lehin ose do të provokojnë. Qëndro i patundur në ato që kemi vendosur”.

Mbajti frymën. U ndjei lumtur. Në shumë qëndrime ata të dy qenë shumë të ngjashëm.

“Fjalimet i kënduam. Shumë mirë ua ke bërë për “krajlin” e Beogradit. Ai e tregoi edhe njëherë se s’është veç agent i imperializmit, për të cilin, në të gjithë fjalimin e tij, nuk foli as edhe njëherë. Demaskoje pa mëshirë, jo vetëm te duaxhinjtë e tij të kampit tonë, por demaskoje edhe te të tjerët”.

Ah, thirri brenda vetes Mehmet Shehu, Titos ashtu kam për t’ia punuar.

“Ne kemi avantazhin këtej të vemi edhe për gjah. Vajta të shtunën, vrava 18 rosa. Po të kisha qëlluar më mirë mund të kisha vrarë edhe më shumë. Asnjë rosë nuk vrava në ujë, por të tëra në flur. Kishte rosa shumë dhe të majme. Kadriu qëndroi në kënetën e kashtës dhe vrau edhe ai mjaft. Mos u mërzit se kemi lënë edhe për ty kur të vish. Lajmet që na japin tregojnë se në Sukth fazanët janë shtuar aq shumë sa ta marrin kapelen nga koka. Por atje s’do të vëmë dorë, do të të presim edhe ty. Beharit të fala. Presim sonte të dëgjojmë fjalimin tënd. Përçafime. Shpati”. Shehu ndjeu një marramendje, por ajo çuditërisht qe e ëmbël, pothuaj si një mjegull që po binte mbi të fare butësisht. Në vend që t’ia shtonte ajo ia çliroi tensionin e krijuar mes dy tëmthave.. E kishte marrë malli për vendin e vet.

“Kaq shpejt!”, rënkoi me vete.

Rinisi ta lexojë edhe njëherë radiogramin.

Kur Reis Malile trokiti në derë ai ishte gati për t’u nisur drejt Pallatit të Qelqtë.

Në sallën e Asamblesë shumica e delegacioneve qenë nëpër vendet e tyre. Nuk mungonte as Nikita Hrushovi.

Paradite do të fliste presidenti çekoslovak Antonin Novotni. Kryeministri sovjetik do të ishte patjetër edhe pasdite, sepse përveç Mehmet Shehut fjalën do ta merrte edhe Fidel Kastro.

Kur në sesion i erdhi radha Novotnit ky mbajti qëndrim të ashpër ndaj qeverisë amerikane. Ishte një përmasë e akuzës shumë herë më agresive nga sa ishte bërë zakon ta përdornin ato kohë vendet e kampit socialist.

Menjëherë pasi presidenti çekoslovak u ul, u pa të ngrihej Zhivkovi dhe të dilte me ngut jashtë sallës. Një çast më pas u çua edhe Novotni, duke dalë po ashtu edhe ai.

Të dy u rikthyen në vendet e tyre pas dhjetë minutash. Përse kishte ndodhur kjo u sqarua shumë shpejt. Ata qenë

takuar në holl. Një këshilltar i delegacionit bullgar që iu afrua Reis Maliles, shpjegoi se kishin marrë një kopje të fjalës së presidentit çekoslovak dhe se kërkonin të njëjtën gjë edhe prej delegacionit shqiptar.

Mehmet Shehu ra dakord menjëherë dhe tjetri u largua me njëmijë falënderime.

“Me siguri Zhivkovi ka shkruar një fjalim të butë ndaj imperializmit amerikan, tha kryeministri, dhe tani, kur pa edhe qëndrimin e Novotnit, duan ta forcojnë ca”.

26 shtator, kryeministri shqiptar zbraz 15 faqe fjalim në OKB

Kur kaloi mesdita kryeministri qëndroi në pritje të përmendjes së emrit të tij për të dalë para Asamblesë. Tashmë emocioni e kishte përfshirë të gjithë delegacionin shqiptar.

Çasti për t'u ngritur e ngjitur në tribunë Mehmet Shehut i erdhi sapo akrepat kapërcyen orën katërbëdhjetë.

U nis drejt foltores me një zbehtësi të lehtë në fytyrë. Sapo hapi fletët nuk bëri më pas asnjë sekondë pauzë. Shqiptoi me zë të tingëllueshëm “Zoti kryetar, Zotërinj!”

Të pesëmbëdhjetë faqet i zbrazti në rusisht njëra pas tjetrës. Duke filluar nga titulli “Respektimi i parimit të sovranitetit, një nga detyrat themelore në marrëdhëniet ndërkombëtare midis shteteve” gjithçka më pas qe një ortek që sa më shumë vraponte aq më tepër grumbullonte rreth vetes tonalitet të fortë.

Kur vështrimi i hyri në faqen e katërt të fjalimit filloi të kritikonte përse nuk gjente mirëkuptim kërkesa e Kinës për t'u futur në Organizatën e Kombeve të Bashkuara si edhe e drejta e saj e ligjshme për të qenë në të gjitha organizatat e tjera ndërkombëtare.

Akuzoi për këtë ndërhyrjen arbitrare të qeverisë amerikane. Më pas u shpreh ashpër për praninë e bazave ushtarake amerikane në botë, e citoi si agresion të rëndë përdorimin e avionit spiun U-2. “Në të katër anët e botës masat e gjëra mallkojnë planet agresive të Pentagonit”, shqiptoi fort, “dënojnë qeverinë e Ajzenauerit”.

Formuloi njëra pas tjetrës shprehjet “qarqet drejtuese të SHBA në mënyrë banditeske”, “praktikat e banditizmit ndërkombëtar” dhe sërish pat rikthim tek U-2.

Gjer në mbyllje të fjalimit nuk rreshti toni i tij i ashpër kundër imperializmit amerikan. “Politika armiqësore, provokimet e komplotet e panumërta të imperializmit amerikan dhe miqve të tij për të përmbysur pushtetin popullor, për t’i rrëmbyer popullit shqiptar fitoret e tij historike kanë pësuar e do të pësojnë kurdoherë disfatë”, thirri me zë të fortë.

Dy paragrafë më poshtë, pa e zbutur fare tonin, deklaroi “Ne ripohojmë gatishmërinë tonë për të vendosur marrëdhënie normale me të gjitha ato shtete që dëshirojnë të kenë marrëdhënie të tilla me ne, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglinë”.

Një minutë më pas, ndërsa i kishte mbledhur letrat e fjalimit, pa qenë i gatshëm të priste ndonjë reagim të sallës, përsëndeti me një ulje të lehtë të kokës tre drejtuesit e sesionit dhe eci me hap të prerë drejt vendit të tij.

Ndihej i qetë, madje krejtësisht i çlodhur. Nuk kishte bërë asnjë gabim në theksat e fjalëve.

Mehmet Shehu nuk ishte ulur ende kur u thirr të dilte në foltore Fidel Kastro. Ora qe 14.57.

Shefi i delegacionit kuban kishte ardhur në Pallatin e Qelqtë dhe hyrë në sallë saktësisht në 14.40. Kështu pati ndjekur pjesën e mbetur nga fjalimi i kryeministrit shqiptar dhe kishte shprehur entuziazëm.

Delegacioni i tyre ndodhej në anën tjetër të sallës, në një nga radhët e mesit, rreshti i tretë. Vetë Kastro qëndronte ulur në anë, buzë rrugëkalimit. Qe vetëm me këmishën ushtarake. Xhaketën e kishte hedhur në shpinë të poltronit.

Kur u ngrit me dorën e majtë përfshiu nga syprina e tryezës një dosje të madhe ngjyrë errët, ja hodhi dorës së

djathtë, dhe me hapin e gjatë u nis drejt podiumit. Katër sheshet e shkallës që të ngjitnin për në tribunë, i bëri si të ngjitej drejt mureve të një kështjelle armike.

Kur mbërriti në foltore prej andej u largua menjëherë një nga punonjësit e shërbimit të OKB-së, i cili sapo i mbushi një gotë me ujë dhe i la pranë edhe një shishe.

Fidel Kastro la dosjen e madhe mbi foltore, e hapi, piu një gllënjë ujë, vuri duart prapa dhe tha se i kishte dalë nami që fliste gjatë, por në të vërtetë në atë debat të Kombeve të Bashkuara do të qe fjalëpakë.

Pastaj, pa ja hedhur sytë letrave, lëshoi mbi sallë frazë pas fraze.

Kur më në fund reshti u bë edhe kampioni i kohëzgjatjes së një diskutimi në OKB.

Ndërsa në mbrëmje u kthyen në Misionin e tyre pjesëtarët e delegacionit shqiptar vunë re se agjentët dhe detektivët amerikanë qenë shtuar, bërë të ashpër dhe patën zgjatur klithmat e sirenave të makinave dhe motoçikletave. Me siguri ishin zëmëruar për fjalimin e Mehmet Shehut kundër qeverisë së tyre.

Rreth orës njëzet teksti i raportimit të kryeministrit u shifrua dhe u nis drejt Pragës: “Shokut Enver. Unë fola mbas dreke i pari. Fjalimi u prit mirë, sidomos nga tanët dhe Kastro. Kur kthehesha nga tribuna hodha sytë nga Hrushovi. Ai kish kohë që më shikonte. Buzëqeshi dhe salutoi me kokë në shenjë aprovimi të fjalimit.

Tito e Popoviçi munguan kur fola unë.

“Pravda” na kërkoi kopjen e fjalimit e ia dhamë, nuk dimë ç’do botojnë. Fjalimi ynë u transmetua i gjithë në televizion. Kur fola unë asistuan edhe disa shqiptarë të ftuar nga ne. Pati mjaft duartrokitje dhe pjesëmarrje.

Pas meje foli Fidel Kastro katër orë e gjysmë pa letër. Fjalimi i Kastros qe aktakuza më e rëndë që mund t’i jetë bërë ndonjëherë imperializmit amerikan, shembull i lartë

leninist se si duhet demaskuar imperializmi dhe grusht i rëndë jo vetëm kundër tij por edhe kundër gjithë atyre që e lypin paqen nga imperializmi dhe shpresojnë marrëveshje me të.

Mendoj se ia vlejti barra qiranë që u mblodhëm, të paktën për faktin e fjalimit të Kastros. Çdo ditë që shkon më shumë vërtetohet drejtësia e vijës së Partisë sonë. Fjalimi i Kastros është një argument i madh në favorin tonë. Po ju dërgojmë tekstin e plotë. E përgëzova nxehtësisht për fjalimin. Për ne më shumë duartrokiste ai.

Zhivkovi sot më tha se duhet demaskuar imperializmi, të fitojmë masat e të forcojmë mbrojtjen etj. I thashë se kjo është e vetmja rrugë e qesha duke i dhënë të kuptojë se ku ka qenë gjer tani...”

Kur ky radiogram prej Pragës transmetohej për në Tiranë, nga Nju Jorku u nis edhe një mesazh tjetër.

Qe hartuar prej Reis Maliles dhe përmbante gjithsej 169 fjalë.

Vinte në dijeni Ministrinë e Jashtme se fjalimi i kryeministrit shqiptar ishte mbajtur dhe pritur me duartrokitje të mëdha. Po ashtu teksti i tij i ishte nisur Agjencisë Telegrafike Sovjetike TASS.

“Shoku Enver, armiqtë na duken si krimba të shushatur”

27 shtatori, ditë shumë intensive për Mehmet Shehun dhe bashkëpunëtorët e tij, që një breshëri radiogramesh drejt Tiranës.

I pari në pushimin e shkurtër të drekës:

“Shokut Enver,

1) Tito vazhdon aktivitet të madh për forcimin e bllokut. Duket se Nehru nuk është dakord. Por edhe në qoftë se blloku i tretë nuk merr formë organizative, praktikisht ai vepron. Kjo situatë punon për Titon.

2) Dje Hrushovi demonstrativisht përshëndeti Titon, duke i rënë shpatullave, me shakara, iu lut të dilnin në fotografi, etj. Gazetat botojnë fotografitë e tyre. Hrushovi duke buzëqeshur me dashamirësi e duke iu përkulur Titos, kurse Tito me fytyrë të vërejtur prej mbreti, pa e shikuar fare në sy e duke i dhënë dorën ftohtë.

Këto janë skena tragjiko-komike e sensansionale që shtypi nuk mungon t'i kapë. Shtypi flet haptas për rolin e ndërmjetëm të Titos, i jep publicitet gati po aq sa Hrushovit, shpreh besimin tek Tito e tjera.

3) Sa e drejtë është vija jonë! Sa e poshtër është kjo situatë! Të ishin shefat e partive si Fidel Kastro, revolucioni botëror do që bërë me kohë. Do bëj çmos të vizitoj Kastron e t'i flas se cili është Tito.

4) Qysh dje i kanë forcuar masat e sigurimit rreth nesh dhe më tepër. Sidomos kur lëvizim nëpër qytet na shoqërojnë gjer 8 makina me detektivë e 10 motoçikleta, veç policisë e kavalerisë që bllokun rrugët.

Merak mos kini, armiqtë na duken si krimba të shushatur.
5) Ju lutem qetësojeni Fiqiretin se në një telegram që më bënte tregohej shumë e shqetësuar. Unë i kam bërë telegrame tre-katër herë, por nuk mund të shkruaj telegrame çdo ditë për të. Mehmeti”.

Tek dreka e mërzitshme e Hrushovit hahet edhe pjepër

Kur hynë në Pallatin e Qelqtë dhe ende ndodheshin në holl morën vesh se Josip Broz Tito ishte takuar me kryeministrin britanik Makmilan dhe pastaj kishte dalë para medias.

Nga gazetarët i qenë bërë vetëm dy pyetje.

Në përgjigje të tyre presidenti jugosllav pat deklaruar se biseda kishte qenë mjaft e dobishme dhe se të dy patën shkëmbyer mendime për çarmatimin dhe disa çështje të tjera.

Akoma pa hyrë në sallë u erdhi edhe lajmi tjetër. Tito që takuar edhe me Nikita Hrushovin dhe, ndërsa prej këtij të fundit akoma media nuk kishte ndonjë deklaratë, atë e kishte shpallur presidenti jugosllav. Sipas tij, ajo bisedë pat zgjatur një orë e tre çerekë dhe vetë Josip Broz kishte dalë optimist se mbledhja e Kombeve të Bashkuara po shkonte drejt përmirësimit.

“Jam shumë i kënaqur nga kontaktet që kam deri tani në Nju Jork me kryetarët e shteteve, burrat e shtetit dhe liderët politikë të vendeve të ndryshme”, që shprehur presidenti jugosllav.

Pa shkuar ora tetë e mbrëmjes Mehmet Shehu doli në holl për një takim të shkurtër me kryeministrin e Libanit. Ky u tregua shumë i dëshiruar dhe gjatë bisedës edhe mjaft i ngrohtë. Tha se të shoqen e kishte me origjinë shqiptare. Shehu u entuziazhua.

Një çast më pas shefi i qeverisë libaneze i propozoi vendosjen e marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve. “Plotësisht dakord!”, iu përgjigj tjetri.

Në orën dhjetë të natës, kur ndërkohë qenë kthyer në Mision, drejt Tiranës u shifrua dhe fluturoi në eter radiogrami i tretë i asaj dite:

“Shokut Enver,

1) Ambasadori sovjetik në Londër Solldatov sot na foli ngrohtë dhe tha se fjalimi ynë qe shumë i mirë. I vura në dukje se Tito po tregohet shumë aktiv për forcimin e bllokut të tretë. U përgjigj se ç’mund të presësh prej tij. I thashë është agjent i amerikanëve etj.

2) Në mëngjes Hrushovi, Tito dhe Zhivkovi u takuan përzemërsisht e biseduan gjatë në këmbë në korridor. Ne u kaluam pranë dhe u kthyem shpinën, u larguam me përbuzje.

3) Për drekë ishim tek Hrushovi kryetarët e delegacioneve dhe ministrat e vendeve tona. Pyetëm më parë se kush do qe. Na e lanë varur, pastaj na thanë “Pse pyesni?” Reisi u përgjigj “Pyesim në rast se do të jetë Tito se po të jetë ai ne nuk vijmë”. Na thanë se janë vetëm vendet socialiste. E çfarë socialisti është Tito?

Megjithatë shkuam. Dreka qe drekë varri. Unë ndenja midis Dezhit e Podgornit. Hrushovi për të treguar se çfarë kishte biseduar sot me Titon tha se u hëngrëm me të për Sekretariatit. Tito thoshte se në vend të Hammarskjoldit do të ishin pesë e Hrushovi ngul këmbë për tre.

Dreka vazhdoi një orë e gjysmë. Askush nuk guxoi të thoshte sikur edhe një fjalë kundër nesh. Hrushovi fliste, Zhivkovi i lëpinte këmbët. Dezhi kërkonte t’i tërhiqte sa më shumë shikimin. Gomulka fliste rrallë, por si në shtëpinë e tij. Kadari qe djalë i përkëdhelur, kurse unë isha memec. Natyrisht shkëmbyem disa fjalë me Podgornin e Dezhin, por me që ata nuk tregonin dëshirë për të biseduar me mua, unë nuk ua vara fare.

Novotni sillej më serioz. Nga muhabetet aty mund të citoj frazat karakteristike të Hrushovit: “...Tito është zëmëruar

se shtypi flet shumë për të; Tito do pesë në Sekretariat sepse do një vend ta zërë vetë; i thashë Titos se po nuk u rregullua çështja e Sekretariatit nuk ka çarmatim, më mirë të mos çarmatosemi se sa të na komandojë Hammarskjöldi...”....

Kur po hanim pjepër Hrushovi tha se është pjepër rumun e qeshi, pastaj u kthye nga unë e tha “Ndoshta është pjepër shqiptar”.

Unë e pashë në sy serioz e nuk i shqiptova asnjë fjalë. Pastaj tha është pjepër bullgar e Zhivkovi fluturoi nga gëzimi.

Podgorni pyeti a bie shi tek ne. I thashë “Bie shumë, por dimrit dhe beharit bën thatë”.

Shtoi se Ukraina sivjet ka pasur thatësirë. I thashë “Jo si tek ne që muarëm 40 përqind të prodhimit”.

Në këtë kohë u ngritëm për të ikur.

4) Fjalimi i Dezhit është bile më i butë se i Titos. Sigurisht e keni lexuar. Kurse Gomulka bën disa propozime të papranueshme për ne:

a-të mos u jepen sekretet atomike shteteve që nuk i kanë;

b-vendet të cilët nuk kanë baza raketash e raketa të angazhohen të mos vendosin;

c-mos të ndërtohen më baza në vendet e huaja. Domethënë të vulozet statukuoja e bazave ushtarake: Italia e Greqia t’i mbajnë bazat e ne të mos vendosim raketa, Kinës të mos i jepet sekreti atomik e raketa, amerikanët t’i mbajnë 260 bazat ushtarake dhe kampi ynë asnjë. Kur të paraqesin rezolutën do ua kundërshtojmë...

6) Pyeta Gromikon sa kohë do rrinë këtu. Tha “Nuk di gjë”. Po ashtu dhe Podgorni. Duke komentuar fjalimin e Naserit, i thash Gromikos se Naseri foli të paktën më mirë se Tito, i cili është i poshtër. “Sigurisht”, tha.

Siç duket këtu do të rijmë shumë gjatë, të paktën gjer në fund të tetorit...Fjalimet tona këtej e tutje do t’i bëjmë më

të forta. Ju kam zili për qetësinë relative e sidomos gjahun. Ne jemi të burgosur, por këtu duket lakuriqësia e revizionistëve dhe demokracia amerikane. Përqafime. Mehmeti”.

Takim me Ges Holl, Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste Amerikane

Në mëngjesin e herët të 28 shtatorit, e mërkurë, kryeministri shqiptar i kishte dërguar Enver Hoxhës edhe një informacion shtesë për çfarë pat ngjarë një ditë më parë.

“1) Fjalimi i Kastros nuk u ka pëlqyer miqve”, shkruante që në rreshtin e parë. “Kur ishim për drekë te Hrushovi”, vazhdonte, “Gromiko e ironizoi atë e Hrushovi nuk demonstronte mendimin e mëparshëm me Kastron.

2) Në pritjen e çekëve muarëm takim me Ges Holl, Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste Amerikane, Xheksonin, Sekretar, e Petersonin, kryeredaktor i gazetës së tyre.

E pyetëm se si do ta marrin fuqinë, në rrugë paqësore apo me luftë. Ges Holli i shkeli synë Beharit e tha: “Akoma nuk e kemi vendosur”.

Bisedimi qe shumë shoqëror. Folën mirë për partinë tonë, ju fola kundër revizionizmit e Titos si agjent i Departamentit Amerikan të Shtetit.

Ishin dakord me vlerësimin tonë për revizionizmin e Titon... Pastaj rastësisht u takuam me Zhivkovin. Unë kisha limonadë në dorë. Ai kërkoi dhe mori një për vete e tha: “Do ta takoj me shokët shqiptarë”. Behari nuk mori. Zhivkovi i tha Beharit: “Po ju pse nuk merrni apo doni të qëndroni neutral?”

Behari iu përgjigj: “Partia ime më ka mësuar të mos rri kurrë neutral”.

Menjëherë e mora unë fjalën, sa do që ishte e qartë se Zhivkovi e tha me shaka e i shpëtoi. I thashë me seriozitet:

“Ne as kemi qenë dhe as do të jemi kurrë neutralë. Marksizmi na mëson të jemi luftëtarë aktivë e jo neutralë. Për ne të jesh neutral do të thosh të jesh me armikun”.

U skuq, uli kokën, nuk foli...i kthyem bythën dhe u larguam.

U takuam edhe me shkrimtarin Pier Kurtad.

Solldatovi, ambasador në Londër, erdhi dhe ai vetë, duke u treguar shumë intim e zemërhapur. Mbas shumë bisedimesh, unë hapa llafin e Titos duke e quajtur të poshtër fjalimin e tij e njësoj si Frankon.

U hodh nevrrik Kurtad e tha: “Nuk jam dakord ta quash si Frankon, sepse Franko ka vrarë qindra komunistë. Duhet të jemi objektivë. Fjalimi i tij ka qenë pozitiv etj”.

Ja preva rreptë: “Tito është fashist e vrasës njësoj si Franko. Ka pushkatuar mbi 8 mijë komunistë e qindra bolshevikë të revolucionit të tetorit. Ajzenaueri nuk mund të priste një fjalim më të mirë nga Tito etj.”

Tha: “Më fal, po kjo është pozita e partisë sime e komunistëve francezë”.

Iu përgjigja: “Edhe unë nuk të flas si person. Kjo është pozita e partisë dhe popullit tim”.

Solldatovi dëgjonte me vërejtje. E kur e pa se u nxeh puna, desh të largohej. I thashë: “Po ju nuk merrni pjesë në debat apo jeni neutral?”

Foli me buzëqeshje shumë të singertë: “Mbi Titon ua thashë mendimin në mëngjes. Shoku Behar më njeh me kohë dhe besoj se nuk do të formoni mendim të keq mbi mua”.

Në mëngjes kishte rënë dakord me ne mbi Titon. Biseda që e rreptë po shoqërore me Kurtadin. E ftuam për pushime.

3) Parmbrëmë qemë për darkë te Nehrui. Hrushovi dukej i vrarë, jo me iniciativën për llogje. Sa u takua me Kastron e u nda prej tij.

Kastron e kapa unë e hëngra në një tavolinë me të. Kur mori vesh se kisha qenë në Spanjë etj, nuk na ndahej sikur të ishim të njohur prej kohe. Mbetëm dakord menjëherë për të lidhur sa më parë marrëdhënie diplomatike e tregtare. E urova për fjalimin historik, etj. Foli shumë mirë për ne. Edhe ministri i jashtëm i tij qe shumë i afruar.

Kadari habitej e Dezhit i vinte inat që Kastro rrinte me ne dhe flisnim pa përkthyes spanjisht. Mbas pothuaj një ore erdhi e gati sa i pushtoi këmbën Dezhi. Donte ta merrte në tavolinën e tij.

Pas shumë hezitimesh Kastro mu lut ta fal, shkoi. Atje vajti edhe Zhivkovi. Kastro ndenji pak e iku, e ftoi Nehrui. Kur u ndamë, më përshëndeti fort e duke thënë me zë të lartë “Hasta Pronto Amigo!”, “Mirë u pafshim së afërmi, o miku im!”

Premtoi të vijë në Shqipëri kur të gjendet rasti. I hodha fjalën kundër Titos.

Në tavolinën e bukës ishte edhe ministri i jashtëm çek. Biseduam përzemërsisht gjatë e pyetëm kur do ikim. Tha me ironi pozitive: “Nuk duhet ikur me duar bosh fare, diçka duhet përfituar”...

E pyetëm çmendonte për Sekretariatit dhe çarmatimin. U përgjigj: “Asgjë nuk arrihet me Sekretariatit, as për transferimin e OKB-së, dhe nënvizoi me qëllim: “E dhëntë Zoti të mos bëhet asnjë çarmatim!”

I thamë se nuk jemi dakord me propozimet polake për çarmatimin e presim mendimin e udhëheqjes nga Tirana për të vepruar, duke i demaskuar këto propozime. Dëgjonte, dukej që i aprovonte, por nuk pohonte, rezervohej.

I folëm kundër Titos. Ishte dakord me ne duke e tallur Titon, bile edhe Naserin. Me ne fliste me përzemërsi shoqërore. Tha se Novotni do të rrijë vetëm dy javë.

Unë mendoj se qëndrimi i çekëve është shumë kuptimplotë dhe aspak i rastit. Ata në thelb nuk besojnë në çarmatimin dhe këtu kanë ardhur vetëm nga halli.

4) Mbas ca ditësh do të japim edhe ne pritje. Do rezervojmë vaporin të ikim porsa të largohet të paktën njëri nga miqtë, besoj aty nga mesi i tetorit.

5) Vazhdojnë prapaskenat me intensitet. Nëse Tito do të jetë mbret, Naseri kërkon të jetë Sulltan. Për ata deti u bë kos e kanë rrëmbyer secili nga katër lugë, çndonjëra sa katër lopata.

Hrushovi as na pyet për propozimet që bën, as për ato që tha në fjalim, as për ato që bën çdo ditë, sado që janë të pranueshme...Duhet demaskuar lakuriq në nëntor...”.

“Fiqireti me fëmijët janë mirë...Të përqafoj. Shpati”

Ndërsa atë njëzetë e tetë shtator në Pallatin e Qelqtë do të niste diskutimi për pranimin si anëtarë të rinj të Organizatës së Kombeve të Bashkuara edhe dy vendeve afrikane, Senegalit dhe Republikës së Malit, në Misioni shqiptar mbërriti një radiogram.

Vinte nga Tirana.

Kishte dalë nga zyra e Enver Hoxhës në orën 14.25.

“I dashur Mehmet,

1) Fjalimi yt na pëlqeu shumë. TASS-i na e vonoi dhe nuk e dhamë dot po atë ditë që e mbajte, as në radio dhe as në gazeta. E botuam të nesërmen në gazeta dhe e përsëritëm disa herë në radio. Në gazeta do të shkruhen disa artikuj duke u bazuar në fjalimin.

...

3) Shokët tanë, Behari dhe Reisi, të na dërgojnë komunikata me telegrame të hapura të bisedimeve dhe të kontakteve që mund të kesh me udhëheqës të ndryshëm që kështu t’i shtypë Agjencia Telegrafike e Lajmeve.

4) Komiteti Qendror i PK të Kinës na dorëzoi letrat përgjigje për partitë që i kishin bërë asaj dhe që ti i di. I djeg me zjarr, veçanërisht komshiun tënd në OKB, Zhivkovin.

5) Delegacionin tonë në Moskë e kishte pritur Pospjellovi, shumë ftohtë, vetëm fjalët si je, si jam dhe asgjë tjetër. Ata i çuan në hotel. Atje i kanë çuar të gjitha delegacionet.

...

9) Më 30 është festa e kinezëve. Në fjalim do të hedh disa “parabomba” për “miqtë” sovjetikë, do t’i bie pragut të dëgjojë dera.

10) Fiqireti me fëmijët janë mirë. E mbaj në korrent për ty.
Të gjithë shokët janë mirë, të bëjnë të fala...
Të përqafoj
Shpati”.

Gazetari grek Kris Nikollopulos, i atashuar pranë OKB-së

Pa u nisur ende për në Pallatin e Qelqtë Reis Malile trokiti në apartamentin e kryeministrit dhe e vuri në dijeni për ngulëkëmbjen e një korrespondenti të agjencisë greke që t'i bënte një intervistë.

-“Quhet Kris Nikollopulos”, - shtoi, - “Është i atashuar pranë OKB-së”.

Mehmet Shehu e vështroi pa folur.

-“Sigurisht nuk është dashamirës”, - tha tjetri, - “por as edhe shumë agresiv”.

Kryeministri sërish nuk shqiptoi asnjë fjalë.

-“Le të vijë!”, - tha papritur, - “T’u themi ca gjëra grekëve. Të paktën të mos shkojnë me ëndrrën se ata do t’i mbajnë raketat dhe ne jo”.

“Baza e Vlorës është aty, le t’u shkojë shtatë”, vijoi Mehmet Shehu dhe u ngrit vrulltas në këmbë, “Ne do ta zgjerojmë e bëjmë më të fortë”.

Nisi të ecte nëpër dhomë.

-“Apo ai gazetar do të ketë hallin e Vorio Epirit?”, - pyeti.

-“Nuk besoj”, - u përgjigj Malile.

-“Le të vijë, le të vijë!”, - shqiptoi kryeministri, - “Po e pres nesër”.

Pas atyre çapitjeve rrotulluese nëpër dhomë Mehmet Shehu iu afrua fare afër Reis Maliles.

-“Do të qe e dobishme dhe korrekte që Tiranës t’i dërgohej teksti i plotë i intervistës që bëra të dielën me gazetarin e revistës “United States News and World Report”. Nuk ka

përse ajo të publikohet nga shtypi ynë pasi të botohet në Amerikë. Le ta kenë që më parë gati”.

Pastaj i zgjati dyfletëshin e daktilografuar me gjashtë pyetje përgjigjet e bisedës.

Kur delegacioni u nis për në sesionin e Asamblesë, në limuzinën e kryeministrit që të tre, Shehu, Shtylla dhe Malile, filluan të shkëmbenin mendim për telashet që me tezën e çarmatimit të Ballkanit u kishin krijuar jo vetëm polakët, por edhe rumunët.

“Në rast se kjo do të pasohet këto ditë edhe nga bullgarët, përplasi fjalët mes dhëmbëve dhe buzëve kryeministri, atëherë duhet kundërshtuar hapur”.

Mirëpo pikërisht atë 28 shtator ndodhi që në diskutimin e tyre në OKB bullgarët u rreshtuan me projektpropozimin e sovjetikëve për një Ballkan pa armë bërthamore dhe raketa.

Reis Malile dorëzoi menjëherë një deklaratë mospajtimi.

Në mbrëmje radiogrami i nisur për Enver Hoxhën mes të tjerash thoshte “...gazetat e darkës botojnë fotografinë e Titos dhe të Hrushovit duke i dhënë dorën njëri-tjetrit me përzemërsi e buzëqeshje...”

2) Sonte kur ishim në pritjen e Kryeministrit të Nepalit, takova Novotnin. Tha: “Nuk do të rrimë për debatin e çarmatimit”. Do të largohet në 7 tetor. “Përveç po na u tha që të rrimë me doemos, atëherë duhet të nënshtrohemi”, pohoi...

3) Pas pritjes së Nepalit ishim me ambasadorin e Libisë, gruaja e tij fis shqiptari. U njohëm. Gruaja erdhi vetë e u prezantua.

Me ish-ambasadorin çek në Bukuresht e tash transferuar në Pragë,...hapëm muhabetin e Titos. Nuk lamë gjë pa thënë kundër tij si armik që këtu po lot një rol jashtëzakonisht të rrezikshëm, se kështu duhet kuptuar e jo si disa që thonë se Tito këtu po mban qëndrim pozitiv.

I thashë se në Bukuresht ne mbajtëm atë qëndrim e do të vazhdojmë gjer në fund sikur edhe vetëm të mbetemi. “Kurrë, i thashë, nuk kemi për të qenë dakord me ato që shpresojnë te Tito e thonë të mos e demaskojmë se i rritet mendja”. Tha: “Pse nuk paskemi të gjithë një qëndrim në Bukuresht?”

I u përgjigja: “Jo. Ne mbajtëm qëndrim në kundërshtim me shumicën dhe e konsiderojmë se uniteti kampit socialist është në krizë dhe duhet luftuar kundër revizionizmit të Titos, ndryshe do ketë rreziqe. Partia Jonë kurrë nuk do të pajtohet me revizionizmin”, etj.

Nuk ramë dakord për të gjitha vlerësimet, por evitua të dy palët të flisnim mbi partinë e tyre ose parti të tjera. Më falënderoi për bisedën shumë interesante e tha se njësoj paskemi menduar për protestën e Popoviçit në OKB, demagogji për ta paraqitur Titon të persekutuar nga amerikanët.

4) Po atje mu afrua një korrespondent amerikan në Moskë e më pyeti për çështjet mbi Shtetet e Bashkuara. I thashë ‘Kam përshtypjet më të pështira për të ashtuquajturën demokraci amerikane’.

“Pse?”, pyeti.

Iu përgjigja: “Sepse më kini burgosur praktikisht, etj.”

U habit e u turpërua. Pastaj, duke dalë, i tha Reisit: “Është poshtërsi për qeverinë amerikane të sillet kështu”.

“Të përqafoj me mall. Shpati”

Në mëngjesin e 29 shtatorit, fiks në orën dhjetë, Mehmet Shehu kishte lënë takimin me korrespondentin e agjencisë greke të lajmeve dhe ndërkaq Kris Nikollopulos po priste në sallon, kur shifranti i solli një radiogram nga Enver Hoxha.

“I dashur Mehmet,

1) Fjalimet e të gjithëve po i ndjekim me kujdes dhe mund t’i karakterizojmë me fjalët e Shekspirit “shumë zhurmë për asgjë”...

6) Mbrëmë isha në familjen tënde. Fiqiretit i dhashë të lexonte radiogramet e tua dhe u zbavit. Nënë e fëmijët i ke mirë. Mos u bëj merak. Bashkimit i është thyer shpata, prandaj kur të vish i sill një shpatë, besoj se do të gjesh atje, pse të tëra shpatat nuk do të jenë kthyer në parmenda.

Beharit i jep të fala. Djalin e ka mirë...

Të përqafoj me mall

Shpati”.

Mehmet Shehu mbajti frymën me shpresë të qetësonte të rrahurat e zemrës. Sytë i shkuan sërish tek rreshtat e fundit të letrës së ardhur nga Enver Hoxha “Mbrëmë isha...”

Intervista me gazetarin grek

Kris Nikollopulos e priti pas dhjetë minutash.

-“Pse vendosët ta kryesonit vetë delegacionin?, - ishte pyetja e parë e tij.

Mehmet Shehu u përgjigj shkurt: ”Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë e vendosi ta kryesoj unë për shkak të probleme të rëndësishme që janë për shqyrtim...”

-“A do t’i bënit propozime të veçanta Asamblesë së Përgjithshme për bashkëpunimin e shteteve ballkanike pavarësisht sistemit të tyre shoqëror?”

-“Në Asamblenë e Përgjithshme theksova edhe njëherë politikën e njohur të qeverisë sonë që midis vendeve të Ballkanit të vendosen dhe zhvillohen marrëdhënie të miqësisë dhe të bashkëpunimit reciprokisht të dobishme”.

Kris Nikollopulos nuk lëvizi asnjë tipar të fytyrës, megjithatë kryeministri shqiptar i dalloj një palpitje të padukshme të buzëve.

-“Flitet se gjatë qëndrimit në Asamblenë e Përgjithshme”, - vijoi gazetari i agjencisë greke të lajmeve, - “udhëheqësit e vendeve socialiste ballkanike do të thërresin një konferencë të të gjitha delegacioneve të rajonit, duke përfshirë edhe ato greke dhe turke, për të biseduar probleme që kanë të bëjnë me atë zonë dhe për t’u përpjekur të gjejnë mundësitë e vendosjes së marrëdhënieve paqësore midis tyre dhe zhvillimit të bashkëpunimit reciprok. A është e vërtetë një gjë e tillë?”

Mehmet Shehu vuri përpara pëllëmbën e hapur të dorës dhe e lëvizi atë në një gjest mohues: “Nuk kemi asnjë dijeni për një konferencë të tillë”.

Kris Nikollopulos dinakëroi vështrimin.

-“A është gatshme Shqipëria të vendosë marrëdhënie paqësore me Greqinë dhe sipas mendimit tuaj në çfarë mënyre mund të bëhet kjo?”

-“Qeveria jonë e Republikës Popullore më se njëherë”, - preu Shehu, - “e ka shprehur këtë gatishmëri”.

Gazetari grek u duk sikur bëri një përpjekje për të vënë buzën në gaz, por nënqeshja iu shua menjëherë mbi cipën e butë të buzëve.

-“Gazetat e djathta të Greqisë shkruajnë se përpjekjet e vendeve socialiste të Ballkanit për bashkëpunim rajonal kanë qëllim të dobësojnë frontin e brendshëm të vendit tonë, sepse thonë që ato, Shqipëria, Bullgaria dhe Rumania, nuk janë vërtet të interesuara për paqen, por për përmbysjen e qeverisë në Athinë si edhe për të ndihmuar forcat komuniste greke”.

Fjalët e përgjigjes Mehmet Shehu i lëshoi si gurë të rëndë në një rrëpirë: “Republika Popullore e Shqipërisë as ka ndërhyrë dhe as do të ndërhyjë në punët e brendshme të vendeve të tjera, duke përfshirë Greqinë...”

Pastaj u ngrit nga poltroni. Intervista kishte përfunduar.

Nga ky çast nuk do të kapërcente më shumë se një orë kur Reis Malile do të trokiste në apartamentin e tij dhe do t'i sillte numrin e fundit të gazetës “Dielli”.

Në faqen e dytë ishte botuar një shkrim me titullin “Letër e hapur Mehmet Shehut”.

Një nga frazat e tij thoshte: “Fakti është Z. Kryeministër që më 1919, një shumicë e krerëve shqiptarë të asaj kohe, duke ndjerë rrezikun e tërësisë tokësore të Shqipërisë, ju lutëm Amerikës ta merrte Shqipërinë si një protektorat për një kohë të caktuar, Amerika refuzoj”.

I gjithë artikulli që kritikë për qeverinë komuniste të Tiranës, e cila kishte këputur marrëdhëniet me Shtëpinë e Bardhë.

Sërish Mot Fishman

Atë ditë të 29 shtatorit në sallën e madhe të Asamblesë do të ndodhte një ngjarje, e cila do të mbushte të gjitha faqet e para të gazetave të mbrëmjes dhe do të qe ekskluzive për edicionet e lajmeve radio dhe televizive.

Mes folësve më i rëndësishmi ishte paralajmëruar se do të qe kryeministri anglez Harold Makmilan. Kur i erdhi radha dhe shkoi në foltore ai foli qetë. Gjithçka u trazua në atë pjesë të diskutimit të tij ku britaniku deklaroi përkrahjen e vet për Sekretarin e Përgjithshëm Hammarskjold.

Nikita Hrushovi që nga tryeza e tij, shumë i zëmëruar, nisi t'i binte ritmikiht me grusht, me të dyja duart, syprinës së tavolinës. Menjëherë e ndoqën nga pas bashkëpunëtorët e tij, përfshi edhe Andrej Gromikon. Pak sekonda më pas ajo lojë nisi t'u shijojë si të qe zbavitje dhe për disa minuta me radhë nuk u shkoi ndërmend ta ndërpritnin.

Atje ku ndodheshin, të shpërndarë nëpër sallë, asnjë prej delegatëve të vendeve të kampit socialist nuk e ndoqi shembullin e sovjetikëve.

Ndërkohë Makmilan e vijoi fjalën e tij me por të njëjtën qetësi siç e kishte nisur. Në një çast tjetër Nikita Hrushovi sërish e kundërshtoi, por këtë herë duke u ngritur nga vendi dhe duke i nderur me kërcënim gishtin tregues të dorës së djathtë.

Radiogrami që Mehmet Shehu, nëpër natën e kontinentit amerikan, i dërgoi Enver Hoxhës kur në brigjet e Adriatikut pas pak pritej të zbardhte dita e 30 shtatorit, informonte "Sot në mëngjes Hrushovi e tjerë bënë një mbledhje atje në sallat e OKB-së. Mua nuk më ftuan. Nuk dimë çfarë u

bisedua. Arkadievi, që është zëvendës i Hammarskjoldit nga ana sovjetike, pyeti Beharin “Ku është shoku Mehmet? Pse nuk shkon në mbledhje?” Behari iu përgjigj: “Ja, shoku Mehmet tek është ulur në vendin e tij, sepse nuk na ka ftuar njeri në mbledhje”.

Arkadievi u habit, pastaj tha se kishte dëgjuar fjalimin tim e i kishte pëlqyer shumë. “Kështu duhet folur, hapët, qartë e drejtë, pa marrë parasysh konsekuencat ç’thonë të tjerët”, pati pohuar.

Është hera e dytë që Arkadievi lexon fjalimin tim, po ashtu edhe Solldatovi.

2) Bullgarëve u shtruam zyrtarisht mos aprovimin e qeverisë tonë për propozimin e Dezhit për çarmatimin lokal të Ballkanit...U thamë që nuk jemi dakord as me mënyrën si kanë proceduar, as me përmbajtjen, se ne nuk pranojmë të çarmatosemi si ballkanas, sepse Flota e Gjashtë ditë e natë do të na rrijë në kokë.

3) Sigurisht e kini lexuar fjalimin e Makmillanit që foli sot. Është grusht i rëndë kundër nesh. Hrushovi bëri xheste që la përshtypje shumë të keqe në sallë, duke i prerë dy herë fjalën Makmillanit, duke rrahur tavolinën me grusht, kur të tjerët e duartrokitnin... Sikur të ishim jo në OKB, por në mbledhjen e drejtorive të ndërmarrjeve. Makmillani u duartrokit nga të gjithë...

5) Unë parashikohet të nisem me vapor në 5 ose 12 tetor. Pritjen nuk do ta japim se në Mision nuk ka vend dhe në hotel nuk jepet garanci sigurimi nga askush, kurse miqtë i japin pritjet në misionet e tyre. Nga protokolli nuk është e domosdoshme, ka dhe të tjerë që nuk japin. Miqve ua shpjeguem. Në Mision do të japim pritje vetëm për shqiptarët. Behari mbasi të iki unë do të japë pritje me grupe e jo të përgjithshme. Përveç kësaj duhet pritur gjer mbas muajit tetor se radhët janë zënë mbasi për çdo ditë japin tre pritje...

7)...Sesioni i 15-të është sesioni i forcimit të pozitive të Titos, i formimit de facto të kampit të tretë, i udhëhequr ideologjikisht nga ai.

8) Sekretari i delegacionit sovjetik në drekë i tha Reisit se mbledhja që do bëhej sonte te Hrushovi me kryetarët e delegacioneve tona anulohet e do të bëhet të shtunën. Reisi e pyeti “Çfarë mbledhje?! Ne nuk dimë gjë, nuk na ka njoftuar njeri”. Ai u zverdh e tha mbytur se mendohej të bëhej një mbledhje, por do të shtyhet. Të shohim çdo të na thonë të shtunën.

Me anëtarësimin e delegacionit të Malit, prapë ndërruam vendet. Sovjetikët, jugosllavët e bullgarët rrinë bashkë, ngjitur tavolinat me ekstremin e djathtë, kurse ne ndodhemi në ekstremin tjetër të sallës dhe jemi vetëm, por më rehat.

Gazetat botojnë përsëri fotografitë e Tito-Hrushovit, siç kuvendonin dje përzemërsisht në OKB. Aktivitet të madh mbrapa skene, sidomos Tito, i cili sot bisedoi dy herë me Hrushovin”.

Ndërkaq që radiogrami kishte mbërritur në Tiranë, deshifruar dhe prej Enver Hoxhës edhe lexuar, në Nju Jork presidenti jugosllav vazhdonte të mbetej ylli i medias amerikane edhe më 30 shtator.

Këtë ditë ai bëri dy takime me gazetarë. Të parin e kreu vetëm me bashkëkombës. Këta i bënë tetë pyetje. Në bisedën me palën e dytë, të gjithë përfaqësues të spikatur të publikut amerikan, një çast Titos iu kërkua mendim për mosmarrëveshjet e lindura mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës. U përgjigj me në buzë një nënqeshje kuptimplotë: “Për marrëdhëniet mes BRSS-së dhe Kinës nuk di ndonjë gjë, sepse nuk më kanë treguar”.

Ndërkohë po këtë ditë, e cila që e premtë, realizoi një sukses mediatik edhe Mehmet Shehu. Agjencia greke e lajmeve pati publikuar intervistën e tij.

Kris Nikollopulos nuk i kish trazuar asnjë presje.

Në mbrëmje, për tre orë të tëra, kryeministri priti e bisedoi me Sekretarin e Përgjithshëm të Veteranëve të Brigadës “Abraham Linkolm” Mot Fishman dhe një grup bashkëpunëtorësh të tij. Takimi mes tyre u gjallërua shumë kur të ardhurit i çelën temën e lirimit të bashkëluftëtarëve ende në burgjet e Frankos dhe si po përpiqeshin të nxirrnin nga thonjtë e diktatorit spanjoll sa më shumë prej tyre.

Sapo u nda me miqtë e tij, në prag të mesnatës, kryeministri i nisi Enver Hoxhës radiogramin e vetëm të asaj dite: “1) Sot për drekë qe shumica e kryeministrave dhe presidentëve d.m.th. vendet socialiste dhe disa neutrale, mes të cilëve edhe Tito... Asgjë interesante, intimitete midis Hrushovit e Titos. Ky krenuar si një kryembret dhe asgjë tjetër.

Kur erdhi Tito, unë i thashë Vinogradovit, ambasador sovjetik në Paris: “Si e quani Titon, socialist apo neutral?” Ai u përgjigj: “Si mund ta quajmë socialist atë?! Ai është neutral. Po ju si e quani?”

I thashë: “Ne e quajmë agjentin më të rrezikshëm të Departamentit të Shtetit dhe armikun më të betuar të Marksizmit”.

Pohoi: “Jam dakord me ju, ashtu është...”.

Gazeta “Shqiptari i lirë”

Tashmë në Nju Jork qe natë dhe në Shqipëri prag gdhirjeje e muajit të ri të tetorit.

Në Tiranë në mesditën e 30 shtatorit Enver Hoxha kishte marrë pjesë në një pritje të ambasadës të Republikës Popullore të Kinës, dhënë me rastin e 11 vjetorit të shpalljes së saj. Pat mbajtur edhe një fjalim. Tufat e frazave të tij qenë të mbushura pa pushim me togfjalëshat “imperialistët amerikanë...imperialistët grabitqarë amerikanë...të gjitha këto veprime të imperialistëve amerikanë...mbrojtja e Kinës nga çdo orvatje e imperialistëve...të mos lejohet imperializmi amerikan...imperialistët amerikanë bëjnë shumë zhurmë...imperializmi është në kalbëzim...duhen demaskuar pa mëshirë imperialistët amerikanë...imperialistët amerikanë do të dështojnë me turp...”

Në këtë fjalim të tij Hoxha kishte shqiptuar edhe fjalët “Në Nju Jork, sikundër dihet, është hapur dhe vazhdon punimet sesioni i zakonshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Kryetari i Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, shoku Mehmet Shehu, shprehu aty vullnetin e popullit shqiptar, të Partisë dhe Qeverisë sonë, që konsiston në ruajtjen e paqes në botë. Ai dënoi kolonializmin. Shoku Mehmet Shehu mbrojti dhe kërkoi me këmbëngulje që të pranohet në Kombet e Bashkuara Kina e madhe dhe të flaket jashtë kukulla e Çan Kai Shisë, duke theksuar me të drejtë se pa pjesëmarrjen e Kinës

asnjë problem ndërkombëtar nuk mund të marrë zgjidhjen e drejtë e të vërtetë...”

Ndërkaq në Tiranë, nëpërmjet linjës ajrore me Romën, kishte mbërritur, i nisur prej Misionit, teksti i fjalimit që kryeministri shqiptar do të mbante më 3 tetor.

Në Nju Jork po ashtu nuk pat munguar edhe një ngjarje tjetër. Sapo kishte dalë nga shtypshkronja numri i fundit i gazetës “Shqiptari i lirë”.

Botonte artikullin “Persekutime fetare në Shqipërinë komuniste”.

Mehmet Shehu në revistën “Life”

Më 1 tetor kryeministri shqiptar do të gjendej me dy fotografi të bukura në revistën “Life”.

Reis Malile pothuaj do të vraponte drejt apartamentit të kryeministrit. Ky në fillim mbeti i pafjalë. Qenë vërtet foto shumë shprehëse.

Në njërën pamje ndodhej në foltoren e Asamblesë, me në dorën e majtë fletë të daktilografuara. Ishte me kostumin e zi dopiopet.

Në foton e dytë, i veshur me pardesynë e tij gri, gjendej para një tufe të madhe mikrofonash.

-“Është revistë e ilustruar mjaft popullore, tha Malile, ka tirazh të lartë. Merret që nga politika deri tek kronika e zezë. Përfshin të gjitha thashethemet për njerëzit më të njohur të botës”.

Kur pa se tjetri ende nuk po i gëzohej sa duhej fotove të tij shtoi se “Life” e pat nisur jetën e vet që në nëntor 1936 dhe qe e shumë e famshme për kopertinat e saj. Në njërën, me sa kujtonte nga çfarë i kishte thënë një koleg, pat nxjerrë edhe Stalinin.

Mehmet Shehu ngriti vrullshëm kokën. E pa në sy si të deshte një dëshmim tjetër të asaj të pabesueshmeje që sapo kishte dëgjuar.

-“Unë nuk e kam parë, por më kanë thënë se qe një foto shumë sugjestionuese e tij, mjaft e bukur”, vijoi Reis Malile.

-“Mund ta mbaj?”, shqiptoi butë kryeministri. Tjetri vuri buzën në gaz dhe doli.

Të vizitojnë “Empire State Building” apo “Rokfeler Center”?

Atë 1 tetor, në orën 12.00, nga paradhoma e zyrës së Enver Hoxhës në Tiranë ishte nisur për tek shifrantët e Ministrisë së Jashtme një radiogram i tij i shtrirë në tre faqe.

Në të thuhej se mbledhja përgatitore në Moskë, ku do të gjendej marrëveshja për çfarë do të debatonte kuvendi i ardhshëm i të gjitha partive komuniste të botës, do të hapej po këtë ditë.

Sipas Hoxhës, delegacionet pjesëmarrëse qenë shumë të zbehta, veç atij kinez dhe shqiptar që ishin të plotë e të drejtuar nga politikanë të rëndësishëm. Gjithë të dërguarve sovjetikët u kishin dorëzuar një material në formë deklarate, i cili qe prej 36 faqesh.

“Po të kesh vërejtje e sugjerime na i shkruaj”, në fund të radiogramit të gjatë i shkruante Enver Hoxha Shehut.

Në mbyllje të tekstit sërish përshëndetej me “Të përqafoj, Shpati”.

Dy radiograme të nisura nga Nju Jorku pasdite dhe në mbrëmjen e vonë informonin për çfarë pat ndodhur atë ditë në Pallatin e Qelqtë dhe në Mision.

Në të parin thuhej se qe hapur debati mbi pranimin e Kinës. Nga përfaqësuesit e lartë të kampit socialist në fillim kishte folur Nikita Hrushovi.

“Kjo është orvatje për ta marrë ne iniciativën”, i shpjegonte Mehmet Shehu Enver Hoxhës.

Në radiogramin e dytë i bëhej e ditur Tiranës se “Në 1 tetor kryeministri Mehmet Shehu priti në selinë e Misionit të RPSH-së në OKB një grup patriotësh të kolonisë shqiptare

të Nju Jorkut, anëtarë të organizatës “Vatra”. Ata i uruan shokut Mehmet mirëseardhjen, i shprehën ndjenjat e patriotizmit dhe të dashurisë ndaj atdheut dhe i uruan sukses në punimet e Asamblesë së OKB në interes të forcimit të paqes.

Takimi u zhvillua në një frymë të përzemërt”.

Ndërsa kjo vajtje-ardhje radiogramesh kishte përfunduar dhe më në fund qe mbrëmje e vonë, Reis Malile i propozoi kryeministrit të vizitonin godinën më të lartë në botë “Empire State Building”. Ose edhe “Rokfeler Center”, shtoi. Pastaj i shpjegoi se këtë herë kishin për t’ia dalë t’i anashkalonin detektivët e shumtë amerikanë dhe prepotencën e tyre. “Duke shëtitur me automobil natën, kthjelloi idenë e tij Malile, shmangim edhe kuriozitetin e popullatës, sepse në ato orë lëvizjet e saj janë të pakta e të rralla”.

Mehmet Shehu nuk e kundërshtoi, madje la t’i shprehej në fytyrë e nëpër gjeste një lloj gëzimi i përmbajtur. Shefi i Misionit qe përgatitur t’i hapte edhe një çështje pune, por hoqi dorë. Nuk kishte përse ja prishte humorin e mirë të atyre çasteve. Do t’ia bënte të njohur të nesërmen, në një orë të përshtatshme.

Kishte marrë informacion rreth përgatitjes së një demonstrate të tretë të vorioepirotëve, çka gjer ato çaste më shumë ishte vetëm një dëshirë e tyre. Ende protesta nuk pat marrë formë të prerë me datë, orë të caktuar dhe leje nga policia.

Tito lajmëron ikjen e tij nga Nju Jorku

Në seancën e veçantë për Kinën, në 2 tetor, paradite, do të fliste Tito, kështu që Mehmet Shehu vendosi të qëndronte i mbyllur në dhomë dhe në fjalimin e tij të ndryshonte disa formulime shprehjesh. I mëshoi më fort tonit të akuzës kundër qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Ndërkohë përgatiti edhe një radiogram tjetër për Enver Hoxhën: “Jam plotësisht dakord me konkluzionet tuaja mbi mbledhjen ku është Hysniu. Pavarësisht nga manovrat e tyre, ne duhet t’i detyrojmë deri në fund të nëntorit t’i vëmë me shpatulla në mur. Ata duhet të përgjigjen për të gjitha gjynahet e tyre, për Hungarinë, futjen e lëvizjes komuniste ndërkombëtare në rrugën e oportunitetit, për hapjen e ideve të revizionizmit, për frenimin e revolucionit, për qëndrimin antimarksist karshi nesh, për dështimin e qëllimit për të cilën erdhëm në Nju Jork, për komplotin e Bukureshtit.

Ata sot janë në mbrojtje, i ndjejnë pozitat e tyre të dobëta, prandaj përpiqen që të fitojnë kredi gjoja si luftëtarë konsekuentë kundër imperializmit, duke i rritur autoritetin Titos, të na thonë se Tito duhet konsideruar neutral...

Unë jam dakord si thoni ju, të mos lëshojmë asnjë milimetër...”

Në orën 13.00 Mehmet Shehu ia dorëzoi Reis Maliles tekstin përfundimtar të fjalimit për Kinën. Ai duhej të nisej menjëherë për në Tiranë. Versioni i parë, tashmë i mbërritur këtu, anulohet.

Pas kësaj si edhe një dreke të shpejtë, kryeministri dhe delegacioni u nisën për në punimet e Asamblesë. Qëndruan

në debat gjithë pasditen, deri në mesnatë. Në të dy herët që Reis Malile doli në sallon për të takuar kolegë të tij e marrë ndonjë informacion, nuk doli aspak duarbosh. Edhe atë ditë Josip Broz Tito pat bërë një spektakël tjetër mediatik. Presidenti jugosllav që takuar publikisht me emigrantë të kombit të vet dhe mes tyre që kujdesur të paraqitej jo vetëm si udhëheqës i vendit, por edhe prijës i shumë popujve në zhvillim.

Po atë ditë Tito kishte dalë edhe para gazetarëve të shtypit botëror të atashuar pranë Kombeve të Bashkuara. Prej pyetjeve që iu bënë, u mor vesh se shumë shpejt do të rimerrte rrugën e kthimit për në Beograd.

Kështu që do t'u mungonte në kronikat e Nju Jorkut.

Tre tetor, në Asamble Mehmet Shehu flet mbi përfaqësimin e Kinës në OKB

Në 3 tetor revista javore “Time” botonte një reportazh shumë të gjatë mbi punimet e Sesionit të 15-të dhe përdorte çdo përfoje të qarkulluar në Nju Jork për të vënë në vështirësi imazhin e delegacioneve të ardhura prej kampit socialist.

Ndërsa përpiquej të vizatonte pamjen e Nikita Hrushovit të ulur në sallën e Asamblesë autori e përshkruante atë si maskë të galvanizuar mbi fytyrën e një mumieje.

Ndërkaq Josip Broz Tito i dukej flokëthinjur, por i ushqyer mjaft mirë.

Pastaj citoheshin njëri pas tjetrit vetëm me emra disa prej krerëve të vendeve pjesëmarrës. Pas George Dezhit, Janosh Kadarit, bjellorusit Kiril Mazurov dhe Teodor Zhivkovit, vinte “shqiptari Mehmet Shehu”.

Vijonte në rreshtim Antonin Novotni dhe Vladislav Gomulka.

Tek e lexonte me të shpejtë shkrimin Reis Malile gjeti një deklaratë të Josip Broz Titos, sipas të cilën demonstruesve jugosllavë kundër tij u pat vënë një emër të keq. “Shumica e tyre, qe shprehur, janë çetnikë që i kanë lyer duart me gjak dhe se mes popullit të tij ata nuk përfaqësonin veç hedhurina, plehra, të cilat oqeani i kishte hedhur në këto brigje”.

Atë mëngjes qe edhe “New York Times” që botonte një intervistë të Dezhit, ndërsa ky përsëriste tashmë se për paqen botërore gjente me shumë vend shpalljen e Ballkanit si zonë neutrale.

Reis Malile e rilexoi edhe njëherë të dytë paragrafin.

Kur ja tregoi gazetën Mehmet Shehut ky nuk shprehu ndonjë shenjë nervozizmi. Tha se duhej bërë më shumë presion për ta neutralizuar atë tezë. Burimi i saj qe Nikita Hrushovi dhe lojërat e tij për ta pasur mirë jo vetëm me jugosllavët, por edhe me grekët. Shehu i kujtoi Maliles se një vit më parë kryeministri sovjetik jo vetëm i kishte bërë lëshime Titos në shpinë të Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe Athinës i pat lënë të kuptonte se Vorio Epiri qe një e drejtë e saj ekskluzive.

“Ta çojmë kundërshtimin tonë të vendosur, nguli këmbë ai, deri tek Gromiko. Por edhe Dezhit do t’ia them në sy”.

Kur hynë në sallën e Asamblesë dhe u ulën në vendet e tyre po fliste përfaqësuesi i një vendi afrikan. Do të qëndronin aty fare pak, sepse ne mesditë të gjitha vendet e kampit socialist qenë ftuar për drekë nga kryeministri bjellorus Kiril Mazurov.

Ndërsa për pak çaste u kthyen në Mision aty sapo kishte mbërritur një radiogram nga Enver Hoxha.

Në drekën e shtruar nga Mazurovi dy herë rresht Nikita Hrushovi u përpoq të bënte ndonjë shaka e me këtë rast ta afronte Mehmet Shehun. Një herë e pyeti “Ku është Zogu?” Ky ja ktheu “Ndodhet me shokët e tij si De Goli”.

Në një batutë të dytë Hrushovi tha se punët me jugosllavët do tua linin shqiptarëve. “Jemi gati për atë që meritojnë jugosllavët, brofi Shehu, edhe ata vetë e dinë si mendojmë ne për ta”.

Kur gjeti rast një herë të dytë t’i fliste, ndërsa qenë bashkë pothuaj të gjithë krerët e delegacioneve të vendeve socialiste, kryeministri sovjetik tha se do të propozonte që në marsin e ardhshëm të bëhej një mbledhje speciale e Asamblesë me temë çarmatimin në Evropë.

Pastaj pa me nënkuptim nga Shehu.

Të gjithë të tjerët e aprovuan.

Pas përfundimit të drekës u nisën për në Pallatin e Qelqtë. Po afrohej radha të diskutonte kryeministri shqiptar. Ndërsa qenë ende në sallon i arriti me hap të shpejtë Solldatovi.

-“Shoku Hrushov më dërgoi, shqiptoi ai me një frymë, të marr mendimin tuaj për mbledhjen e Asamblesë për çarmatimin në mars”.

-“Në qoftë se më pyesni të jap një mendim, tha shumë qetësisht Mehmet Shehu, më duket se nuk është e drejtë që pa mbaruar ky sesion të kërkohet një tjetër. Kemi kohë ta shpallim atë e kjo duhet bërë mbasi të konsultohemi. Unë do pyes edhe Tiranën”.

-“Do t’i them Hrushovit”, premtoi tjetri dhe u largua po aq shpejt sa edhe pat ardhur.

Kur u ulën nuk vonoi shumë dhe në rreshtin ku ndodheshin sovjetikët, në anën tjetër të sallës, nisi një debat mes Nikita Hrushovit dhe Hammarskjoldit. Një çast u dëgjua, me ritmin tashmë të mësuar nga të pranishmit, edhe përplasja e grushteve në tavolinë.

Kryeministri sovjetik i binte më fort dhe më me shumë qejf. Ndërsa e kishin konsumuar fjalën e tyre katër paraardhës, u ngjit në podin folës edhe Mehmet Shehu. Diskutimi i tij qe nëntë faqe.

Tek e dëgjonte shumë i përqendruar Reis Malile ndjeu se në fjalën e kryeministrit përmasa e sulmeve kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës qe rritur.

Kur në fund të seancës po dilnin Mehmet Shehu e ndoqi me sy George Dezhin dhe e kapi kur ky qe i sigurt se i pat shpëtuar: tek shkallët e daljes e ndërsa i qe afruar për të hipur te limuzina e vet.

I tha se kishte lexuar një intervistë të tij në “New York Times”.

-“Është falsifikim çfarë gjoja kam thënë për çarmatimin e Ballkanit”, - u përgjigj tjetri pa e parë në sy.

-“Atëherë të isha si ju do ta përgënjeshtroja zyrtarisht”, - vijoi ngulshëm Shehu.

-“Nuk i japim rëndësi”, - belbëzoi tjetri, shqiptoi një “Natën e mirë!” dhe u fut me tërë trupin në veturë.

Kur ora qe njëzetë e tre drejt Enver Hoxhës u nis radiogrami me raportimin e asaj dite. Në fund të tij Shehu shkruante “Ka të ngjarë të nisem në 12 tetor për në Sherburg. Do t’u njoftoj”.

Në mesnatë në drejtim të Pragës Reis Malile dërgoi edhe radiogramin e tij. Qenë gjithsej 18 fjalë: “Shoku Kryeministër foli sot, tre tetor, në Asamble, mbi përfaqësimin e Kinës në OKB. Merrni fjalimin përmes TASS-it”.

Kur gdhiu 4 tetori

Kur zbardhi dita e 4 tetorit Mehmet Shehu bëri kujdes ta raciononte sa më mirë atë ditë. Ajo zbardhi e qetë dhe iu duk premtuese për të punuar, por edhe çlodhur sado pak. Në mesditë do të merrte pjesë në një drekë që shtronte Nikita Hrushovi. Informacion për Enver Hoxhën do të mblidhte pikërisht këtu.

Në atë katër tetor Tito do të hipte në vapor e do t'ia mbathte. Kishte zgjedhur anijen italiane të pasagjerëve “Leonardo Da Vinçi”.

Ditë më parë, sapo Shehu e kishte marrë vesh këtë gjë, bëri zgjedhjen e tij: për rrugën e kthimit do të qe trageti francez i pasagjerëve “Liberté”.

Gjer në orën dhjetë Mehmet Shehu shkroi përgjigjet e disa mesazheve përshëndetëse që i kishin mbërritur një ditë më parë. Në letrën e një grupi juristësh amerikanë, të cilët prisnin caktimin e një ditë takimi, vuri shënimin miratues. Pastaj thirri përkthyesin e tha shkurt: “Kur të kthehem në Shqipëri do të mbaj një fjalim në Kuvendin Popullor. Bëj një projekt. Unë kam këto mendime”.

Kryeministri zgjati dy fije letre, stilografin dhe nisi të shqiptonte tezat për fjalimin e ardhshëm.

Kur doli përkthyesi, hyri shifranti. Mesazhi i ardhur prej Enver Hoxhës qe i shkurtër: “I dashur Mehmet, të gjitha radiogramet i kam marrë. Po e ndjekim “fiaskon” e OKB-së. Mbledhja në Moskë fillon të shtunën. Vetëm sa u hap...Dje Kosllovka e thirri për drekë Hysniun, por ai nuk shkoi...Fiqiretin dhe fëmijët i ke mirë. Të përqafoj dhe të presim sa më parë. Shpati”.

Në mesditë kryeministri i shoqëruar nga Behar Shtylla dhe Reis Malile shkoi në drekën e shtruar nga Nikita Hrushovi dhe aty mori vesh se Tito tashmë ndodhej në oqean, duke ikur. Ja kishte dalë që edhe në momentet e fundit të tërhiqte vëmendjen e medias. Në konferencën e shtypit para gazetarëve pati deklaruar me një ngazëllim të dukshëm se “Fuqitë e të paangazhuarve po vinë duke u rritur”.

Antikomunisti Selahudin Kaloshi i godet me një shishe vere

Në orët e para të pasdrekes, ndërsa gjithçka deri ato çaste dukej si tërësisht e patrazuar, ngjau një e papritur. Dy diplomatë të Misionit si edhe dy prej trupës së sigurisë së Mehmet Shehut erdhën të shqetësuar. U kishte ndodhur një incident, madje e quanin provokacion të mirëfilltë. Ndërsa me makinën e Misionit me targë DPL 27 ndodheshin në rrugën "Allen Street" një shqiptar i arratisur me emrin Selahudin Kaloshi i kishte goditur me një shishe me verë.

Në fillim ky as që kishte qenë i vëmendshëm për ta, por pasi brenda kabinës së veturës dëgjoi të flitej shqip dhe menjëherë pat hedhur sytë tek targa, kuptoi se cilët qenë. Atëherë u fut në një dyqan të madh afër, bleu një shishe vere dhe e flaku me forcë drejt tyre.

Shishja goditi automobilin dhe theu në të djathtë xhamin e derës së dytë. Dy diplomatët e Misionit dhe dy truporjat e kryeministrit shqiptar, ndërsa Kaloshi nuk lëvizte fare nga vendi, kishin dalë nga vetura dhe thirrën menjëherë një polic amerikan.

Sipas tyre, ky e kishte parë me sytë e tij çfarë pat ngjarë, prandaj edhe pritej të ndërhynte. Porse agjenti, edhe pse njeriu që i sulmoi me shishe vere qëndroi në vendin ku ishte, madje pa i tutur syri, u tregua moskokëçarës. Edhe pas kërkesës së diplomatëve shqiptarë për të marrë ndaj agresorit masat përkatëse polici u soll sërish me të njëjtën mënyrë.

Veç ajo që të katër i kishte lënë fare pa gojë ishte një episod i mëpasshëm. Pa e ftuar kush Selaudin Kaloshi u qe afruar shumë, u pat dëgjuar ankesën, gjestin për të cilin e akuzonin e pranoi dhe pyetjes “Përse e bëre?” i dha qetësisht përgjigjen “Sepse jeni komunistë”.

Të gjithë këtë skenë të habitshme polici amerikan e kishte parë dhe dëgjuar, por sërish nuk pati ndërhyrë. Atëherë dy diplomatët shqiptarë përdorën kartën e fundit. I treguan dokumentin e OKB-së.

Tjetri megjithatë nuk ndryshoi asgjë nga sjellja e mëparshme.

Tek e dëgjoji rrëfimin Reis Malile në fillim bërbeliti diçka nëpër dhembë, si për ta përmbajtur zemërimin. Veprimi i të arratisurit, edhe pse qe thjesht demonstrativ, mund t'i kishte rrezikuar jetën ndonjërit prej të katërve. Kaq nuk qe pak për të bërë një protestë të fortë.

Edhe pse veprim individual dhe jo i porositur apo i organizuar që më parë, gjithsesi ai akt dhune dhe mosndërhyrja e policisë kryheshin në një kohë kur në Nju Jork ndodhej Mehmet Shehu. Ishte në një farë mënyre mesazh kundër tij. Veprim i qartë edhe kundër Misionit Shqiptar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Malile vendosi ta bënte menjëherë problem.

Çfarë pat ndodhur ia thanë Mehmet Shehut vetëm kur u nisën për në Pallatin e Qelqtë. Ky u shqetësua.

Kur pas dy orësh u kthyen në Mision dhe kryeministri u mbyll në dhomë për të shkruar raportimin ditor, trokiti në derën e apartamentit të tij përkthyesi. Sapo hyri në dhomë i zgjati Shehut një tufë me letra të mbushura me makinë shkrimi.

Qenë plot dhjetë faqe.

Ishte projekti i parë i fjalimit që kryeministri do të mbante në Kuvendin Popullor. Ky e pa me shumë kujdes dhe sa herë që kthente fletët aq më shumë ndihej i kënaqur. “Mirë,

tha kur e mbaroi, e njeh stilin tim. Puno tani se pas një jave do të nisemi për në Shqipëri. Kur të hipim në anije ma jep, që t'i jap dorën time gjatë udhëtimit”.

Më pak se një orë më pas drejt Enver Hoxhës u nis radiogrami, mes togfrazave të të cilit ishin edhe këto tre: “Në pritjen e Hrushovit fola me katër anëtarët e Byrosë së Partisë mbi Titon, rrezikshmërinë, rolin e tij këtu, etj. Ishin dakord me ne plotësisht.

Vinogradovi, ambasador në Paris, tha se i kishte pëlqyer shumë fjalimi im mbi Kinën...

Së shpejti nisemi. Në Paris arrij më 17, në Romë më 19 dhe aty më 20 apo 21 tetor.

Avioni qeveritar të jetë gati për të ardhur në Romë në ditët 19 deri 21.

Nga Parisi ju njoftojmë ekzakt. Nisjen këtej do ju informojmë përfundimisht përsëri. Konkluzion: Erdhëm për të blerë desh dhe na rruan dhe kokën”.

Vizitë e Mehmet Shehut në “Metropolitan Museum”, e pret vetë drejtori Xhejms Robejner

Në mëngjesin e 5 tetorit një nga punonjësit e Misionit i tha Reis Maliles se në mbrëmjen e shkuar nuk e kishin kapur dot emisionin në valë të shkurtra të Radio-Tiranës. “Ndoshta defekte teknike, u përgjigj ky, ta bëjmë një provë dëgjimi sot”.

Në orën njëmbëdhjetë, gjithçka qe gati për të shkuar në “Metropolitan Museum”. Rojet amerikane të sigurisë vunë në lëvizje policinë njujorkeze dhe karvani i katër makinave u nis menjëherë.

Ndërsa po lëviznin drejt qendrës së Manhatanit Reis Maliles i bëri përshtypje sasia e madhe e mjeteve shoqëruese. Qenë shtatë automobila të policisë së zakonshme dhe asaj sekrete, ndërsa do të mjaftonin vetëm dy, një në krye dhe një tjetër në fund të karvanit.

Ndërkohë që të shtata tashmë po uturinin në rrugën kryesore, duke i sokëllitur edhe shtatë sirenat e tyre. Ulërinin edhe katër të tjera të motoçikletave. Kështu u bënë njëmbëdhjetë klithmues.

Në katër prej makinave agjentë të armatosur deri në dhembë qëndronin të varur jashtë kabinave, me një rën dorë mbajtur fort tek buza e derës.

Në rrugë sapo dëgjonin alarmin e sirenave dhe ndeshnin autokolonën makinat e tjera ndaleshin në vend. Pothuaj të gjithë njerëzit e gjendur ato çaste në trotuare e buzërrugë kthenin kokën nga kjo skenë e potershme.

Kur më në fund iu afruan “Metropolitan Museum” dhe Mehmet Shehu zbriti nga automobili, menjëherë u vu në

mes prej një numri të madh detektivësh dhe policësh. Një pjesë madje kishin kohë që e prisnin aty.

Këtu ndodhi e befasishmja. Për ta pritur kryeministrin shqiptar kishte dalë vetë drejtori i Muzeut Xhejms Robejner.

E përshëndeti në mënyrë shumë të sjellshme dhe tha se e kishte për nder ta shoqëronte gjatë gjithë vizitës.

“Flasim anglisht”, shqiptoi tingëllueshëm Mehmet Shehu dhe Xhejms Robejner e kuptoi qartësisht se ajo çfarë dëgjoji që një shprehje mirënjohjeje dhe ngrohtësie për të.

Ndërsa ktheheshin për në Mision në sjelljen e policisë ndodhi e njëjta gjë. Kur më në fund kryeministri u fut në apartamentin e tij Reis Malile u lëshua në një nga kolltukët e zyrës dhe u plandos në mendime. I gjithë ai spektakël policesk sikur donte ta bënte kryeministrin shqiptar shenjë të mbrapshtë të vëmendjes së opinionit publik.

Ishte duke menduar të gjitha këto kur e lajmëruan se e kërkonte Mehmet Shehu. Kur hyri në apartamentin e tij e gjeti edhe atë të zhytur në një kolltuk. Dukej i qetë. E falënderoi për mundësinë që i dha për të parë “Metropolitan Museum” dhe se po ta hiqnin qafe atë çetë të madhe policësh le të bënin edhe një vizitë të pabujshme në lagjen Harlem.

Reis Malile vuri buzën në gaz: “Okej!”

Shehu befas u zymtua. Tjetri e kuptoi se kryeministrit nuk i pati pëlqyer atë përgjigje ala-amerikane. Rikorigjoi: “Dakord, që sonte në darkë”.

Mirëpo papritur Mehmet Shehu ja shkrepiti të qeshurit dhe i bëri shenjë me kurrizin e dorës që të largohej.

Vizitë në lagjen “Harlem”

Pasdite shefi i Protokollit i OKB-së De Noue e priti Reis Malilen menjëherë. Ky i tregoi një për një të gjithë ngjarjen e goditjes së makinës të diplomatëve shqiptarë dhe mosveprimit të agjentit të policisë. Ngulmoi se rrethana të tilla e bënin mjaft të pasigurt veprimtarinë e delegacionit të vendit të tij. Pastaj i kërkoi që për çfarë pati ndodhur të vinte në dijeni zotin Dag Hammarskjold.

Zyrtari i Protokollit u shqetësua shumë. Për disa minuta nuk dukej se kishte forca të mjaftueshme për të risjellë tek vetja qetësinë e para takimit. Pothuaj i zbehur në fytyrë dhe me buzë që fërkonin dridhshëm njëra-tjetrën premtoi se do ta njoftonte menjëherë Sekretarin e Përgjithshëm dhe se do ta çonte gjer në fund këmbënguljen për t'i kërkuar policisë njujorkeze të merrte masa ndaj punonjësit të saj.

Kur Malile u kthye në Mision gjeti dy ngjarje të pakëndshme. I pari qe një informacion që paralajmëronte manifestimin e vorioepirotëve. Ai do të bëhej të nesërmen. I dyti ishte një artikull në faqen e gazetës “Dielli”.

Titullohej “Fshatarësia në Shqipëri nën komunizëm”.

Në të bëheshin akuza se politika e mëmëdheut kishte rënë në duart e komisarëve të kuq.

Kur u afrua ora 20.30 e fiksuan në radio shënjesin e valëve tek pozicioni 30.93, por emisioni në shqip nuk u dëgjua. E lëvizën para dhe pas me shpresë mos kishte ndërruar vend, por gjersa vajti 21.00, çast kur transmetimi ndërpritej, nuk e kapën dot.

Një orë më vonë, nën shoqërinë e vetëm katër amerikanëve të sigurisë, e çuan Mehmet Shehun të shihte lagjen “Harlem”.

Kur po kalonin pranë hotelit “Negro” Reis Malile i shpjegoi se atje në një gjysmë kati të tërë kishte qëndruar si mbret Josip Broz Tito.

“Fiqiretin me fëmijë i ke mirë, të bëjnë të fala. Shokët dhe Nexhmija të bëjnë gjithashtu të fala... Yti, Shpati”

Në shtatë e gjysmë të 6 tetorit Shehu kishte në duar radiogramin e ri të Enver Hoxhës.

E përgëzonte për punën në OKB dhe e informonte “Nga fronti i brendshëm s’ka asgjë të re. Tokat po punohen; panxhari po shkulet, por shumë i dobët. Një tërmet i vogël ka rënë në zonën e Kardhiqit, por pa dëme në njerëz, vetëm disa shtëpi u rrëzuan...Regjistrimi i popullsisë u bë në rregull...”.

Tre radhët e fundit ishin “Nënë tënde e takova prapë sot dhe i dhashë sihariqin e kthimit tënd. U gëzua. Fiqiretin me fëmijë i ke mirë, të bëjnë të fala. Shokët dhe Nexhmija të bëjnë gjithashtu të fala... Yti, Shpati”.

Protesta e vorioepirotëve u krye në mesditë. Nuk qenë më shumë se pesëdhjetë vetë. Vepronin si herën e dytë: vërtiteshin në heshtje me pankarta në duar. Ashtu ngjanin më shumë me murgjër. Një gjysmë ore më vonë u larguan po aq pa zhurmë.

Në “Empire State Building”

Për të vizituar “Empire State Building” u nisën vetëm me dy makina. Qiellgërvishtësi ndodhej në rrugën “5th Ave” dhe kryeministrit Reis Malile ia tregoi atë që larg, sapo bëri ballë me të gjithë pamjen e tij një qind e dy katëshe. Takimin me kuriozitetin e ri kryeministri e priti pa e fshehur dot padurimin. Që pas xhamit të makinës shtatin kolosal të godinës e ndoqi vazhdimisht me sy gjatë gjithë udhëtimit nëpër rrugët e Manhatanit dhe u gëzua kur, sapo morën një kthesë majtas, u shfaq menjëherë hyrja e saj.

Qe një bazament i stërmadh, ndërtesë katër katëshe, me sipër germat veshur në ngjyrë të florinjte “State Building”. “Këtu të bie kasketa nga koka”, foli hareshëm Mehmet Shehu.

Ndërsa po e shihte ndërtesën gjigande e kishte hequr nga koka kapelën republike dhe e mbante shpengueshëm në dorë. Pastaj qeshi lirshëm. Ishte një lloj gëzimi i ngjashëm me të një fëmije para se të hipë në një karusel aq shumë vërtitës sa të merr mendtë.

Në “Empire State Building” i panë me radhë të gjitha dyqanet e kateve të para. Pastaj hipën në kafen që ndodhej në tarracë. Kur ra nata prej andej Nju Jorku i llamburitur nga dritat dukej si një galaktikë kozmosi i mbushur jo me planetë, por me diamante.

Novotni dhe Gomulka largohen nga SHBA

Fragment radiogrami i dërguar nga Nju Jorku e shtunë paradite, 7 tetor: “Shoku Enver,...2) Sot “New York Times” boton artikullin e Salisbërit “Çarje midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik”.

Publikohet me ndryshimin midis fjalimit të Hrushovit e timit në debatin e përgjithshëm, ku ne flisnim për Kinën më fort se ata. Po ashtu në marrëdhëniet e tjera midis meje e Hrushovit në Nju Jork...

3) Novotni dhe Gomulka ikën të parët. Hrushovi me sot, me nesër. Vonohet. Është e qartë se çdo gjë mbetet e llogaritur. Ai nuk dëshiron ta gjejë Ten Siao Pinin në Moskë e kështu do të evitojë takimin me të. Por është bërë tmerrësisht qesharak...unë jam i të njëjtit mendim me ju që ne të mbrojmë vijën tonë deri në fund, pa marrë parasysh rrjedhimet. T'i hedhim të gjitha faktet dhe arsyetimet tona në tavolinën e nëntorit. Nuk durohet më. Mehmeti”

Në mbrëmje Përfaqësuesi i Përhershëm i Bashkimit Sovjetik Podgorni shtronte një darkë.

Ishte shenjë e sigurt se po afrohej çasti i largimit të Nikita Hrushovit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

“Hrushovi, person me sëmundje psiqike”

Ajo e shtunë e 8 tetorit do të ishte seanca e votimit për anëtarësimin apo jo të Kinës. U mbyll me humbjen e propozuesve, vendeve të kampit socialist dhe Mehmet Shehu nuk qe në humor të mirë.

E rifitoi qetësinë kur pasdite në selinë e Misionit nisi pritja zyrtare për shumë shqiptarë të kolonisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Qenë shumë që i gëzoheshin atij takimi, përfaqësues të organizatave “Shqipëria e Lirë”, “Vatra” si edhe të disa bashkimeve të tjera të Nju Jorkut, Bostonit, Detroitit...

Kur bashkëkombësit qenë larguar kryeministri përgatiti informimin e parë të asaj dite për Enver Hoxhën: “...2) Mbrëmë në darkën e Podgornit...Hrushovi ishte i gëzuar, bënte shaka, na ftoi të gjithëve për jashtë qytetit në vilë, të dielën. Doli vullnetar Zhivkovi e Novotni. Hrushovi tha të vijnë dhe shokët shqiptarë. Unë iu përgjigja: “Faleminderit, por mua nuk më lë policia të dal jashtë qytetit”. Tha: “T’i kërkoj leje policisë”. Ia ktheva se javën që shkoi kërkoja të dilja jashtë Manhatanit e nuk më lejuan, prandaj edhe më nuk kërkoj...

Në darkën e Podgorinit Novotni në emër të gjithëve ngriti dolli për Hrushovin, e lavdëroi atë si frymëzues, e quajti fitore sesionin e OKB-së, etj.

3) Të gjithë janë drejtuar në “Balltika”. Dezhi e Zhivkovi do udhëtojnë bashkë me vapor anglez të mërkurën, unë e rregullova të iki të martën vetëm me tjetër vapor”.

Radiogramin e dytë Mehmet Shehu do ta niste afër mesnatës. Shifrantët në Ministrinë e Jashtme e regjistruan

me numrin 423: “Shoku Enver, ...2)...Psikiatër të Nju Jorkut studiojnë e shkruajnë mbi karakterin e Hrushovit. Për ta është objekt interesant, e karakterizojnë si person me sëmundje psiqike që shkon brenda disa orëve nga sjellja serioze e tragjike në sjellje të butë servile kundrejt të njëjtit person. Bjenë shembull sjelljen karshi Hammarskjoldit që e shau në OKB dhe e përqafoi të nesërmen. Edhe një qeveritar amerikan deshi ta përqafonte, por ky i ktheu shpinën.

3) Do ju sjell një koleksion të vlefshëm me fotografi të Hrushovit, sidomos ato me Titon, disa nga të cilat sovjetikët i hoqën nga qarkullimi, por megjithatë ne i muarëm. Do kënaqeni kur ta shihni duke iu lutur Titos, i kërrusur mizerabël sa si puth këmbën. Titua rri serioz si mbret. Një ekspozitë e tërë bëhet me këto fotografi. Tash numërohen edhe orët, jo vetëm ditët, kur do shpëtoj nga ky ferr i tmerrshëm e të rilind duke u nisur në atdhe”.

“Të vish shëndoshë. Shpati”

Të dielën, më 9 tetor, që nga Tirana Enver Hoxha i shkruante: “Shoku Mehmet, lufta u nxeh, por punët shkojnë mirë. Të demaskohen plehrat një herë e mirë...Të hënën do të marrin grushte nga ne dhe nga kinezi...Të presim. Të vish shëndoshë. Shpati”.

Radiogrami i përgjigjes, kur mbërriti në Tiranë, u regjistrua me numrin 429: “Shoku Enver, shumë mirë që u hodhën zaret e u nxeh puna. Inshalla t’i vejë flaka në qiell se u mbush kupa me majë nga këta varrmihës të revolucionit...Marksizmi do fitojë më në fund e do i shohim me sytë tanë. Mehmeti”.

Përsëri revista “Time”

E hëna gdhiu me shumë re, por prej kërlëshjes së reve deri në mbrëmje nuk formoi dot asnjë pikë uji.

Qe dita e parafundit e qëndrimit të kryeministrit shqiptar në SHBA. Revista “Time” pat botuar atë mëngjes artikullin “Mehmet Shehut i përplasat dera në fytyrë”.

“Manhatan”, niste menjëherë shkrimi, “një njeri ishte dukshëm rastësisht jashtë. Në një pritje komuniste çeke, Shehu u ndal në një qoshe, u shmang nga të gjithë, përveç njeriut të sigurisë i Departamenti të Shtetit i caktuar si truproje e tij.

Dhe kur, në një pritje të dhënë nga rumunët e kuq, Hrushovi mori klikën e tij të miqve satelitë në një dhomë mbrapa për një bisedë, dera iu mbyll në fytyrë Shehut sapo ai filloi t’i ndjekë ata”.

“Shqipëria është një satelit evropian, i cili duket se ka zgjedhur Pekinin në një konflikt të brendshëm ideologjik mes Rusisë dhe Kinës së Kuqe, vijonte artikulli më pas, në qershor, kur Hrushovi thirri të gjithë shefat e partive satelite në Bukuresht për të ratifikuar politikën e tij "paqësore" të bashkëjetesës, sekretari i partisë shqiptare Enver Hoxha qe i vetmi kryetar i lartë komunist që mungonte. Në OKB, Shehu në fjalimin për pranimin e Kinës së Kuqe, duke i bërë jehonë asaj, ishte më i rreptë se Hrushovi...

Pse ky vend i vogël (10.630 km katrorë) si Shqipëria, e cila ka më pak hapësirë se Virxhinia Perëndimore dhe më pak njerëz se Detroiti, duhet të marrë pjesë në Kinën e Kuqe kundër rusëve është diçka e mistershme. Një pjesë e

përgjigjes mund të jetë varfëria e saj. Shqipëria ka vetëm 5.000 vetura, kamionë dhe autobusë. Si Kina e Kuqe ndjen nevojën e mbajtjes gjallë të luftës së klasave për ta larguar popullin e saj nga rebelimi. Por një tjetër arsye janë incidentet historike dhe gjeografike: Jugosllavia e Titos, armiqtë e Shqipërisë dhe fqinjët, mbeten aktualisht objektivi i preferuar për kritikën kineze, dhe Shqipëria mund të figurojë si "armiku i armikut tim është miku im".

Vapori tundet...

Në mëngjesin e dhjetë tetorit Mehmet Shehu nuk erdhi në restorant dhe përkthyesi mendoi se ndryshe nga herët e tjera, kur në tryezat pranë njëra tjetrës, kishin drekuar apo darkuar, kryeministri nuk do të kishte rast ta vështronte me nëntekstin e pyetjes së pathënë “A e mbarove shkrimin e fjalimit që do të mbaj në Kuvendin Popullor?”

Në të vërtetë që prej çastit kur Shehu ia pat vënë detyrë ai që mbyllur në dhomën e tij e përmbysur mbi tufën e letrave. E megjithatë, ndërsa nuk mbeste ditë pa dy apo tre faqe të shkruara kujdesshëm, nuk kishte shumë vullnet për ta përfunduar. Me vete bënte llogarinë e thjeshtë se kryeministrit boceti i duhej kur të zbriste në Tiranë.

Por ndërsa mendoi se të njëjtin ritëm do të mbante edhe Mehmet Shehu, ky sapo u kthyen nga restoranti, e thirri në dhomën e tij. Kur pyetjes së ngulmët nëse e kishte përfunduar projektin e fjalimit, sepse edhe atij i duhej kohë t’i jepte dorën e vet, përkthyesi iu përgjigj disi i hutuar se ende jo, kryeministri u nervozua.

–“Shiko, i tha, me mua mos bëj shaka. Në qoftë se një punë nuk e bën dot thuaj nuk e bëj se unë e bëj vetë”.

–“Do ta përfundoj patjetër”, i premtoi përkthyesi.

–“Kur?” gati sokëlliu Shehu.

–“Pas dy-tre ditësh”, lëshoi fjalët vetëmbrojtëse tjetri.

–“Ku paske për të punuar kaq lehtësisht?”, kërciti sërish fjalët kryeministri.

“Në vapor”, iu përgjigj me zë të plotë përkthyesi.

–“Nuk mundesh në vapor”, brofi Mehmet Shehu.

–“Pse?”, pyeti tjetri.

-“Sepse vapori tundet”, erdhi reagimi nga kryeministri.

-“Po ju si do t’i jepnit dorën e fundit?”

Shehu bërbëliti një tufë fjalësh nëpër buzë, por asnjë prej tyre nuk mori formë të kuptueshme.

Pasditen e vonë informoi Enver Hoxhën se “Kulmi i poshtërimit të Hrushovit qe mbrëmë në debatin në televizion me një qelbësirë korrespondent gazete, për dy orë e gjysmë. Qelbësira amerikane arriti sa t’i thotë “Ju po i lehni hënës” dhe e bëri që Hrushovi të vazhdojë t’i lutet për paqe. Çdo 20 minuta llomotitje e lutje e Nikitës për paqe emisioni ndërpritej dy minuta dhe transmetonte nga “Evropa e lirë”.

Pas intervistës televizive vazhdoi komenti i ekspertëve të çështjes sovjetike. Krahasuan çfarë ka thënë Hrushovi për Stalinin para e pas vdekjes, e quajtën gënjeshtar e hipokrit, por megjithatë, thanë, është pozitive se me të mund të bisedohet, etj.

Revoltonjëse dhe e poshtër e gjithë kjo intervistë.

Nesër, të martën, ora 4.30 pasdreke me të Tiranës, nisem për Havre e jam i lumtur se udhëtoj vetëm. Ora nisjes është ora e lindjes. U gjeça mirë. Ju përqafoj. Mehmeti”.

46 fjalët e radiogramit

E marta e 11 tetorit që prej brigjeve të Atlantikut drejt Tiranës lëvizi nëpër eter tre mesazhe.

I pari përmbante 46 fjalë: “Në njëmbëdhjetë tetor u nis nga Nju Jorku për në atdhe me vaporin francez “Liberté” Kryeministri. Në portin e Nju Jorkut shoku Mehmet Shehu u përcoll nga Ministri Behar Shtylla, nga Përfaqësuesi i Përherhëm Reis Malile si edhe nga anëtarë të tjerë të delegacionit në Sesionin e 16-të. Gjithashtu shoku Mehmet u përcoll nga përfaqësuesit e vendeve socialiste në OKB si edhe nga shefi i protokollit të saj”.

Radiogrami i dytë kur mbërriti në kryeqytetin shqiptar saktësonte: “Shoku Mehmet u nis sot me vaporin “Liberté”. Kishin dalë vetëm përfaqësuesit e përherhëm bullgar, hungarez dhe ndihmëspërfaqësuesi polak. Nga të tjerët asnjë, me gjithë se ishin lajmëruar...

Udhëtarët e “Balltikës” po ikin veç e veç, mbrëmë Novotni, sonte Gomulka, Dezhi e Zhivkua bashkë, pasnesër Hrushovi tok me Kadarin, etj. Asnjë me “Balltikën”.

Kjo ka mbetur buzë detit. Një marinar iu arratis dje”.

I treti radiogram, ai që në zyrën e shifrës në Ministrinë e Jashtme në Tiranë mori numrin 434, si një udhëtar i hutuar dhe i ngatërruar nëpër rrugët e qiejve, përpëliste fjalët se “Intervista e Kryeministrit në “United States News” nuk u botua”, prandaj edhe “teksti i dërguar të mos publikohet”.

Në mbrëmjen e vonë të 11 tetorit në Misionin Shqiptar erdhi ambasadori i Çekosllovakisë Kurka. Me Reis Malilen ndenji një gjysmë ore dhe fjala e parë që shqiptoi ishte

kërkimi i ndjesës. Tha se nuk mundi të vinte dot në përcjellje dhe se bashkë me të madje do të vinte edhe vetë ministri i Jashtëm David, por gabimisht kishin ngatërruar datën e nisjes.

Piu një kafe, mërmëriti disa fjalë të përgjithshme dhe pastaj iku. Malile e përcolli deri sa ambasadori Kurka hipi në makinën e tij.

Ndërsa u ringjiti në zyrë e rrëzoi trupin menjëherë në kolltuk dhe siç bënte kur ndihej shumë i vetmuar, hoqi syzet dhe mbuloi sytë me pëllëmbët e duarve. Që atë ditë apartamentet e zëna nga kryeministri dhe njerëzit e tjerë të delegacionit po riktheheshin në gjendjen e mëparshme. Mbi tre javë familjet e punonjësve të Misionit kishin banuar në hapësira shumë të ngushta, tek njëri-tjetri, në pjesën e mbetur të katit.

Pesë minuta më pas Reis Malile u ngrit dhe formuloi shkurt një radiogram të katërt për Tiranën. Njoftoi se kishte pothuaj dhjetë ditë që emisioni për shqiptarët në Amerikën e Veriut nuk dëgjohej.

Pastaj u rilëshua mbi kolltuk. E kishte kapur një trishtim i çuditshëm.

Ikja e Mehmet Shehut nga Nju Jorku me udhëtimin e fundit të anijes franceze “Liberté”

Vapori i pasagjerëve “Liberté” qe një anije franceze 270 metra e gjatë. Ishte një lundruese mjaft e sigurt dhe shumë e rehatshme, por tashmë e mundur prej konkurrencës së anijeve të reja.

Oqeanin Atlantik prej brigjeve të Francës deri në Nju Jork si edhe intenerarin e ndërsjellët e bënte për gjashtë ditë. Tragjetet e reja e kryenin për vetëm pesë njëzetë e katër orësh.

Ishte kjo arsyeja që udhëtarët nuk e pëlqenin më dhe e dalë me humbje në atë mes shtator 1960 po kryente udhëtimin e saj të fundit. Me të mbërritur në bregun francez do të nxirrej në radë e do të çmontohej pjesë-pjesë. Do të shkonte për hekurishte.

Atë 12 tetor Mehmet Shehu shumicën e kohës qëndroi i mbyllur në kabinën e tij. Ndërkohë nuk u pa mes shëtitësve në kuvertë as përkthyesi. Në kabinën e vet ai vazhdonte të shkruante fjalimin e kryeministrit, përherë me shpresë ta përfundonte para se trageti të hidhte ankorat në portin e Havresë.

Po atë ditë Josip Broz Tito gjendej në molin e Napolit. I porsa zbritur nga shkallët e vaborit “Leonardo Da Vinci” shkëmbeu disa batuta me gazetarët italianë. Këta ishin një turmë e tërë. Presidenti jugosllav u tregoi se për herë të parë në atë qytet kishte qenë në vitin 1944.

Ndërkohë në sallën e Asamblesë atë 12 tetor pati ndodhur një ngjarje, e cila do të mbetet e përfolur në të gjithë historinë e Kombeve të Bashkuara.

Për të Enver Hoxhën do ta informonte një ditë më pas që nga Nju Jorku ministri i Jashtëm Behar Shtylla: “Këto kohët e fundit Hrushovi arriti kulmin e qëndrimit kontradiktor dhe të ulët. Brenda një seance fjalë të buta, përgëzime amerikanëve dhe pastaj kërcënime e shprehje brutale. Mbrëmë nxori këpucën dhe me të godiste tryezën. Sot gazetat e botojnë fotografinë me këpucë mbi tryezë... Sonte ikën. Ne nuk do ta përcjellim. Shoku Mehmet po udhëton shumë mirë, është i kënaqur”.

Zbritja në aeroportin e Rinasit

Në mbrëmjen e 17 tetorit legata shqiptare në Francë njoftoi Ministrinë e Jashtme: “Në vijim të udhëtimit për në atdhe sot arriti nga Nju Jorku në Havre dhe prej Havre me tren në Paris kryeministri Mehmet Shehu.

Ai u prit në port nga i Ngarkuari me Punë M. S.

Në stacionin e trenit në Paris kishin dalë titullarë të përfaqësive diplomatike të vendeve socialiste dhe Kryesia e Shoqatës së Miqësisë France-Shqipëri, me në krye Zhilbert Byrlo, nënpresident i shoqatës dhe Pol Kyjo, sekretar i përgjithshëm i saj”.

Radiogrami i cili në Tiranë prej shifrantëve u kodua me numrin 549 dhe që i dërguar prej Romës, shënonte datën 22 tetor, thoshte se “Sonte në orën 00.18 u nis delegacioni shumë në rregull. Në stacion erdhën për ta përcjellë nga vendet që njoftuam, këta persona: këshilltari i ambasadës sovjetike, këshilltari polak, sekretari i parë rumun, ministri çek dhe hungarez. Ndërsa bullgarët, indiani dhe sudanezi nuk erdhën. Nga Ministria e Jashtme Italiane qe këshilltari Rosi. Mbërrijnë në Bari në orën 7.50...”.

Këtu që një natë më parë ishte ulur avioni qeveritar shqiptar.

Ky, me Mehmet Shehun brenda, e kaloi Adriatikun brenda po asaj dite.

Ndërkohë që sapo ulej në aeroportin e Rinasit, nëpër qiell, i ardhur me ngut nga drejtimi i Pragës, mbërriti prej Nju Jorkut radiogrami 455: “Radio Tirana filloi të ridëgjohet mirë”.